



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE

Draft

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË
BIZNESIT DHE INVESTIMEVE

(2013- 2020)

Prill 2013

TABELA E PËRMBAJTJES

<i>Hyrje</i>	4
I. SITUATA AKTUALE	6
1. Përmirësimi i Klimës së Biznesit	6
1.1. <i>Thjeshtimet Administrative</i>	6
1.2. <i>Reforma Tatimore</i>	6
1.3. <i>Qeverisja Elektronike</i>	6
2. Konkureshmëria e Ekonomisë	7
3. Zhvillimi i biznesit dhe sfidat	10
3.1 Zhvillimi i Sipërmarrjes dhe i SME-ve	10
3.1.1. <i>Situata Aktuale e Zhvillimit të Sektorit të SME-ve</i>	10
3.1.2. <i>Lehtësirat Financiare dhe Kreditimi</i>	12
3.1.3. <i>Akti i Biznesit të Vogël për Evropën (SBA)</i>	12
3.1.4. <i>Ekonomia Kreative & Sipërmarrjet nga gratë</i>	13
3.1.5. <i>Inovacioni dhe Zhvillimi i Teknologjisë për SME-ve</i>	13
3.1.6. <i>Sfidat për zhvillimin e SME-ve</i>	13
3.2. Zhvillimi i Industrisë dhe i Minerave	16
3.2.1. <i>Zhvillimi i Industrisë jo-ushqimore</i>	16
3.2.2. <i>Zhvillimi i Industrisë Minerare</i>	17
3.2.3. <i>Sfidat për zhvillimin e industrisë dhe minerave</i>	19
3.3. Zhvillimi i Eksporteve	20
3.3.1. <i>Zhvillimet në kontekstin e politikës tregtare</i>	20
3.3.2. <i>Ecuria e Eksporteve</i>	21
3.3.3. <i>Sfidat dhe problematikat në fushën e eksporteve</i>	Error! Bookmark not defined.
3.4. Zhvillimet në Performancën e Investimeve të Huaja Direkte (IHD)	25
3.4.1. <i>Vështrim i Përgjithshëm</i>	25
3.4.2. <i>IHD-të në shifra</i>	26
3.4.3. <i>Sfidat për zhvillimin e Investimeve të Huaja Direkte</i>	29
4. Risqet që kushtëzojnë suksesin e zbatimit të kësaj strategjie	Error! Bookmark not defined.
II. VIZIONI, QËLLIMET DHE POLITIKAT E STRATEGJISË	32
1. Vizioni i Strategjisë	32
2. Qëllimet e Strategjisë	33
3. Politikat kryesore të strategjisë	34
3.1. <i>Politikat e zhvillimit të sipërmarrjes dhe SME-ve:</i>	34
3.2. <i>Politikat industriale dhe minerare</i>	35
3.3. <i>Politikat e nxitjes së eksporteve</i>	39
3.4. <i>Politikat e nxitjes së investimeve</i>	40
III. OBJEKTIVAT KRYESORE TË STRATEGJISË	43
1. <i>Sipërmarrja dhe SME-të</i>	43
2. <i>Objektivat për sektorin e industrisë dhe minerave</i>	54
3. <i>Objektivat për eksportet</i>	61
4. <i>Objektivat për zhvillimin e Investimeve të Huaja Direkte</i>	65
IV. KOSTOT FINANCIARE DHE BURIMET PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË	68
<i>Orientim mbi kostot e përgjithshme për zbatimin e strategjisë:</i>	69
V. TREGUESIT E MONITORIMIT TË STRATEGJISË	71
1. <i>Benchmarking Ndërkombëtar</i>	71
2. <i>Treguesit e strategjisë</i>	72

GRUPI I PUNËS

Sipas Nenit 102, paragrafi 4, të Kushtetutës dhe Udhëzimit të Kryeministrit nr. 12, datë 02.02.2012 "Për hartimin dhe përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim" NSDI 2013-2020, dhe në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, nr. 258, datë 20.03.2012, u ngrit grupi i punës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe të Investimeve, me pjesëmarrjen e:

Z. Dardan Domi Kryetar
Z. Bashkim Sykja
Znj. Pranvera Kastrati
Z. Sokol Mati
Z. Artur Pilkati
Znj. Eneida Guria
Znj. Silvi Gruda
Znj. Tefta Demeti
Znj. Kujtime Stefani
Znj. Frida Bilali (Tifekçiu)
Z. Thoma Rusha

Për përgatitjen e këtij drafti, përveç anëtarëve të grupit të punës, një kontribut me vlerë është dhënë edhe nga stafi i METE në Drejtorinë e Politikave të Konkureshmërisë, në atë të Politikave Industriale dhe Minerare, Politikave të Integritit Tregtar nga stafi i AIDA si dhe nga opinionet e grupit këshillimor.

Hyrje

Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2013-2020, përbën dokumentin bazë për evidentimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për nxitjen e biznesit dhe investimeve për periudhën 2013-2020. Dokumenti është konceptuar si vazhdimësi dhe zgjerim i politikave të parashikuara për periudhën 2007- 2013 dhe është hartuar mbi bazën e gjetjeve të arritura si dhe pas një analize të detajuar të treguesve dhe nevojave të identifikuara përgjatë kësaj periudhe.

Strategjia është në linjë me dokumentet kryesore të Komisionit European në fushën e nxitjes së biznesit dhe investimeve dhe si e tillë ka në fokus të saj edhe një nga prioritetet kryesore të BE-së për periudhën 2013-2020, *rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë*. Si i tillë ky dokument është në përputhje edhe me ambicet dhe objektivat e qeverisë për zhvillim dhe integrimin European.

Strategjia e Biznesit dhe Investimeve, është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo është në linjë me parimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) dhe kapitujve të saj, me nenin 91 "Nxitja dhe Mbrojtja e Investimeve" dhe nenin 93 "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" që lidhen edhe me parimet e Aktit të Biznesit të Vogël/ SBA.

Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2013-2020 është në harmoni me politikën industriale të BE-së, që bazohet në parimet e Strategjisë Evropiane "Europë 2020" (e integruar, e zgjuar, rritje e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse). Ka si qëllim rritjen e punësimit, përmirësimin e kushteve dhe rritjen e mbështetjes për inovacionin, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe kohezionin social.

Kjo strategji, gjatë gjithë procesit të hartimit është e bazuar mbi një dialog të vazhdueshëm publik-privat. Me qëllim për të pasur një proces konsultimi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës, janë organizuar një seri tryezash konsultimi, me përfaqësues të komunitetit të biznesit, shoqëria civile, donatore dhe institucione financiare, si dhe me grupe ekspertesh të ekonomisë.

Strategjia e Biznesit 2013-2020, është hartuar duke marrë në konsideratë edhe krizën ekonomike financiare ndërkombëtare, europiane, të rajonit dhe ku padyshim është ndikuar edhe ekonomia e vendit.

Si pasojë e zbatimit të suksesshëm të strategjisë aktuale e cila mbulon periudhën 2007-2013, janë realizuar reforma madhore, si p.sh. taksa e sheshtë, prokurimi elektronik, liberalizimi dhe thjeshtimi i të bërit biznes dhe përmirësimet e vazhdueshme të infrastrukturës fizike, të cilat kanë ndikuar që Shqipëria tu bëjë ballë krizave ekonomike financiare, më mirë se vendet fqinje të saj.

Misioni i kësaj strategjie është : "Për një Shqipëri konkurruese".

Referuar misionit të strategjisë, Shqipëria synon të arrijë në 2020: një vend që zhvillon dhe përmirëson klimën e biznesit dhe SME-ve, një treg të hapur konkurrues, zhvillimin e industrisë si dhe një destinacion tërheqës për investimet.

Strategjia është e natyrës horizontale, që nuk përqendrohet në mbështetjen e industrive apo sipërmarrjeve të veçanta. Ajo përbën një udhërrëfyes në mënyrë që kompanitë të zhvillojnë dhe të

përmirësojnë aftësitë e tyre konkurruese, të zhvillojnë inovacionin e produkteve dhe shërbimeve, duke nxitur rritjen afat-gjatë të qëndrueshme në tregjet ndërkombëtare dhe krijimin e kushteve për thithjen e investimeve të huaja. Kolonat kryesore të strategjisë janë: 1. Një fokus i ri i orientuar në politikën e klimës së biznesit dhe SME-ve; 2. Politikën industriale dhe minerare; 3. Integrimi tregtar dhe zhvillimi i eksporteve; 4. Nxitja e Investimeve të huaja direkte.

Kjo strategji do të shërbejë funksioneve të politikbërjes dhe atyre rregullatore, për implementimin e politikave pro aktive, që ti përgjigjen më mirë konkurrencës në tregun rajonal dhe më gjerë. Ajo do të zbatohet nëpërmjet zhvillimit të kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe me kontribut financiar dhe në bashkëpunim me donatorët dhe organizatat financiare ndërkombëtare.

Strategjia shërben si instrument kryesor drejtues dhe menaxhues i procesit të planifikimit në fushat e biznesit dhe investimeve për të gjitha nivelet e qeverisjes. Ajo gjithashtu kontribuon dhe nxit zhvillimin ekonomik të qarqeve dhe bashkive në Shqipëri, bazuar mbi avantazhet konkurruese që këto qarqe ofrojnë, duke përmirësuar klimën e biznesit dhe të investimeve, reduktimin e pengesave administrative dhe të kostos së bërjes biznes, si baza për të siguruar zhvillimin e kapaciteteve prodhuese.

Strategjia nxit zhvillimin e një sektori produktiv industrial dhe mineral, të aftë të përpunojë lëndët e para në vend dhe të rrisë vlerën e shtuar përmes nxitjes së investimeve, aplikimit të teknologjive të reja, prodhimit të pastër dhe rritjes së profesionalizmit që përbejnë themelin e krijimit të një industrie konkurruese.

Strategjia krijon kornizën për krijimin e partneriteteve mes qeverisë dhe biznesit lidhur me nevojën e përmirësimit të teknologjisë, inovacionit dhe kapaciteteve, ku të gjithë aktorët të kenë mundësinë të kontribuojnë drejt një ekonomie me dinamike dhe konkurruese, me shumë investime të huaja direkte, duke rritur dhe diversifikuar eksportet dhe krijimin e SME-ve të reja.

Në këtë strategji ndryshe nga programet e mëparshme është punuar për të përputhur më mirë raportet e politikës së programit buxhetor me kostot financiare dhe burimet e financimit të kësaj strategjie. *Meqenëse burimet e brendshme janë të kufizuara, në strategji synohet që masat e përcaktuara për çdo produkt të konvertohen lehtësisht në fisha projekti që të jenë të mirëpritura nga vetë donatorët.* Në këto kushte, puna do të fokusohet në zhvillimin dhe realizimin e projekteve prioritare të parashikuara në këtë strategji.

I. SITUATA AKTUALE

1. Përmirësimi i Klimës së Biznesit

Gjatë pesë viteve të fundit Shqipëria ka ndërmarrë shumë reforma për reduktimin e pengesave administrative ndaj biznesit që kanë dhënë rezultatet e mëposhtme:

1.1. Thjeshtimet Administrative

- ✦ *Qendra Kombëtare e Regjistrimit. QKR-ja si one stop shop.* Regjistrimi në QKR bëhet brenda një dite pune dhe me një kosto minimale prej 100 ALL (0.81 euro). Regjistrimi me një sportel të vetëm ofrohet në **32 zyra** në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim thjeshtimin në maksimum të procedurës së regjistrimit.
- ✦ *Qendra Kombëtare e Licencimit. QKL-ja si one stop shop.* QKL-ja punon mbi parimin e vetë-deklarimit dhe miratimit të heshtur. Licencat e grupit I dhe II jepen nga QKL-ja brenda 2-4 ditëve. Licencat e grupit III, të cilat iu janë kaluar ministrive përkatëse, kërkojnë nga 10-30 ditë procedura licencimi. Që nga 9 Qershori 2010, brenda QKL-së ka filluar funksionimin sporteli i aplikimeve për projektet në fushën e energjetikës, si një objektiv madhor zhvillimi për qeverinë Shqiptare.

1.2. Reforma Tatimore

- ✦ *Reformat Tatimore.* Politika fiskale është duke influencuar gjithnjë e më tepër në krijimin e një klime nxitëse dhe mbështetëse për sipërmarrjet vendase dhe ato të huaja. Tatimi mbi të ardhurat është reduktuar në nivelin e sheshtë prej 10% që nga Janari 2008 dhe përfshin të gjitha llojet e të ardhurave. Në vitin 2009 u ratifikua e drejta e kompensimit për detyrimet tatimore pasardhëse, si dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe ato shëndetësore në vlerën e TVSH-së së rimbursueshme. Për vitin 2013, hyrja në fuqi e ligjit për heqjen e TVSH për të gjitha makineritë e pajisjet, për të gjitha nivelet e bizneseve që importojnë këto për qëllime investimi dhe prodhimi, konsiderohet si një masë tepër e rëndësishme. Bizneset që mund ti blejnë këto makineri pa paguar TVSH, janë bizneset që:
 - importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë në ose mbi 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë;
 - importojnë makineri dhe pajisje në sektorin e përpunimit aktiv (fason), pavarësisht nga vlera e investimit;
 - importojnë makineri dhe pajisje në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit;
 - biznesi i vogël të cilët importojnë makineri prodhuese në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre.
 - si dhe përjashtimi i TVSH-s nga importi për hekurin dhe çimenton që përdoret për ndërtimin e hidrocentraleve.
 - Gjithashtu importimi i makinerive dhe pajisjeve të bëra me ndërmjetësimin e kompanive leasing janë subjekt i përjashtimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar.Kontributet e sigurimeve shoqërore janë reduktuar në masën 15% që nga Maji i vitit 2009.

1.3. Qeverisja Elektronike

- ✦ Lidhur me thjeshtimin e procedurave të bërjes biznes, me mbështetjen edhe të Marrëveshjes së Sfidës së Pragut të Mijëvjeçarit (MCATA), të administruar nga USAID, është bërë progres në

veprimtarinë e administratës publike në katër fusha kryesore: *prokurimin publik, regjistrimin e biznesit, administrimin e taksave dhe licencimin.*

o *Shërbimi on line për deklarimin dhe pagesën e taksave.* Gjatë vitit 2011 e në vazhdim, shërbimeve elektronike të ofruara nga autoritetet tatimore u është shtuar gjithashtu deklarimi on line i:

- a. listë pagesave, kontributeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi,
- b. punonjësve të rinj, atyre të punësuar rishtazi dhe të larguarave nga puna,
- c. deklarimi i pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi i vogël.

o *Prokurimi on line:* Që nga fillim viti 2009 të gjitha llojet e prokurimeve publike zhvillohen on line. Sistemi elektronik i prokurimit publik (www.app.gov.al) përmban të gjithë dokumentacionin për marrjen pjesë në tender, ku të gjitha sistemet operative, përfshirë shkarkimin e dokumenteve dhe dorëzimin elektronik të ofertave dhe propozimeve për tender bëhen falas.

o *Shërbimi on line në dogana:* Me kompjuterizimin e të gjitha pikave doganore dhe përdorimin e programit **ASYCUDA** shërbimi ndaj biznesit është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme, duke reduktuar kohën e kryerjes së kontrollit të dokumentacionit dhe atë të mallrave. Që nga viti 2010 deklaratat doganore përpunohen duke përdorur 100% të kohës sistemin ACA ASYCUDA (100% DTI - Direct Trader Input) që shtrihet në të gjithë territorin doganor.

✚ *Teknologjia e informacionit.* Gjatë viteve të fundit Qeveria ka ndërmarrë politika nxitëse mbi zhvillimin e teknologjisë së informacionit që nga shkollat e deri tek sipërmarrjet për të rritur konkurrueshmërinë e bizneseve Shqiptare në tregun rajonal dhe atë global.

2. Konkurrueshmëria e Ekonomisë

Duke ditur se Shqipëria aspiron për tu bërë një vend kandidat për anëtar i BE-s, benchmark i BE-së është i rëndësishëm, por gjithashtu është i rëndësishëm krahasimi me vendet e Evropës Juglindore (SEE) në aspektin e konkurrueshmërisë. Kështu PBB për frymë në vitin 2011, sipas EUROSTAT, në Shqipëri ishte në masën **30% të PBB** për frymë në PPS¹ krahasuar me mesataren e EU-27, 11% krahasuar me PBB-në/ për frymë më të lartë që e ka Luksemburgu dhe 66% e PBB-së / për frymë krahasuar me vendin me nivelin më të ulët në BE që është Bullgaria.

Grafiku 1 i referohet pozicionit të Shqipërisë kundrejt vendeve të Ballkanit perëndimor.

Sipas raportit të **Konkurrueshmërisë Globale** të Forumit Ekonomik Botëror 2012-2013, Shqipëria renditet e **89-a nga 144 vende/ekonomi.**

Shqipëria klasifikohet në grupin e vendeve që janë në stadin e dytë të zhvillimit të konkurrueshmërisë (gjithashtu quhet “ stadi nxites i eficiencës së ekonomisë ”) Kur ekonomitë transferohen në fazën e eficiencës, jo shumë kohe konkurrueshmëria e tyre mbështetet në çmime të ulta, **por në cilësinë e mallrave dhe të shërbimeve.**

Duke konsideruar tre dimensionet kryesore (kërkesat bazë, rritja e eficiencës, inovacioni dhe faktorët e sofistikimit) të indeksit, Shqipëria ka rezultatin me të lartë në treguesin e parë” “kërkesat bazë” (4.2 pikë)², duke u renditur në pozicionin e **87-t.** Duke vështruar shtyllat brenda

1 PPS -PPP lejon të krahasohet standardi i jetesës midis vendeve duke marrë parasysh nivelin e shkëmbimit valutor


2 Rezultatet jane nga 1 deri ne 7. Vlera me e madhe, performance me e mire

këtyre dimensioneve, **renditjet me te mira të këtyre shtyllave, janë** “shëndeti dhe edukimi parësor” (5,6 pikë), “efiçienca e tregut të punës (4,4 pikë), “efiçienca e tregut të mallrave” (4,3 pikë); mjedisi makroekonomik (4,3 pikë).

Renditja me e ulët sipas shtyllave janë ‘inovacioni’ (2.6 pikë), ‘madhësia e tregut’ (2.9 pikë), ‘zhvillimi i tregut financiar’ (3.4 pikë), ‘gatishmëria teknologjike’ (3.7 pikë), ‘sofistikimi i biznesit’ (3.6 pikë) dhe ‘infrastruktura’ (3.5 pike).

Për sa i takon nën indikatorëve, Shqipëria renditet mjaft mirë për “indeksin e të drejtave ligjore” në vendin e 9-të, “koha për të filluar biznes” në vendin e 9-të, “mbrojtja e investitorit” në vendin e 15-te, “pagesa dhe produktiviteti” në vendin e 17-të, “barra rregullatore administrative për biznesin” në vendin e 9-të. **Faktorët më problematikë** për të bërë biznes sipas raportit janë: aksesin në financë, niveli i taksave, korrupsioni, dhe rregullimi i taksave.

Grafiku 1.



Në renditjen rajonale, vendin e parë në renditje e zë Mali i Zi. Shqipëria është gati në një nivel renditje me Bosnje Herzegovinen dhe lë pas Serbinë me 6 vende. Pas shumë viteve progresi të qëndrueshëm, Shqipëria vetëm në periudhën e fundit 2 vjeçare 2012-2013 ka paraqitur rënie në renditje, e cila mund të jetë në një masë të caktuar ndikimi i faktorëve të jashtëm (kriza ekonomike globale). Ndërsa rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë në vitet e fundit i dedikohet në një masë të madhe reformave të qeverisë, por që nga ana tjetër që vendi të jetë më konkurrues kërkohet të vihet theksi në faktorët e inovacionit, gatishmërisë teknologjike, përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe konsolidimin e institucioneve.

Sipas “**Indeksit të Lirisë Ekonomike 2012**” të raportit të Heritage Foundation and Wall Street Journal, e cila mbulon 10 liritë – nga të drejtat e pronës deri në sipërmarrjen – në mes 184

vendeve të botës, Shqipëria shënoi (65,1 pikë)³ duke u renditur në vendin e 57-të në botë dhe në vendin e 26 mes 43 vendeve evropiane.

³ Shkalla e matjes nga 1-100, ku 100 përfaqëson lirinë maksimale.


Shqipëria klasifikohet në kategorinë e vendeve me **liri ekonomike të moderuar** mbi mesataren botërore (59.5) dhe u rrit me një pikë në renditje krahasuar me vitin e kaluar, kryesisht për përmirësim në luftën kundër korrupsionit dhe lirisë së biznesit.

Dimensionet me **renditje më të lartë** të lirisë ekonomike mbeten ‘liria fiskale’ (91.4 pikë), e ndjekur nga ‘liria monetare’ (78.6 pikë ose 11.1 pikë me shumë se në vitin 2011), ‘liria tregtare’ (79,8 pikë). Dimensionet me renditje më të ulët janë ‘liria nga korrupsioni’ (33 pikë) me një përmirësim prej 1 pikë nga 2011 dhe ‘të drejtat e pronës (35 pikë) pa ndryshim nga viti i kaluar. Raporti nënvizon se është rritur dinamizmi ekonomik, dhe vendi ka përjetuar një rritje të fortë ekonomike që e ka ulur varfërinë dhe normat e papunësisë. Efiçienca e sistemit rregullator është lehtësuar nga një thjeshtëzim në shkallë të gjerë të procedurave të biznesit. Themelet e lirisë ekonomike të Shqipërisë janë të paqëndrueshme nga mbrojtja e dobët e të drejtave të pronës dhe korrupsioni i përhapur. Mbrojtja e dobët e të drejtës së pronës është kryesisht rezultat i ndërhyrjes së politikës në sistemin gjyqësor.

Banka Botërore: Lehtësia e të bërit biznes 2012-2013.

Sipas raportit të Bankës Botërore ‘Të bërit Biznes 2012-2013’, Shqipëria renditet e 85 nga 185 ekonomi, një renditje më e mirë se vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, të tilla si Bosnje & Hercegovina dhe Serbia. Shifrat tregojnë se renditja e Shqipërisë ka qenë gati e pandryshueshme në tre vitet e fundit, por hop cilësor dhe të rëndësishëm ka shënuar nga viti 2007 në 2009, vit në të cilin pati një përmirësim në renditje prej gati 51 vende më lartë, nga pozicioni i 136 në atë të 85. Megjithatë, në të dhjetë kriteret ka një diversifikim shumë të madh të arritjeve, duke shënuar pozitivisht në aspektin e mbrojtjes së investitorëve, marrjes së kredisë, fillimin e një biznesi dhe duke theksuar nevojën për përmirësime të mëtejshme substanciale në: lejet e ndërtimit, lidhjen me energji dhe regjistrimin e pronës.

Grafiku 2.



Burimi: Doing Business database, 2012-2013

3. Zhvillimi i biznesit dhe sfidat

Shqipëria klasifikohet akoma në nivele të ulëta si: i) shkurtimi i mëtejshëm i procedurave për fillimin e një biznesi, ii) reduktimi i kohës për dhënien e lejes së ndërtimit; iii) numri i ditëve për furnizimin me energji elektrike; iv) numri i ditëve dhe procedurave për regjistrimin e pasurisë; v) për reduktimin e dokumentacionit në dogane; vi) për respektimin e kontratave; vii) për falimentimin, etj.

Përmirësimi i këtyre treguesve, është një nga sfidat e kësaj strategjie.

3.1 Zhvillimi i Sipërmarrjes dhe i SME-ve

Gjatë viteve të fundit qeveria Shqiptare ka ndërmarrë reforma të rëndësishme për ta kanalizuar ekonominë Shqiptare brenda sektorit formal. Hyrja në fuqi e taksës së sheshtë, vendosja e kasave fiskale, reforma në sistemin e TVSH-së, përmirësimet e procedurave të autoriteteve tatimore, suksesi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të bizneseve dhe thjeshtimi i procedurave të licencimit kanë qenë reforma shumë të suksesshme nga të cilat Shqipëria ka treguar rritje ekonomike pavarësisht krizës globale. Shqipëria, gjithashtu, në 5 vitet e fundit ka bërë kapërcim në shumicën e renditjeve globale mbi reformat dhe konkurrueshmërinë. Megjithatë, një pjesë domethënëse e ekonomisë vazhdon të mbetet në sektorin informal.

Qeveria Shqiptare me mbështetjen e komunitetit të donatorëve ka qenë lider në rajon për sa i përket përpjekjeve lidhur me qeverisjen elektronike dhe sistemi i përhapur kudo i prokurimit on line në funksionim në Shqipëri është një histori suksesi për të cilën Shqipëria është përshëndetur edhe në arenën ndërkombëtare. Përpjekje të mëdha janë duke u bërë në fushën e tatimeve, zbatimin dhe transparencën me bazën e të dhënave on line të pronave si dhe përpjekje të ngjashme janë duke u bërë në sektorin e shëndetit dhe arsimimit.


3.1.1. Situata Aktuale e Zhvillimit të Sektorit të SME-ve

Sektorin e SME-ve ka një kontribut substancial në rritjen ekonomike dhe punësimin. Bazuar në të dhënat e INSTAT (2011), kontributi i SME-ve në PBB është më shumë se 73% dhe më shumë se 71% në sektorin e punësimit.


Gjithashtu numri i sipërmarrjeve aktive në fund të 2011 ishte rreth **106.503**. Krahasuar me sipërmarrjet aktive në vitin 2005 ka një rritje prej **65%**. Numri i sipërmarrjeve që drejtohen apo janë pronare femrat është 27%.

Sipas strukturës së sipërmarrjeve aktive në vitin 2011 është vënë re që SME-të më së shumti dominohen nga mikro-ndërmarrjet me nga 1 deri në 9 punonjës, që përbëjnë rreth **95.2%** të numrit të përgjithshëm të sipërmarrjeve aktive.

Grafiku 3. SME-të sipas madhësisë




Grafiku 4. SME-të sipas sektorëve



Burimi: ASN – INSTAT 2011

Shpërndarja e sipërmarrjeve aktive sipas sektorëve ekonomikë është: tregtia **43.8 %**, hotelet & restorantet **16.1 %**, transporti & komunikacionet **10.2%**, industria **9.8 %**, ndërtimi **4.3 %**, bujqësia dhe peshkimi **1.8 %** ndërsa shërbimet e tjera zënë **14.1 %**. Është për tu theksuar se sektorët e tregtisë, hoteleve, bareve dhe restoranteve dominohen nga sipërmarrjet vendase me një zhvendosje të lehtë në vitet e fundit drejt tregtisë ndërkombëtare, veçanërisht gjatë periudhës së verës si pasojë e rritjes së turizmit në vend.

Grafiku 5. Shpërndarja e SME-ve sipas rajoneve



Burimi: ASN - INSTAT 2011

Mbi **50%** sipërmarrjeve aktive veprojnë në rajonin e Tiranës dhe të Durrësit. Në prefekturën e Elbasanit, Dibër dhe Korçës është vënë re vetëm një rritje e vogël e sipërmarrjeve duke e lënë situatën pothuajse në gjendjen e një viti më parë.

Mbizotëruese në numër janë aktivitetet në fushën e tregtisë dhe në sektorin e hoteleri – restorante me **60%**. **43.8%** e sipërmarrjeve janë në fushën e tregtisë me një rënie të vogël prej **0.6%** krahasuar me 2010. Prodhuesit e mallrave përbëjnë vetëm **16%**. Dominimi i ofruesve të shërbimeve është fenomen i zakonshëm në të gjitha prefekturat.

Krahasuar me vitin e kaluar xhiroja për vitin 2011 u rrit me **8%**. Kjo rritje prej **32.3%** erdhi nga sipërmarrjet në fushën e ndërtimit. Krahasuar me vitin 2010 prodhuesit e mallrave u rritën me **6.3%**, ndërsa ofruesit e shërbimeve, krahasuar me të njëjtin vit u rritën me **5.7%**.

3.1.2. Lehtësirat Financiare dhe Kreditimi

Sipas raportit “Të Bërit Biznes”, të Bankës Botërore 2011-2012, Shqipëria renditet e 23 në botë për lehtësinë e kreditimit.

Bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, përqindja e kreditimit të sektorit privat ndaj PBB-së në dhjetor 2012 ishte 40.2%. Përqindja e rritjes vjetore të portofolit të kredive rezultoi të ishte rreth 14%. Bankat janë financuesit më të mëdhenj të ekonomisë duke qenë se sektori bankar përbën më shumë se 95% të sektorit financiar.

Për të përmirësuar ambientin e financimit të SME-ve, në vitet e fundit janë marrë disa masa në lidhje kryesisht me futjen në fuqi të skemave të garancisë së kredive ndaj SME-ve.

✚ *Zbatimi i skemës së kreditimit të SME-ve.* Që nga nisja zyrtare e programit në Janar të vitit 2009, e deri në dhjetor 2012 kreditimi i SME-ve nga 25 milion EUR janë financuar 79 projekte të SME-ve shqiptare me një financim prej 17,4 Mil. EURO nga të cilat 10 projekte janë "Start up". Për më tepër, një fond garancie prej 2.5 milion Euro është disponibël si pjesë e Programit për Zhvillimin e SME-ve me qëllim garantimin e huadhënies bankare.

✚ *Fondi Evropian për Evropën Juglindore (FEEJ).* FEEJ ka dhënë një hua prej 20 milion EURO për Bankën Kombëtare Tregtare (BKT). Deri tani janë aprovuar 23.8 milion Euro hua për 332 klientë duke financuar kështu bizneset në disa rrethe të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme si për: kapital qarkullues, investime në inventar dhe aktive të paluajtshme. Gjendja e pashlyer e këtyre kredive është 17.9 milion Euro, ndërkohë që kanë një ecuri shlyerje shume të kënaqshme.

3.1.3. Akti i Biznesit të Vogël për Evropën (SBA)


Sipas Indeksit të Politikave të SME-ve 2012, (OECD 2012), zhvillimi i SME-ve në Shqipëri vlerësohet në 3.01 pikë (niveli maksimal i vlerësimit është 5), çka është lehtësisht më pak se mesatarja e rajonit prej 3.07 pikë.

Vlerësimi është bërë në 10 dimensionet sipas Aktit të Biznesit të Vogël, (Small Business Act, SBA⁴). Performanca e politikave të Shqipërisë gjatë periudhës 2007-2011 ka qenë mbresëlënëse dhe në krahasim me Indeksin e Politikave të SME-ve 2009 janë bërë përmirësime në 6 dimensionet: veçanërisht, në fushat e politikave lidhur me përmirësimin e klimës së biznesit (të tilla si regjistrimi i kompanive, licencimi i kompanive, reforma rregullatore, aksesit ndaj financimeve dhe promovimi i eksporteve).

Çështjet që kërkojnë përmirësim mbeten; zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe kapacitetet teknologjike të SME-ve si dhe pagesat e transaksioneve tregtare.

Grafiku 5: *Indeksi i politikave të SME-ve për Shqipërinë, viti 2012*

⁴ Në Qershor 2008 Komisioni Evropian adaptoi Aktin e biznesit të vogël, SBA, si një dokument i rëndësishëm politik. Implementimi me efektivitet i këtyre parimeve është një ndër obligimet më të rëndësishme të qeverisë shqiptare, pasi konsiderohen pjesë përbërëse e procesit të Stabilizim Asocimit me Bashkimin Evropian.



3.1.4. Ekonomia Kreative & Sipërmarrjet nga gratë

Ekonomia kreative konsiderohet si një sektor ekonomik premtues me potencialin për të kontribuar në ekonominë lokale, rajonale dhe atë kombëtare, si dhe në krijimin e vendeve të punës.

Sipas një studimi të GIZ në 2011, kontributi i ekonomisë kreative në Shqipëri shkon përafërsisht rreth 0.5% - 1% të PBB-së. Në shumicën e vendeve të zhvilluara, ekonomia artizanale kontribuon rreth 3% të PBB-së. Nga kjo kuptohet shkalla e potencialit dhe çfarë duhet që të përmirësohet në Shqipëri. Sektori kreativ ofron rreth 3,500 vende pune, ose 0.5% deri në 1% të fuqisë punëtore. 56% e të gjithë të punësuarve në këtë sektor janë gra, me përqendrimin më të madh në fushën e veshjeve (> 90%) dhe të punëve të dorës (78%). Një pjesë e madhe e të punësuarve në këtë ekonomi janë në sektorin e artizanatit me 37%.

3.1.5. Inovacioni dhe Zhvillimi i Teknologjisë për SME-t.

Shqipëria ka regjistruar një rritje të shpejtë në numrin e sipërmarrjeve, një fakt që tregon një shkallë të lartë të dëshirës për sipërmarrjen në vend.

Me suportin e projektit IPA 2007 “Mbështetja e SME-ve për tu bërë më konkurruese në tregun European”, është hartuar strategjia e Inovacionit dhe teknologjisë së biznesit. Për të konkretizuar zbatimin e kësaj strategjie, me VKM Nr.104, datë 9.2.2011 u miratua Programi Strategjik për Zhvillimin e Inovacionit dhe Teknologjisë për SME-të.

Ndërmjet metodave kryesore që përdoren në Shqipëri për inovacionin janë: Blerja e makinerive dhe pajisjeve dhe rekrutimi i personelit të kualifikuar.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në kapacitetin e firmave për të thithur teknologjinë e re janë: *klima e investimit* në të cilën ato operojnë dhe *niveli i aftësive* dhe i kapaciteteve teknologjike në firma. Në Shqipëri vetëm 10 % e të gjitha firmave të vëzhguara u japin trajnime formale punonjësve të tyre, krahasuar me 79 % të firmave Sllovaqe të përfshira në studim në 2005 dhe 48 % të firmave në Serbi (*Banka Botërore, 2009, fq. 48*).

3.1.6. Sfidat për zhvillimin e SME-ve

Bazuar në analizat SWOT, e cila gjendet më poshtë, mbi ecurinë e zhvillimit të SME-ve, konstatohet se:

- *Financimi i SME-ve:* Megjithëse nivelet e financimit të SME-ve kanë ardhur në rritje në këto vitet e fundit, gjithsesi konsiderohet i pamjaftueshëm për të nxitur një zhvillim të shpejtë të këtij sektori. Gjithashtu SME-të dhe sidomos SME-të e reja hasin mjaft vështirësi për të marrë kredi nga sektori bankar, ku kostoja e kredisë është relativisht e lartë. Kërkesat e bankave nuk janë të favorshme për biznesin, veçanërisht për nivelin e lartë të kolateralit prej 120-150% dhe interesave të larta të kredisë edhe kur kërkohet për investime në makineri e pajisje. Ende mungojnë politikat mbështetëse për bizneset start up. Mungesa e burimeve financiare alternative për SME-të, si venture capital, innovation vouchers, business angels, etj.
- *Interneti dhe tregtia elektronike:* Gjatë viteve të fundit në Shqipëri numri i SME-ve të cilat përdorimin shërbimet e internetit të gjeneratës së dytë është rritur, veçanërisht nga brezi i ri i sipërmarrësve dhe menaxherëve. Sipas AKEP⁵ në vitin 2011 shkalla e mbulimit me internet është mbi 50%, por akoma më e ulët po të krahasohet me 67.6% të vendeve të BE-së. Me gjithë përmirësimet edhe në kuadrin ligjor vetëm 10,000 biznese kanë internet me bandë të gjerë nga 100,687 biznese aktive
- *Ekonomia kreative:* ndjehet e nevojshme ndërhyrja me politika konkrete për këtë sektor siç mund të jone: i) masa rregulluese me qëllim heqjen e pengesave administrative dhe ligjore; ii) përmirësimi i sistemit të arsimit dhe trajnimit profesional (për të gjitha aktivitetet dizajnuese/projektuese, reklammat dhe zejtarinë); iii) masa nxitëse ligjore dhe financiare për mbështetjen e këtij sektori si dhe iv) përmirësimi i kapaciteteve të organizatave që prezantojnë këtë sektor.
- *Përfshirja e përgjegjësisë sociale në rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve, CSR.* Përgjegjësia sociale e korporatës është një pjesë kyçe e strategjisë së re “Europa 2020”, e cila kërkon një qasje të integruar për “një rritje të shpejtë, të qëndrueshme dhe përfshirëse”, brenda një vizioni të përgjithshëm të një ekonomie sociale të tregut⁵. Përfshirja e përgjegjësisë sociale në biznes përbën një sfidë për rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve, prandaj edhe se është një politikë e re për Shqipërinë, duhet të përfshihet në agendën e zhvillimit të qëndrueshëm të biznesit.
- *Zhvillimi i Inovacionit dhe Teknologjisë për SME-të.* Shqipëria vazhdon të mbetet prapa vendeve të tjera për sa i përket performancës së varfër në inovacion. Ndërmarrjet financojnë zhvillimet teknologjike kryesisht nga burimet e brendshme, të cilat janë të kufizuara. Ndjehet mungesa e inkubatorëve të biznesit dhe klasterave; Shqipëria tashmë është pjesë e Rrjetit Evropian të SME-ve, EEN. Zbatimi i politikave pro aktive për të mbështetur rritjen e kapacitetit të teknologjisë për ndërmarrjet, veçanërisht për SME-të mbetet një sfidë për periudhën e ardhshme 2013-2020.
- *Nxitja e sipërmarrjeve femërore.* Sipërmarrjet e drejtuara apo pronare nga femrat janë në nivel të ulët, në rreth 27% të të gjitha bizneseve aktive për vitin 2011. Mbi 90% e bizneseve të drejtuara nga gratë gjenden në sektorët e shërbimeve (tregti me pakicë, turizëm, profesione të lira etj.). Rreth 30% e të vetëpunësuarve janë femra. Përqindja e disbursimit të kredive nga bizneset e grave arriti në 25% në vitin 2011. Mungojnë politika për mbështetjen e sipërmarrjeve femërore dhe sipas raportit të “SME policy index 2012” Shqipëria vlerësohet me 2,5 pikë (nga 5 pikë maksimale).

⁵ The European Commission, Europe 2020, http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

Analiza SWOT e SME-ve:

PIKAT E FORTA :

- Zbatimi i reformës rregullatore në ndihmë të përmirësimit të klimës së biznesit dhe uljes së kostove ë të bërit biznes;
- Zhvillimi i TIK;
- Zbatimi i dokumentit strategjik të zhvillimit të SME-ve, në mënyrë të veçantë reduktimi i vazhdueshëm i barrierave administrative;
- Qendra e Regjistrimit Kombëtar, QKR, si one stop shop, ku regjistrimi bëhet në një ditë me kosto 100 ALL;
- Qendra Kombëtare e Licencimit, QKL, si një one stop shop ku shumica e licencave jepen brenda një periudhë 2-4 ditë, kurse licencat që jepen nga institucioneve e tjera lëshohen nga 10-30 ditë (pa përfshirë lejet e ndërtimit);
- Reforma Fiskale. Taksa e sheshtë 10% mbi të ardhurat personale dhe të ardhurat e korporatës.
- Krijimi i AIDA & BRIC.
- Shqipëria është bërë pjesë e rrjetit Evropian të SME-ve, EEN;
- Rritje e qëndrueshme makroekonomike.
- Trajtim i barabartë ndërmjet investitorëve vendas dhe të huaj.

PIKAT E DOBËTA :

- Mungesa e skemave mbështetëse financiare për fillimin e biznesit ;
- Akses i dobët nga ndërmarrjet dhe mikro ndërmarrjet ndaj burimeve të financimit;
- Mungesa e burimeve financiare alternative për SME-të, si ‘venture capital’, ‘innovation vouchers’, ‘business angels’;
- Mangësi në ofrimin e shërbimeve për biznesin;
- Performanca e dobët në inovacione;
- Mungesa në aftësitë teknologjike të ndërmarrjeve;
- Mungesa e hapësirave dhe parqeve industriale;
- Mungesa e inkubatorëve të biznesit dhe klasterave;
- Informaliteti në ekonomi; Mungesa e statistikave të besueshme në analizimin e treguesve ekonomikë;
- akses i kufizuar në financimin privat.
- Probleme me të drejtën e pronësisë;
- Vështirësi në marrjen e lejeve të ndërtimit, marrjen e energjisë elektrike, regjistrimin e pronës dhe pagesën e taksave;
- Nivele të ulta të R&D & kapaciteteve njerëzore (veçanërisht në fushat teknike);
- Konsultime të limituara me palët e interesuara dhe grupet e interesit;
- Menaxhimi i sistemit ISO, është arritur vetëm nga një numër i vogël i kompanive.
- Mungesa e programeve gjinore, programet mbështetëse për gratë sipërmarrëse;
- Aftësi të kufizuara në IT dhe "arsimimit", qasje në internet;

<p>MUNDËSITË :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Zbatimi i strategjisë së re për rritjen e konkurrencës së SME-ve përmes transferimit të teknologjive dhe inovacionit, si pjesë e Biznesit dhe Investimeve; -Qeveria është e përkushtuar plotësisht për të përmirësuar më tej klimën e biznesit; -Ekzistenca e Forumeve Donatore për SME-të për të koordinuar krijimin e sinergjive mes bashkëpunimit ndërkombëtar; -Funksionimi i Portalit E-government www.e-albania.al -Marrja e statusit të vendit kandidat të BE-së -Fuqizimi i shoqatave të biznesit përgjatë sektorëve dhe rritja e bashkëpunimit midis industrive dhe SME-ve; -Shqipëria mund të lëvizë e para drejt energjisë së pastër dhe praktikave të përdorimit me efikasitet të burimeve në rajonin Jug-Lindor. -Rritja e ndërgjegjësimit për qëndrueshmërinë në këtë fazë të zhvillimit sektorial. 	<p>RREZIQET :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Praktikat e padrejta tregtare konsiderohen si një nga pengesat kryesore për zhvillimin e SME-ve; -Ndryshime të vazhdueshme në legjislacionin e taksave. -Kriza ekonomike në vendet e eurozonës dhe veçanërisht nga vendet fqinje Greqi dhe Itali; -Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara. -Zbatimi i ligjit është më i rëndësishëm se sa thjesht miratimi i tyre në përputhje me legjislacionin e BE-së - Stereotipat gjinore dhe profilet profesionale gjinore në të gjitha nivelet e arsimit (sidomos në arsimin e lartë dhe profesional) që çon në mos përdorimin optimal të burimeve njerëzore dhe kufizimin e mundësive për punësim veçanërisht për gratë dhe vajzat; - Numër i vogël i grave në pozita udhëheqëse, mungesa e modeleve, mungesa e përfaqësimit në organizmat zyrtarë vendim-marrëse dhe shoqatat
---	--

3.2. Zhvillimi i Industrisë dhe i Minerave

3.2.1. Zhvillimi i Industrisë jo-ushqimore

Kjo industri ka pasur disa aspekte të veçanta në zhvillimin e saj gjatë këtyre viteve të tilla si:

- Industria metalurgjike***, që përfaqësohet nga riciklimi i skrapit të metaleve dhe prodhimi i ferro-kromit që janë rritur nga viti në vit: janë përdorur vendndodhjet ekzistuese dhe rinovimi industrial i teknologjisë, që ka bërë të mundur daljen në tregjet e brendshme, atë rajonal dhe më tej. Aktualisht përpunohen rreth 600 mijë ton skrape metali dhe prodhohen rreth 23 mijë ton ferro-krom në vit. Ekziston një potencial i madh për këtë industri në proceset metalurgjike të trajtimit të xeherorëve të bakrit dhe nikelit.
- i) ***Industria mekanike***, që përfaqësohet nga mikro ndërmarrjet me 2-5 punonjës ku prodhohen kryesisht konstruksione metalike, produkte alumini për ndërtim, pjesë të veçanta këmbimi për industri të ndryshme, etj. Numri i përgjithshëm i sipërmarrjeve në këtë industri është rreth 700. Kjo industri vë në përdorim eksperiencën profesionale të punonjësve dhe kërkesën e tregut për shërbime specifike. Zhvillimi i saj është i kushtëzuar nga zhvillimi i infrastrukturës dhe i ndërtimit. Kjo industri nuk ka arritur të zhvillojë prodhimin e pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve teknologjike të kërkuara nga disa degë të industrisë, veçanërisht nga minierat, ushqimi, duke u përqendruar këtë periudhë vetëm në sektorin e shërbimeve dhe mirëmbajtjes. Kjo përbën një nga drejtimet e zhvillimit të saj për vitet 2013-2020.
- ii) ***Industria e përpunimit të drurit*** ka traditë dhe për momentin zhvillimi i saj është normal. Produktet e kësaj industrie janë duke përmbushur çdo ditë e më shumë kërkesat e konsumatorëve me produkte druri vendi dhe prezenca e tyre është duke u bërë e dukshme edhe në tregjet rajonale. Sot industria e përpunimit të drurit numëron rreth 700 firma të

përpunimit të drurit në të gjithë vendin, 200 prej të cilave prodhojnë materiale të sharruara dhe 500 firma merren me prodhimin e mobilieve në të cilat janë të punësuar rreth 4500-5000 punonjës, me të ardhura që shkojnë rreth 20 - 22 milion Euro. Eksportet e këtyre produkteve kapin vlerën e 4 milion Euro për materialet e drurit gjysmë të fabrikuar.

- iii) **Industria kimike** e ngritur pas viteve 90 karakterizohet nga shumë sipërmarrje të vogla, të mesme, dhe të mëdha, të cilat prodhojnë produkte në fushën e industrisë kimike si bojëra, detergjente, polistirol, vajra, ngjitës për materialet e ndërtimit, etj.
- iv) **Industria tekstile dhe e veshjeve** përfaqësohet kryesisht nga prodhimi i veshjeve dhe një prodhim i vogël i tekstileve dhe materialeve të leshit duke shfrytëzuar një pjesë të ambienteve egzistuese, koston e lire të punës, eksperiencën e punonjësve. Vihet re fenomeni i kompanive me aktive të përbashkëta, kryesisht Italiane, Greke, Gjermane, të cilat përdorin edhe teknologji moderne. Në këtë degë, vlera e eksporteve për 2011 ka arritur shifrën **238.6 milion EUR**. Numri i punonjësve në fund të 2010, sipas INSTAT ka shkuar rreth **15 mijë punonjës**.
- v) **Industria e lëkurës dhe e këpucëve** përfaqësohet kryesisht nga kompanitë e përpunimit të brendshëm që punojnë me materialin e blerësve. Kjo industri ka shfrytëzuar të njëjtat mundësi si ajo e të veshjeve. Në këtë degë sipas INSTAT janë të punësuar **10.600 punonjës** dhe vlera e eksporteve për 2011 arriti **216 milion EURO**
- vi) **Industria e xhamit dhe qeramikës** përfaqësohet nga prodhimet artizanale po ashtu edhe nga poçaria e ashpër dhe pllakat hidrosanitare. Këto produkte në shumicën më të madhe, kanë trashëguar dhe ndjekin përfaqësimet më të hershme të traditës së vendit, atë të poçarisë së ashpër. Si lëndë e parë për produktet e tyre përdoret lëndë e parë vendase, niveli i artizanatit dhe teknologjia vazhdojnë të jenë duart e njeriut gjë që ndikon në rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimit. Përgjithësisht këto linja konsiderohen të vogla ku nuk punojnë më shume se dy deri në katër punonjës të specializuar.


3.2.2. Zhvillimi i Industrisë Minerare

Industria minerare pas ndryshimeve ligjore të vitit 2010, iu përgjigj me performancën më të mirë të sektorit për sa i përket zhvillimit të bazuar në tre aspekte: a) zhvillimi qëndrueshëm, b) respektimi i kërkesave mjedisore c) zhvillimi social d) përdorimin racional i burimeve minerare. Ligji i ri për minierat dhe rregulloret janë hartuar që të garantojnë zhvillimin e një procesi të qëndrueshëm minierar, me synim konsolidimin e veprimtarive minerare si një aktivitet fitimprurës, në mbështetje të prioriteteve kryesore të zhvillimit, punësimit, si dhe që të jenë garantuesit kryesor të përmirësimit të klimës së biznesit në këtë sektor.

Në vitin 2012 sasia e mineralit të prodhuar arrin në 10.3 milion ton me një vlerë prodhimi prej 110 milion USD, me një numër prej rreth 9600 punonjësish që kryejnë aktivitetet në rreth 700 objekte minerare, një vlerë investimi vjetore rreth 43 milion USD (pa përfshirë këtu investimet në industrinë e çimentos që shkojnë në disa qindra milion EURO). Mineralet tradicionale metalike përbejnë rreth 13% të sasisë së prodhimit dhe rreth 50% të vlerës së prodhimit.

Si rezultat i zhvillimeve madhore dhe reformave në dekadën e fundit disa nga industritë filluan të adaptohen me kushtet e reja: industria metalurgjike si pjesë e industrisë së përdorimit të mineraleve ka përdorur ambientet ekzistuese, për përpunimin e mineralit të kromit në koncentrate kromi dhe ferro-krom; industria e përpunimit të bakrit po ashtu përdori si aspektet e lëndës së parë, eksperiencën dhe koston e lirë të punës, duke dalë në eksport me produkt koncentrat bakri.


Grafiku 8. Vlera e Produkteve minerare ndër vite



Burimi: METE

Investimet gjatë 20-viteve të fundit kanë qenë të drejtuara kryesisht drejt minerale të ndërtimit, (lidhur me kërkesën për materiale dhe produkte ndërtimi, infrastrukture dhe çimento). Fakti që investimet në sektorin e mineraleve metalore ka një tendencë në rritje në vitet e fundit lidhet me tendencat në rritje për këto minerale në tregjet rajonale dhe globale, veçanërisht për produktet e përpunuara. Forcimi i disa sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në këtë sektor ka krijuar kapacitetet për të hyrë në tregun ndërkombëtar të minierave. Ulja e rezervave të pasura minerare, fillimi i shfrytëzimit në thellësi, domosdoshmërisht kërkon përpunimin, duke nxitur në këtë mënyrë ndërtimin e fabrikave të pasurimit, tendence e vënë re në trevjeçarin e fundit kryesisht për mineralet e kromit dhe bakrit.

Grafiku 9. Vlera e investimeve në sektorin minerar 1993-2011



Burimi: METE

Konjuktura aktuale e favorshme e çmimeve të mineraleve ka bërë që shumë investitorë të kthejnë sytë nga sektori minerar, veçanërisht ndaj mineraleve metalorë, kromit, bakrit, nikelit, hekur-nikelit dhe titano-magnetitit. Nevojat për energji janë duke vënë në dukje edhe një herë mundësinë e rihapjes së minierave të mineraleve energjetike duke llogaritur koston e energjisë së prodhuar nga to në një situatë, ku çmimi për njësi i energjisë është rritur dhe mbyllja ose ruajtja e minierave të mineraleve energjetike bëhet në situata të tjera, mundësia e parë dhe e re për sistemin tonë është balancimi i energjisë përmes Termocentraleve me kapacitet të vogël afër minierave.

3.2.3. Sfidat për zhvillimin e industrisë dhe minierave

Sfida e zhvillimit të industrisë, qëndron në orientimin e investimeve që ndikojnë në zhvillimin e produkteve dhe sektorëve me vlerë të shtuar sa më të lartë. Synohet për një thellim të mëtejshëm në procesin e liberalizimit në tregun e brendshëm, për të sjellë energji të reja për: i) zhvillimin industrial, për kërkimin dhe zhvillimin e produktit, për produktet e reja të eksportit, për kushtet e përshtatshme të zhvillimit të kulturës së sipërmarrjes, për rrjetet e biznesit, për bashkëpunimin teknologjik dhe inovacionin; ii) zhvillimit të institucioneve të tregut të kombinuara me rolin koordinues të shtetit me balancën e vendosur në funksionimin e tregut të lirë; iii) orientimin e politikave të zbatuara në drejtim të rritjes së fluksit të investimeve të huaja edhe në zhvillimin e infrastrukturës, në drejtim të shfrytëzimit të kapaciteteve teknologjike, të përmirësimit të legjislacionit, iv) përmirësimin e efijencës së shërbimeve të ofruara nga administrata publike për të mbështetur zhvillimet industriale, kërkimin dhe zhvillimin e produkteve të reja me qellim shtimin e vlerës së eksporteve të vendit dhe të biznesit;

Industria minerare përballet aktualisht me një seri sfidash që kërkojnë doemos një koordinim e partneritet të shtetit me biznesin minerar. Ky sektor duhet ti përgjigjet:

- Kërkesave gjithnjë në rritje për lëndë të para minerale në vend;
- Konjuktura aktuale favorizuese e çmimeve të mineraleve kërkon një përqendrim në mineralet metalike, krom, bakër, nikel, hekur nikel.
- Nevojat për **minerale energjetikë (qymyret)** po nxjerrin dhe njëherë në pah mundësinë e rihapjes së minierave të mineraleve energjetikë mbi bazën e përlllogaritjeve të kostos së energjisë së prodhuar prej tyre.
- Domosdoshmërisë se përmirësimit të bilancit import-eksport, duke pasur parasysh që produktet e dala nga ky aktivitet përbëjnë një potencial të madh për eksportin.
- Zhvillimit të industrive të tjera, të cilat nuk mund të mendohen të zhvillohen pa një bazë të fuqishme minerare e cila shërben për veprimtari të mëtejshme në fusha të tjera të industrisë. si asaj të çimentos, të prodhimit të materialeve të ndërtimit, industrisë metalurgjike, industrisë kimike, etj.
- Kërkesave për **plehra kimike**, si një nga elementët e zhvillimit të bujqësisë doemos kërkon një ripërtëritje të kësaj industrie me bazë minerare me aplikim të teknologjive të reja.
- Përgatitja e burimeve njerëzore të afta për menaxhimin e industrisë minerare.
- Studimi dhe projektimi i sistemeve të reja të shfrytëzimit dhe përpunimit efektiv për burimet minerale ekzistuese si edhe ato alternative, etj.
- Nevoja që duhet të paraprihen nga programe afatgjata dhe afatmesme të zhvillimit të procedurave të zbulimeve dhe kërkimeve gjeologjike, vlerësimit të rezervave sipas standardeve ndërkombëtare duke synuar programin e minierave si pjesë e planifikimit territorial dhe hartimit të hartave të zonave minerare në promovimin e tyre.
- Bazuar në iniciativën Evropiane të përdorimit eficient të burimeve, pjesë e strategjisë së Evropës për vitin 2020, Shqipëria do të synojë të jetë një vend ku burimet përdoren me efijencë fokusuar në prioritetet e mëposhtme:
 - veprimet lidhur me ndryshimin e klimës dhe efijencën e energjisë mund të rrisin sigurinë energjitike dhe të zvogëlojnë efektet nga luhajtjet e çmimit të naftës;
 - teknologjia me emetim të ulët karbonit mund të zvogëlojë ndotjen dhe shpesh sjell përfitime në termat e cilësisë së ajrit, zhurmës dhe shëndetit publik;
 - rritja e shkallës së riciklimit do të zvogëlojë presionin e kërkesës për lëndë të parë, ndihmon për ripërdorimin e materialeve me vlerë dhe do të reduktojë konsumimin e energjisë dhe të emetimeve të gazit nga nxjerrja dhe përpunimi;

- përmirësimi i produkteve mund të uli kërkesën për energji dhe lëndë të parë dhe ti bëjë këto parë dhe ti bëjë këto produkte më rezistente dhe të lehta për tu ricikluar.

3.3. Zhvillimi i Eksporteve

3.3.1. Zhvillimet në kontekstin e politikës tregtare

Politika tregtare që është pjesë e zhvillimit të eksporteve është frymëzuar nga parimet udhëheqëse dhe qëndrimi i OBT-së. Të gjitha strategjitë e politikave tregtare pas anëtarësimit në OBT-ë bazohen në (i) një dokument strategjik, që është raporti i anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë dhe (ii) Marrëveshjen e Uruguait. Përmes këtyre dokumenteve bëhet e mundur që Shqipëria përmes legjislacionit dhe praktikës së saj të brendshme të garantojë mungesën e:

- Kufizimeve sasiore mbi importet dhe eksportet, përveç rasteve të mbrojtjes mjedisore apo të ndihmës ndaj industrive të krijuara rishtazi. Gjithashtu, në raste krizash apo raste emergjente, në përputhje me dispozitat e GATT 1994 aplikohen kufizime të përkohshme, deri në stabilizimin e situatës.
- Subvencioneve për eksportet;
- Taksave në eksport;
- Ose çdo lloj ndalimi të licencave të eksportit, ndryshe nga memorandumi i ndalimit ose licencimit të eksporteve në përputhje me rregullat ndërkombëtare.

Parimet e OBT-së kanë gjetur shprehje në të gjitha marrëveshjet e tregtisë së lirë në Shqipëri. Duke filluar nga Korriku 2007 ka hyrë në fuqi marrëveshja e tregtisë së lirë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, CEFTA 2006. Sipas kësaj marrëveshjeje, Shqipëria ka një zonë plotësisht të lirë tregtie brenda vendeve të CEFTA-s ku të gjithë mallrat tregtohen pa detyrime doganore, me përjashtim të disa produkteve bujqësore me Bosnje-Hercegovinën. Pas disa raundesh negociatash kjo marrëveshje bën të mundur që:

- Eksportet Shqiptare të produkteve industriale të dalin pa tarifa doganore dhe pa kuota drejt të gjitha vendeve të CEFTA-s;
- Eksportet shqiptare të produkteve bujqësore të dalin pa tarifa doganore dhe pa kuota drejt të gjitha vendeve të CEFTA-s me përjashtimin e disa produkteve me Bosnje dhe Hercegovinën;

Duke filluar nga Maji 2008 ka hyrë në fuqi një marrëveshje e tregtisë së lirë me Turqinë që ka krijuar një zonë të tregtisë së lirë mes dy vendeve. Kjo marrëveshje bën të mundur që:

- Eksportet me origjinë Shqiptare të produkteve industriale të dalin pa tarifa doganore dhe pa kuota;
- Eksportet me origjinë Shqiptare të prodhimeve bujqësore të dalin pa tarifa doganore dhe pa kuota, (uji mineral, Vermouth, alkoli, kakao dhe produkte kakaoje, produkte pasticerie)
- Produkte me origjinë Shqiptare, me kuota eksporti, pa detyrime doganore dhe kuota për këto eksporte pa kufizime por me tarifa doganore, si vera, djathi, vezët, mjalti, bimët (përfshirë kalemata) domate, qepë, lakër dhe lulëlakër, karota; kastravec, fasule, perime të ngrira, perime të thara, bizele, erëza, shalqi dhe pjepër, fruta të ngrira, bimë medicinale, konserva peshku, çokollatë, konserva frutash dhe perimesh, lëngje frutash të konservuara, lëng domateje, akullore;


Që nga Nëntori 2011 ka hyrë në fuqi marrëveshja e tregtisë së lirë me vendet e EFTA-s. Vendet anëtare të EFTA-s janë Islanda, Zvicra, Norvegjia dhe Lihtenshteini. Kjo marrëveshje bën të mundur që:

- Eksportet me origjinë Shqiptare të produkteve industriale të dalin pa tarifa doganore dhe pa kuota;
- Eksporte me origjinë Shqiptare të disa produkteve bujqësore të dalin, sipas Vendeve Anëtare të EFTA-s me kuota dhe pa detyrime doganore, si vaji ullirit, perimet e freskëta, bimët medicinale, etj;
- Eksportet pa kufizim por me tarifa doganore për të gjitha prodhimet e tjera bujqësore.

3.3.2. Ecuria e Eksporteve

Volumi tregtar i Shqipërisë në vitin 2011 ka pësuar një rritje prej 16.1%. Në vitin 2011, volumi i përgjithshëm i tregtisë përbëhet 74% nga importet dhe 26% nga eksportet. Gjatë vitit 2011 eksportet janë rritur me 21.9% dhe importet janë rritur me 14.2%. Qe nga vitit 2006, eksporti është rritur mesatarisht me 28%⁶.

Grafiku 10: Fluksi i mallrave për vitet 2007-2011 në milion euro




Burimi: METE

Shkalla e hapjes së ekonomisë si raport i volumi tregtar ndaj GDP-se ka qenë në rritje të vazhdueshme. Në vitin 2011 ajo është rreth 58% ndaj 42% që ishte në vitin 2006. Viti 2009 është i vetmi vit në të cilin raporti i eksportit dhe importit ne GDP patën një rënie të lehtë. Që nga 2010, ky raport është rritur ndjeshëm duke arritur në vitin 2011, rreth 15% për eksportet dhe 43% importet.

⁶ Shifrat e vitit 2009 nuk janë përfshirë në këtë vlerësim

Grafiku 10-1: Shkalla e hapjes, si raport i volumi tregtar ndaj GDP-së



Përqindja e mbulimit të eksportit ndaj importit ka shënuar rritje në favor të eksportit në 5 vitet e fundit. Përqindja e mbulimit të eksportit ndaj importit për vitin 2011 është 36 % ose 1 me 3, raporti i cili deri në vitin 2008 ka qenë në shifrat 1 me 4. Bilanci i tregtisë së mallrave dhe shërbimeve është përmirësuar si raport i saj ndaj GDP, nga -24% në -22.7%.

Eksportet sipas grupeve të mallrave

Sektorët potencialë për eksportin e produkteve vazhdojnë të mbeten po ato që tashmë quhen sektorët tradicionalë:

1. *Tekstilet dhe veshjet e këmbës* mbeten një potencial i konsiderueshëm për rritjen e volumeve të eksportit. Ky sektor zë 32% të eksporteve të përgjithshme.
2. *Mineralet dhe hidrokarburet (oils)* në Shqipëri përbëjnë një tjetër potencial që për vitin 2011 ka arritur 27% të eksporteve të përgjithshme.
3. *Materiallet e ndërtimit* përbëjnë rreth 13.5% të eksporteve totale.

Eksporte sipas grup mallrave	Eksportet në milion Euro					
	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Mineralet dhe hidrokarburet	47.2	121.3	166	156	324	418.15
Tekstilet dhe veshje këmbë	344.6	380	397	367	403.6	455.6
Materiallet e ndërtimit	108.28	125.8	185.65	100.15	237.75	299.4

Burimi: METE


Eksportet e artikujve kryesore kanë një rritje të ndjeshme nga 2006, respektivisht 8,7 herë minerale dhe hidrokarbure, 1,3 here tekstilet dhe veshje këmbë, 2.8 here materiallet e ndërtimit

Eksportet sipas vendeve të destinacionit

Eksportet drejt vendeve të BE-së përbëjnë 72.5% të të gjithë eksporteve me një rritje prej 26.5% krahasuar me fundin e vitit 2010. Eksportet kryesore të vendit shkojnë në: Itali, Greqi, Spanjë, Gjermani, Maltë, etje. Siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, një nga partnerët kryesor të eksporteve tona me 53% është Italia, pastaj vjen Greqia me 5.2%, etj.

Pas vënies në zbatim të marrëveshjes CEFTA në 2011, eksportet Shqiptare drejt ***vendeve anëtare të CEFTA-s*** kanë pasuar një ndryshim të dukshëm duke zënë një peshë specifike prej 12.4% të eksporteve të përgjithshme kundrejt 10.2% që përbënin në vitin 2010. Krahasuar me 2010, në 2011, eksportet drejt vendeve të CEFTA-s u ritën me 47%. Kosova ka qenë tradicionalisht vendi kryesor i eksporteve brenda CEFTA-s, me një peshë specifike prej 60% të eksporteve të përgjithshme të CEFTA-s. Eksportet e Shqipërisë drejt ***Turqisë*** për vitin 2011 kanë zënë 7.5% të eksporteve të përgjithshme dhe janë rritur me 63% krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 11. Eksportet e mallrave sipas peshës specifike të vendit të destinacionit për vitin 2011



Burimi: METE

3.3.3. Sfidat dhe problematikat në fushën e eksporteve

Në dekadën e fundit politikat e qeverisë dhe kuadri rregullator për biznesin janë mbështetur në parimet e qeverisjes së mirë me fokus parësor transparencën, para-shikueshmërinë dhe thjeshtësinë e praktikave të zbatuara. Regjimi liberal tarifor dhe rrjeti i marrëveshjeve të tregtisë së lirë, zgjeruar me tej edhe me zgjerimin e zbatimit të parimit të kumulit të origjinës kanë mundësuar rritjen e shanseve për eksportuesit shqiptarë për të hyrë në tregje të reja.

Biznesi në Shqipëri ende përballet me shumë problematika, zgjidhja e të cilave është një domosdoshmëri duke qenë se ka një impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë Shqiptare. Nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë të prodhimit vendas, që konsiston jo vetëm në vlera të larta eksporti, por me shume diversifikim të artikujve për eksport duke rritur përmbajtjen teknologjike dhe nivelin e kualifikimit, duke ulur kështu nevojat për import, si dhe rritjen e eksporteve dhe depërtimin e produkteve “Made in Albania” në tregje të reja, janë sfida reale për kompanitë eksportuese:

- ***Rritja e kooperimit ndërmjet sektorit publik dhe privat***

Rritja e eksportit kërkon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë (nivel kombëtar dhe rajonal) dhe sektorit privat. Nevoja për të fuqizuar Agjencinë e Nxitjes së Eksporteve (AIDA), veçanërisht për SME-t eksportuese, për të pasur me shume institucione trinimi dhe kualifikimi të pajisur siç duhet me materiale trajnuese dhe eksperte profesioniste (mësues); krijim i lidhjeve të ngushta ndërmjet universiteteve, departamenteve të kërkimit shkencor që të punojnë nga afër me

3-4 sektorë që premtojnë për eksport. Nevoja për të përmirësuar nivelin e bashkëpunimit dhe kooperimit është një kërkesë imperative për t'ju përgjigjur me mire kërkesave të tregut ndërkombëtar për eksportet shqiptarë. Kompanitë eksportuese si edhe ato që ofrojnë potenciale eksportuese duhet të mbështeten me shërbime dhe sigurimin e informacionit për konkurrentet në tregun global.

- *Infrastruktura e dobët fizike*

Infrastrukturat e dobëta rrisin ndjeshëm koston e prodhimit dhe janë një pengesë e rëndësishme për eksport. Përvojat e vendeve të tregut evropian dhe disa vendeve të rajonit tregojnë se një strategji efektive eksporti, kërkon përmirësimin e vazhdueshme të infrastrukturës fizike. Duke marrë në konsideratë krijimin e të gjitha lehtësirave në sigurimin e transportit dhe marketingut të produkteve për eksport, duke filluar nga zonat rurale, qendrat e përpunimit të eksportit, furnizim pa ndërprerje me energji elektrike dhe ujë, etj.

- *Vështirësitë në plotësimin e standardeve të cilësisë*

Një sfidë e madhe për zhvillimin e eksporteve është respektimi i standardeve ndërkombëtare të cilësisë, shëndetit dhe sigurisë. Përvojat ndërkombëtare tregojnë se një mënyrë efektive për rritjen e eksportit është që të sigurohet mbështetja e kompanive eksportuese, e agjencive publike në mbështetje të eksporteve, për laboratorë të akredituar, certifikimin e produkteve, sigurimin e trajnimeve me qëllim për të arritur nivelin e nevojshëm të cilësisë.

- *Mungesa në financimin e eksporteve*

Një sistem i dobët financiar është një pengesë e madhe për të nxitur zhvillimin e eksporteve për shkak se mund të rrisë koston e transaksionit. Në veçanti, kufizimet e aksesit në kreditim paraqesin një pengesë të rëndësishme në eksporte sidomos kur mundësitë nga buxheti për sigurimin e granteve janë të limituara. Në tregun bankar pengesa kryesore qëndron në kreditimin e eksporteve, norma e lartë e interesit (i cili pjesërisht reflekton rreziqet e larta të investimeve), dhe disa çështje që lidhen me aktivitetin e vlerësimit të riskut nga ana e sistemit bankar.

- *Pengesat të tjera nga perceptimet e biznesit*

- Cilësia e ulët e produkteve dhe e shërbimit të ofruar për to.
- Aftësi menaxheriale të kufizuara për të pozicionuar produktet "Made in Albania" në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.
- Mungesa e njohurive për marketingun e produkteve, duke sjelle vështirësi për hyrjen në treg të produkteve të reja për eksport.
- Çështja e rimbursimit të TVSH-së. Mos rimbursimi i TVSH-së sjell direkt mungesën e likuiditetit të këtyre subjekteve. Prandaj ai është i lidhur me koston e rritura për shkak të kredisë, rritja e kostove për shkak të gjobave së bashku me interesin. Gjithashtu mos pagesa në kohë e taksave që vijnë për shkak të mungesës së likuiditetit. Mos rimbursimi i TVSH-së dhe problemet e fluksit të parasë, duke ndikuar në uljen e 8-12 për qind në vit të xhiros totale të bizneseve eksportuese⁷.
- Shkalla e lartë e informalitetit, e cila është e ndryshme në sektorë të ndryshëm.
- Kosto të larta të transportit për eksportimin e produkteve shqiptare. Ky shqetësim bëhet veçanërisht i ndjeshëm në tregjet e largëta më shumë se 1000 km (kryesisht tregjet e Austrisë, Gjermani, Holandë, Francë, etj) që në fakt janë tregjet më të qëndrueshme dhe më të fuqishme për eksportet Shqiptare.
- Identifikimi i partnerëve eksportues.

⁷ Studim për rimbursimin e TVSH-së për eksportuesit drejtuar nga ACIT dhe projekti 'Rritja e Shqipërisë', mbështetur nga USAID

- Besueshmëria e prodhimit (cilësia konstante, tipi, standardi, volumi, shpërndarja në kohë) në veçanti për produktet bujqësore (dhe veçanërisht për produktet bio).

3.4. Zhvillimet në Performancën e Investimeve të Huaja Direkte (IHD)

3.4.1. Vështrim i Përgjithshëm

Shqipëria është një nga liderët në thithjen e IHD-ve në Ballkanin Perëndimor. Përmirësimi i dukshëm i infrastrukturës së rrugëve, elektricitetit dhe furnizimit me ujë, përmirësimet e mëdha në shërbimet publike si dhe iniciativat të mirë të marketingut kanë tërhequr investitorë kryesorë në fushat e energjisë, hidrokarbureve dhe në infrastrukturë si edhe në fushën e shitjeve me pakicë dhe në industrinë financiare.

Ne sektorin e energjisë: Projektet koncesionare në sektorin e energjisë kanë si qëllim rritjen e prodhimit të energjisë elektrike si dhe diversifikimin e burimeve energjetike për energjitë e rinovueshme. Strategjia e qeverisë për të rritur sigurinë në furnizimin me energji, është për shfrytëzimin e të gjitha potencialeve energjetike që ekzistojnë në vend. Ky sektor ka tërhequr kompani të rëndësishme të huaja. Ndërkohë Shqipëria po lëviz drejt tregut rajonal të energjisë dhe në linjat rajonale të interkoneksionit.

Disa linja interkoneksioni janë bërë operacionale, si Elbasan-Tiranë dhe Tiranë-Podgoricë. Investime të tjera janë ato për shtrimin e kabllave nënujore me Italinë si dhe interkoneksioni i linjave Tiranë-Prishtinë, Tiranë-Shkup, që do të mbyllin "by-pasin" rajonal të transmetimit të energjisë elektrike, duke përfshirë Shqipërinë.

Në sektorin minerar, janë disa kompani të huaja që operojnë në nxjerrjen e mineralit të kromit dhe të përpunimit industrial të tij. Gjithashtu në nxjerrjen e mineralit të bakrit dhe të përpunimit industrial.

Në industrinë e naftës, Qeveria ka nënshkruar marrëveshje për zbulimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit me disa kompani ndërkombëtare. Gjithashtu investime të mëdha janë realizuar në industrinë e çimentos me prezencën e kompanive të huaja.

Fabrika e re e çimentos afër Fushe-Krujës, ka një kapacitet total prej 1,5 milion Ton në vit. Me vënien në punë të kësaj fabrike të re, jo vetëm që reduktohen nevojat për importin e çimentos por gjithashtu si një inkurajim për investime të reja në ndërtesa banimi, zhvillim infrastrukture ashtu edhe për eksport.

Zhvillimi i infrastrukturës së vendit është një prioritet i qeverisë. Në partneritet me sektorin privat, është zhvilluar dhe rehabilituar rrjeti rrugor, i cili rrit eficiencën dhe kapacitetin e linjave të transportit rrugor dhe rajonal. Autostrada kryesore e ndërtuar që shtrihet nga porti i Durrësit deri në kufirin me Kosovën, tani është bërë realitet dhe Kosova është duke zhvilluar pjesën e saj të këtij projekti të rëndësishëm, duke lidhur Shqipërinë me pjesën tjetër të tregjeve të Evropës qendrore dhe lindore. Ne shume pak vite vendi ynë do të lidhet me fqinjët kryesorë nëpërmjet një sistemi rrugor me cilësi të lartë, duke lehtësuar transportin dhe tregtinë.

Aeroporti "Nënë Tereza" i është nënshtruar modernizimit në dekadën e fundit dhe është një nga koncesionet më të suksesshme.

Shqipëria është duke modernizuar gjithashtu portet detare, duke rritur nivelin e kapacitetit dhe të eficiencës. Duke njohur vlerat e infrastrukturës portuale, qeveria ka zhvilluar një plan konkret për

t'ju përgjigjur më mirë nevojave dhe kërkesave në rritje. Nëpërmjet zhvillimit të FDI-ve, ato pritet që të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e këtij nën-sektori.


Telekomunikacioni është një ndër aktivitetet me dinamike në sektorin e shërbimit në Shqipëri. Ai është zhvilluar kryesisht nëpërmjet privatizimit dhe investimeve pasuese të bëra nga investitorët e huaj dhe në një farë mase edhe nga investimet vendase. Si rezultat i investimeve të kryera pas privatizimit, nga investitorët, numri i abonentëve të telefonisë celulare në fund të vitit 2011, arriti në 5,2 milion. Ky nivel i penetrimit të telefonisë celulare me 187% , është i ngjashëm me vendet e zhvilluara si Gjermania. Prezenca e kompanive të huaja ka bërë që të rritet konkurrenca në treg, duke ofruar shërbime cilësore më të mira, me kosto të ulët dhe të krahasueshme me rajonin. Tregu i telekomunikacionit pritet që të zhvillohet në mënyrë simultane me rritjen e bandës së gjerë dhe shërbimet 3G (internet me shpejtësi të lartë) që sigurohen nga dy operatorët Vofafon dhe AMC si dhe projekti i qeverisë “digital Albania” (AKEP 2012).

Industria e shërbimeve financiare ka bërë ndryshime rrënjësore në sajë të zhvillimit të IHD-ve. Hyrja e bankave të huaja si dhe privatizimi i bankave të vendit, ka ndikuar në konsolidimin e sistemit bankar. Në tërësi, bankat e huaja kanë luajtur një rol pozitiv, lidhur me eficiencën dhe stabilitetin e sistemit bankar në ekonomi. Ato kanë fuqizuar menaxhimin e riskut dhe qeverisjen e bankave nëpërmjet një shpërndarje eficiente të kapitalit si dhe kanë rritur konkurrencën, duke prezantuar shërbime bankare moderne dhe të sofistikuar. Megjithatë, veçoritë e përgjithshme pozitive që ofrohen nga standardet ndërkombëtare për sistemin bankar, nuk kënaqin akoma të gjitha nevojat e ekonomisë. SME-të kanë një akses të kufizuar në financim nga bankat dhe është e nevojshme që të përmirësohen skemat e garantimit të kredive. Është e rëndësishme për tu theksuar se niveli i interesit që ju ofrohet SME-ve nga bankat, është akoma i lartë për tu përballuar. Gjithashtu nga bankat kërkohet kolateral, gjë që e bën kreditimin më të vështirë në përfitim të SME-ve.

3.4.2. IHD-të në shifra

Shumë nga vendet e Evropës Lindore kanë pasuar rënie drastike të fluksit të IHD-ve në 2010, ndërsa Shqipëria ka thithur më shumë sesa në vitin e kaluar. Pas 717 milionëve EURO në vitin 2009, flukset e IHD-ve në 2010 shkuan në 793 milion Euro. Në vitin 2010 Shqipëria u rendit e dyta me shumën më të lartë të IHD-ve në EJT pas Serbisë (Grafiku 11), sipas raportit të investimeve të huaja AIR 2011.

Grafiku 11. Fluksi i IHD në Europën Juglindore në vitet 2008-2010 në Milion USD



Burimi WIR 2011

Raporti i fluksit të IHD kundrejt PBB-s është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Në vitin 2011 ai arriti në 8,1% kundrejt 3,6% që ishte në vitin 2006.


Shqipëria ka stokun relative më të ulët të IHD-ve ndërmjet vendeve të Europës Juglindore, që është ndryshe nga madhësia relative e fluksit në Shqipëri në këto vite, që nga viti 2008.

Kjo ndodh për faktin se investimet e huaja direkte në Shqipëri janë një fenomen i kohëve të fundit dhe shumica e stokut është akumuluar vetëm në vitet e fundit, ndërsa krahasuar me vendet e tjera ato kanë pritur IHD për një periudhë të gjatë kohe. Shqipëria ka pasur gjithashtu një rritje ekonomike më të shpejte se sa vendet e rajonit, gjë që ka ulur magnitudën e indikatorëve të IHD-ve kundrejt PBB-s (AIR 2011).

Në vitin 2011 Shqipëria tërhoqi investime të huaja direkte IHD 742 Mil EUR , diçka më pak se nga viti i kaluar. Ndersa për 9 muajin e vitit 2012, shifra e IHD-ve arriti në vlerë prej 551 Mil.Euro, me një rritje prej 20,3% krahasuar me të njëjten periudhë të vitit të kaluar. Sektorët më të rëndësishëm që kontribuan në vlerën e IHD-ve, janë sektori i industrisë energjisë, sektori financiar dhe telekomunikacioni. (AIR 2011)⁸.

Sektori industrial (duke përfshirë prodhimin dhe minierat) vlerëson pothuaj 50% të fluksit të IHD për vitin 2010 dhe 2011, së bashku me minierat dhe industrinë mekanike, që konsiderohen sektorët kryesor në thithjen e investimeve. Disa industri me intensitet punësimi, siç janë industria e veshjeve dhe këpucëve kanë tërhequr një numër të madh projektsh por me sasi modeste kapitali.

Grafiku 13. Hyrjet e Investimeve të Huaja Direkte 2007-2011



Burimi BSH

Sektori industrial përfaqëson sektorin kryesor në tërheqjen e investimeve të huaja për 2011 me 47%, i ndjekur nga sektori financiar me 15%, shpërndarja dhe shërbime të tjera 15%, elektriciteti dhe gazi me 14% dhe telekomunikacioni me 9% (tabela 2).

⁸ Albanian Investment Report 2011

Tabela 2. Fluksi I IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik 2007-2011


Aktivite	2007	2008	2009	2010	2011	2011 (%)
Industria	56	369	300	394	351	47%
Energjia & gazi	4	2	143	88	103	14%
Telekomunikacioni	196	-61	84	97	67	9%
Ndërmjetës Financiar	136	167	120	138	110	15%
Shpërndarja dhe shërbime të tjera	25	95	59	33	111	15%
TOTAL	480	665	717	793	742	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2011

Sektorin e shërbimeve dominohet me 58% të stokut të IHD për vitin 2010. Gjatë tre viteve IHD në sektorin e shërbimeve ka mbetur pothuaj i pandryshuar ndërsa është zgjeruar në sektorë të tjerë ekonomike. Një nga sektorët përfitues është ai i minierave. Vlera e investimeve IHD në këtë sektor është rritur pothuaj 10 herë në tre vitet, nga një vlerë të neglizhuar deri në pothuaj 13% të stokut të IHD. E njëjta situatë zhvillimi është dhe për sektorin e energjisë që ka kontributin e tij nga me pak se 1% që ishte në vitin 2008, duke arritur pothuaj në 5% në vitin 2010. Në industrinë nxjerrëse është investuar 13% e stokut të IHD-ve, ndërsa në industrinë përpunuese në 15,6%.

Grafiku 15: Stoku i IHD sipas sektorëve ekonomike

Grafiku 16. IHD sipas origjinës së vendit



Burimi; Banka e Shqipërisë, 2011

Një ndarje e detajuar e stokut të IHD-ve në sektorin e prodhimit, nxjerr në evidencë dominimin në kapital intensiv të industrive. Dega prodhuese me stokun me të lartë të IHD-ve, është prodhimi i produkteve minerare jo-metalike (materialet e ndërtimit). Ajo pasohet nga produktet e naftës, të bazuara në burimet lokale natyrore. Një tjetër objektivi i rëndësishëm investimi është prodhimi i metaleve bazike të fabrikuara, duke shfrytëzuar mineralin e vendit. Tjetër industri me investime relativisht të larta është prodhimi i ushqimeve dhe pijeve. Ajo bazohet si në importin ashtu dhe sigurimin e lëndëve të para në vend. 16% e stokut të IHD në sektorin prodhues është investuar në tekstil dhe lëkurë, aktivitete intensive nga pikëpamja e punësimit dhe me potenciale për eksport.

Industritë “high-tech”, si prodhimi i makinerive elektronike, apo automjete pothuaj mungojnë jo vetëm si objektiva investimi, por gjithashtu në tërë ekonominë e vendit.

Sipas **origjinës së vendit** të IHD-ve në Shqipëri, vendet fqinje sigurojnë shumicën e IHD-ve, ndërsa Greqia renditet e para me 27%, Italia në vendin e dytë me 15%, e treta Austria me 14%, e pasuar nga Kanada dhe Turqia me 11% (grafiku 16).

Investimet Greke janë të fokusuar në telekomunikacion dhe ndërmjetësim financiar, ku stoku i kapitalit ka pësuar rënie. Vendi i dytë, si burim IHD është Italia me 15% të stokut të IHD për vitin 2010, duke shtuar tre pike përqindjeje në tre vitet. Investimet me origjinë Italiane janë të fokusuar kryesisht në sektorët prodhues dhe ndërtim.

Gjithashtu ato janë prezent në sektorin e shërbimeve, kryesisht në sektorin financiar. Një dukuri e veçantë e investimeve Italiane është se ato përfaqësohen me ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Austria është vendi i tretë si burim investimesh me 14% në vitin 2010, duke u rritur me 6 pikë përqindje që nga vitin 2007. Pothuaj të gjithë investimet Austriake janë në sektorin bankar si dhe në industrinë e hidrocentraleve elektrike. Kanadaja renditet në vendin e katërt si investitor për vitin 2010, pjesërisht me Bankers Petroleum Ltd, një kompani kanadeze në fushën e eksplorimit të naftës dhe gazit.

Numri i kompanive të huaja dhe atyre joint-venture sipas INSTAT, në fund të vitit 2011, numëron deri në 3572 ndërmarrje, që përfaqësojnë 3,2% të numrit total të ndërmarrjeve aktive në vend.

Një ndarje e këtyre ndërmarrjeve të huaja sipas sektorëve ekonomike është; 32% në sektorin e tregtisë, 23% në industri, 25% në shërbime, 11% në ndërtim, 6% në transport dhe komunikacion, 3% në hotele, kafe dhe restorante dhe 1% në bujqësi dhe peshkim.

Në disa aktivitete, degët e kompanive të huaja përbejnë pjesën më të madhe të këtyre kompanive, p.sh. më shumë se gjysma e tyre operon në nxjerrjen e naftës, më shumë se një e treta e tyre në sektor ndihmës për prodhimin e pajisjeve të transportit, produkte elektrike dhe makineri, për naftën, gazin dhe energjinë. Këto janë aktivitete me investime të larta kapitale, ku SME-t me pronësi lokale janë të rralla. Ndërsa në aktivitete të tjera, siç është tregtia me pakicë, hotele dhe restorante, prezenca e SME-ve lokale është dominante në numër.

3.4.3. Sfidat për zhvillimin e Investimeve të Huaja Direkte

Me qëllim për të arritur objektivat në fushën e investimeve të huaja, ekonomia e Shqipërisë ka përballë një numër sfidash, që do të bëhen përpjekje për të thithur investime të huaja, duke marrë në konsideratë tregun e vogël dhe fuqinë blerëse të kufizuar, që mund të frenojë investitorët e mesëm dhe të mëdhenj. Nga ana tjetër konkurrenca e madhe që ekziston nga vendet fqinje të cilët po ndjekin një strategji agresive në nxitjen e investimeve të huaja.

Sipas Treguesve të Bankës Botërore të Qeverisjes Botërore (WGI), tregu vendas perballë akoma me forcimin e ligjit, ndjekur nga kontrolli ndaj korrupsionit, efektivitetin e qeverisjes dhe cilësinë rregulluese. Në kritere specifike, Shqipëria është ende larg, në mënyrë të veçantë për sa i përket lejeve të ndërtimit, pagimit të tatim-taksave, sigurimin e titujve të pronësisë, zbatimit të kontratave, etj.

Shqipëria ka ende një nivel të ulët shpenzimesh për kërkimet shkencore dhe inovacionin, nivel të ulët të inovacionit dhe teknologjive, të sofistikimit të biznesit, si dhe nivel të ulët të kuadrit të zhvillimit të industrisë së klasterave dhe inkubatorëve teknologjike.

Për të përmirësuar më tej konkurrueshmërinë e Shqipërisë si një destinacion për investime të huaja dhe në sektorët prioritarë, kërkohet thellimi i reformave, në adresimin e pengesave të ndryshme ndaj investimeve siç janë:

- *Zbatimi i ligjit dhe kuadrit rregullator.*

Megjithëse Shqipëria është pjesë e shumë marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në investime, duhen gjykata të specializuara në çështjet tregtare dhe që të jenë edhe në rrethe të ndryshme përveç kryeqytetit. Nga ana tjetër kërkohet rritja e kapaciteteve në gjykata dhe zhvillimin e mekanizmave alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

- *Sigurimi i titujve të pronësisë.*

Shume prona nuk mund të regjistrohen me tituj të pastër pronësie, për shkak të pengesave ligjore të shkaktuara apo nga mangësitë në zbatim të ligjit, nga mungesa e procedurave të sakta dhe mos zbatim i ligjit. Mungesat në regjistrimin e pronësisë, pengojnë sigurinë e pronësisë si dhe zhvillimin ekonomik. Qeveria do të adresojë këto çështje që lidhen me thjeshtimin e procedurave të regjistrimit, me standardizimin e kontratave të shitblerjes, zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve të teknologjisë së informacionit për një bashkëpunim më të mirë ndërmjet institucioneve të përfshira dhe disponueshmërisë së dokumenteve on line për verifikim dhe transparence.

- *Zhvillimi i zonave ekonomike dhe parqeve industriale*

Deri tani janë miratuar me vendim qeverie 10 zona ekonomike, prej të cilave 9 janë me statusin e parkut industrial dhe nje si zonë e lirë ekonomike.

- *Nevoja për një fuqi punëtore të kualifikuar* për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të punës dhe investitorëve të huaj.

Vërehet një boshllëk ndërmjet nevojave të biznesit privat dhe të diplomuarve të arsimit të lartë, mangësi në sasi dhe cilësi në shkollat e nivelit të dytë dhe universitete, për fuqi punëtore të kualifikuar, për trajnime të kualifikuara si dhe për institucione menaxhimi të biznesit.

- *Ekonomia informale* mbetet në nivele të larta dhe dëmton mjedisin e të bërit biznes për shkak të konkurrencës së pandershme që firmat hasin në treg. Me gjithë progresin dhe bashkëpunimin e institucioneve përgjegjëse si Drejtoria e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror i Punës, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes, Sindikatat dhe Dhomat e Tregtisë, mbetet akoma shume për të bërë.

- *Rritja e Efiçencës së administratës publike në nivel qendror dhe lokal.*

Burokracia dhe niveli i shërbimit si dhe ngritja e kapaciteteve të administratës publike mbetet një faktor i rëndësishëm për klimën e investimeve në përgjithësi. Më shumë vëmendje duhet ti dedikohet qëndrueshmërisë së institucioneve publike, nga niveli politik bërës tek ato që e zbatojnë, duke shmangur ne çdo rast largimet dhe larg politizimit të administratës publike.

- *Forcimi i të drejtave të pronësisë intelektuale*

Investitorët në përgjithësi dhe ata të huaj në veçanti janë të ndjeshëm ndaj respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, e cila në Shqipëri është në nivele të ulta.

4. Risqet që kushtëzojnë suksesin e zbatimit të kësaj strategjie

- ***Ecuria e procesit të Asocim Stabilizimit me Bashkimin European.***

Në tërësi Shqipëria vazhdon të zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga MSA. Hapja e negociatave për marrjen e statusit të vendit kandidat, plotësimi i objektivave të përcaktuara nga Komisioni European, është njëkohësisht një kusht i rëndësishëm në financimin e projekteve nga Bashkimi European, duke ndihmuar në zbatimin e masave të parashikuara në këtë strategji.

- ***Programi i reformave në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit***

Ndërmarrja e reformës rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit, Qeveria e konsideron si një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Që nga Marsi i vitit 2006 kur është miratuar Plani i Veprimit janë përcaktuar çështjet kryesore për tu reformuar, hapat që duhet të

ndiqen për përmirësimin e ambientit rregullator në funksion të shërbimeve të ofruara ndaj biznesit, si dhe zhvillimin, administrimin dhe monitorimin e reformës rregullatore, me qëllim zbatimin e saj në mënyrë sa më efektive. Qëllimi i kësaj reforme institucionale edhe për vitet që pasojnë është për të garantuar në vazhdimësi thellimin e reformave. Këto reforma, që në themel lidhen me rritjen e transparencës, uljen e kostos së të bërit biznes, efektivitetin e institucioneve publike dhe shërbimit të ofruar prej tyre, si dhe rritjes së performancës institucionale, përbëjnë sfidën reale në procesin e zhvillimit ekonomik dhe integritet të vendit.

- Sinergji efiçiente në të gjitha veprimtaritë për rritjen e imazhit të Shqipërisë në nivelet ndërkombëtare.

Një mungesë sinergjie ndërmjet institucioneve që kontribuojnë në rritjen e imazhit të Shqipërisë nëpër botë (AIDA,AKBN, Agjencia Kombëtare e Turizmit, etj) do të kishte pasoja negative, në tërheqjen e investimeve të huaja si dhe në krijimin e zonave dhe parqeve industriale me mbështetjen e investitorëve të huaj, që përbejnë ndër kapitujt më të rëndësishëm të kësaj strategjie.

- Konkurrueshmëria e produkteve dhe shërbimeve, garantohet nga funksionimi i një sistemi inovacioni në nivel kombëtar.

Ekzistojnë shumë aktore dhe agjenci të specializuara si AKTI, BRIC, Qendrat Kërkimore Shkencore, Labororë dhe katedrat e universiteteve dhe shumë struktura të tjera që operojnë dhe kontribuojnë në krijimin e një sistemi kombëtar inovacioni. Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe rritja e efektivitetit të AIDA/BRIC, është një kusht i domosdoshëm që t'i përfshijë plotësisht bizneset në dinamikën e inovacionit, d.m.th në procesin e përthithjes së zhvillimit teknologjik, sikurse edhe të sigurojë ndërveprimet e plota me aktorët e tjerë të interesuar. Mungesa e projekteve apo dhe fondeve nga buxheti për BRIC, do të rrishte zbatimin e masave të parashikuara në këtë strategji.

- Sigurimi i fondeve të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve dhe masave përkatëse në funksion të objektivave të kësaj strategjie.

Realizimi i objektivave të kësaj strategjie do të varet edhe nga sigurimi i fondeve përkatëse. Kostot e parashikuara për realizimin e objektivave do të përballohen pjesërisht nga buxheti i shtetit, ndërsa për shumë nga masat do të kërkohen financime nga institucionet financiare ndërkombëtare, agjencitë e huaja të zhvillimit, donatore të tjerë. Risku këtu qëndron, në respektimin e alokimit të fondeve apo në devijimin e tyre në raste fatkeqësish të ndryshme natyrore.

Një pjesë e kostove, në varësi të masave do të mund të përballohet gjithashtu duke stimuluar programe dhe projekte në partneritet me sektorin privat, nëpërmjet realizimit të projekteve PPP.

II. VIZIONI, QELLIMET DHE POLITIKAT E STRATEGJISE

1. Vizioni i Strategjisë

“Një Shqipëri konkurruese, me një sipërmarrje dinamike dhe industri produktive”.

Kjo strategji është e zbatueshme në nivel kombëtar dhe rajonal. Ajo do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të rajoneve, bazuar në avantazhet konkurruese që mund të ofrojnë vetë këto rajone, ku vizioni i saj do të konkretizohet në :

- *Një Shqipëri Konkurruese:* Synimin drejt një ekonomie gjithnjë e më konkurruese dhe dinamike, për më shumë investime të huaja, për të rritur diversifikimin e eksporteve, dhe për të ofruar krijimin e bizneseve të reja. Nevoja për të përmirësuar vazhdimisht pozicionin konkurrues të Shqipërisë kundrejt fqinjëve të saj rajonalë, partnerëve Evropianë dhe në nivel global është tashmë ambicie kombëtare. Vëmendja do të përqendrohet drejt avantazheve konkurruese natyrore të Shqipërisë, përmirësimit të produktivitetit të burimeve njerëzore dhe natyrore të disponueshme, mobilizimit të potencialeve të pashfrytëzuara të Shqipërisë për sa i përket burimeve natyrore, tokës bujqësore dhe zhvillimit të turizmit, pozicionit gjeostrategjik për tregtinë dhe transportin dhe zhvillimin e energjisë si parakusht për rritjen e prodhimit industrial. Krijimin e një partneriteti midis qeverisë dhe biznesit në lidhje me nevojat për përmirësimin e teknologjisë, inovacionit dhe aftësisë për të përgatitur “Force punëtore të kualifikuar”.
- *Një vend që stimulon zhvillimin e sipërmarrjes dhe SME-ve:* Përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe investimeve, reduktimin e barrierave administrative dhe kostos së biznesit, si baza me e sigurt në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese. Deri në vitin 2020 Shqipëria do të përmirësojë kuadrin legjislativ dhe institucional për SME-të duke u përqendruar në çlirimin e potencialit sipërmarrës të bizneseve të saja të vogla dhe të mesme. Shqipëria aspirojnë që të jetë lider në rajon lidhur me parametrat kryesorë globalë mbi ambientin miqësor ndaj biznesit dhe benchmark-eve të tilla si raporti i BB-së ‘Të Bërit Biznes’ dhe Akti i Biznesit të Vogël të BE-së.
- *Zhvillimin e një sektori industrial dhe minerar produktiv,* i aftë për të përpunuar lëndët e para në vend dhe rritjes së vlerës së tyre, nëpërmjet nxitjes së investimeve dhe aplikimit të teknologjive të reja, prodhimit të pastër, rritjes së profesionalizmit dhe punësimit, që stimulon krijimin e bazës së një industrie konkurruese. Deri në 2020 Shqipëria do të realizojë potencialin e saj të plotë industrial përmes kombinimit të potencialit të pasur minerar dhe potencialit të prodhimit të energjisë. Synon drejt një prodhimi të integruar të mallrave industriale të gatshme për eksport drejt tregjeve botërore. Synohet që të shfrytëzohet pasuria minerare në një shkallë gjithnjë e më rritje duke mbështetur investitorët në fushën e minierave me menaxhimin e shpejtë dhe eficient të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me licencat dhe lejet, të rritet zinxhiri i vlerës së shtuar industriale brenda vendit duke përdorur burimet e energjisë. Është në interesin e vendit që të ndërtohet një themel i fortë industrial brenda Shqipërisë dhe me synim për të koordinuar me kapacitetet ekzistuese industriale të fqinjëve të tij si Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia, për tu bërë pjesë e dobishme industriale rajonale me drejtim të integruar.
- *Një Shqipëri e hapur drejt tregjeve rajonale, Evropiane dhe globale*
Brenda 2020 Shqipëria synon të jetë e integruar plotësisht drejt tregjeve rajonale, Evropiane

dhe globale. Brenda 2020 Shqipëria do të jetë një pjesë e rëndësishme e Tregut të brendshëm Evropian me të gjitha përfitimet dhe forcat konkurruese të tij. Do të rivlerësohen avantazhet konkurruese, potencialet eksportuese të saj si dhe mundësitë për tregje të reja për produktet “Made in Albania”.

Do të punohet për zhvillimin e potencialit të plotë të saj, duke përfituar nga marrëveshjet e tregtisë së lirë, kryesisht me Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin Europian. Synohet që brenda vitit 2020 nëpërmjet rritjes së konkurrues mërisë, diversifikimit të produkteve për eksport të rritet shkalla e penetrimit në këto tregje.

- *Shqipëria lider në fushën e IHD-ve në Europën Juglindore:*

Brenda vitit 2020 Shqipëria aspiron të jetë destinacioni kryesor i investimeve në Ballkanin Perëndimor, si një vend kryesor për biznesin ndërkombëtar, në nivele të barabarta me konkurruesit e tjerë rajonalë. Duke u bazuar mbi historitë e suksesit të dekadës së fundit Shqipëria aspiron nivele të larta të flukseve të IHD-ve në shkallë rajoni. Do të përmirësohen fushat sfiduese si; sundimi i ligjit, zbatimi i kontratave, të drejtat e pronësisë, mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe zbatimi i normave të tregtisë me qëllim thithjen e kapitalit të huaj si në shërbime ashtu dhe në sektorin e teknologjisë, thelbësore kjo për mbajtjen në Shqipëri të elitës së re të arsimuar.

2. Qëllimet e Strategjisë

“Hartimi dhe zbatimi i politikave që ndikojnë në rritjen dinamike dhe zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të industrisë, minierave dhe SME-ve , në përputhje me strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim, respektimit të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin social, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë nëpërmjet nxitjes së investime vendase e të huaja, eksporteve, aplikimit të teknologjive të reja, forcimit të institucioneve, specializimit të fuqisë puntore, penetrimit në tregjet e hapura rajonale, europiane dhe më gjerë”.

Strategjia bazuar në qëllimet e saj do të orientohet sipas disa drejtimeve kryesore specifike :

i) *Rritja e kapacitetit të kompanive lokale për thithjen e njohurive të reja dhe përvojës në nxitjen e investimeve.* Përmirësimi dhe krijimi i rrjetit të bashkëpunimit ndërkombëtar (internacionalizimi) nëpërmjet rrjeteve profesionale midis partnerëve të biznesit, të shkëmbimit të njohurive, të mësuarit dhe zhvillimit të menaxhimit, marketingut dhe aftësitë e tjera të biznesit si zbatimi i metodave për rritjen e produktivitetit, përgatitja e punëtorëve të kualifikuar, etj.

ii) *Ofrimi i produkteve dhe shërbimeve bazuar në eficiencën e burimeve dhe prodhimin e pastër,* si një parakusht që do të çojë në ristrukturimin e industrive jo ushqimore, ashtu edhe në sektorin e minierave, duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë në lidhje me tregjet e synuara, diversifikimin e produkteve për eksport. Masat dhe aktivitetet e ndërmarra do të krijojnë bazat për një pozicionim real të industrisë së vendit kundrejt tregut global, drejt zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve të reja, mbështetur në një infrastrukturë të qëndrueshme.

iii) *Zhvillimit të biznesit inovativ,* që bazohet në kërkimin dhe zhvillimin e njohurive si nga sektori publik ashtu dhe privat. Nxitja dhe bashkëpunimi ndërmjet shkencës me sektorin e industrisë dhe minierave, bashkëpunimin me universitetet dhe qendrat e kërkimit shkencor, zhvillimi i infrastrukturës teknologjike, krijimi i zonave dhe parqeve industriale, rritja e aplikimit të teknologjive të reja, dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale.

iv) *Zhvillimi i SME-ve dhe sipërmarrjes*, me rritjen çdo vit të numrit të ndërmarrjeve të reja dhe atyre inovative dhe nëpërmjet një financimi më të mirë. Duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme klimën e biznesit, në nxitjen e shpirtit të sipërmarrjes, të mësuarit gjatë gjithë jetës. Ky proces zhvillimi do të shoqërohet me futjen e instrumenteve të reja financiare, për të gjitha SME-të dhe në veçanti në mbështetjen e atyre bizneseve që drejtohen nga femra apo që janë në fazën fillestare të tyre (start-up).

v) *Zhvillimi i grupimeve industriale nëpërmjet klasterave*, nëpërmjet bashkëpunimit të institucioneve publike dhe private, duke u fokusuar si në inovacion, marketing, menaxhim, zhvillimin e inkubatorëve teknologjike, pjesëmarrja në trajnime të përbashkëta më të gjithë zinxhirin e aktoreve të organizuar në bazë klasteri, duke zhvilluar aktivitete partnersiteti në tërë zinxhirin e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve sipas grup klasterave.

vi) *Zhvillimin e ndërmarrjeve për shfrytëzimin e lëndëve të para minerare* me rezerva të mjaftueshme për zhvillimin e proceseve të nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve deri në produkte përfundimtare konkurruese në tregun rajonal dhe atë global.

3. Politikat kryesore të strategjisë

3.1. Politikat e zhvillimit të sipërmarrjes dhe SME-ve:

Politikat e zhvillimit të SME-ve do të hartohen në përputhje me të gjitha aktet dhe marrëveshjet e MSA dhe partneritetit Evropian si dhe të Aktit të Biznesit të Vogël/SBA.

Drejtimet kryesore të Politikës për zhvillimin e SME-ve gjatë periudhës 2013-2020, do të fokusohen në drejtim të:

- Përmirësimin e klimës së biznesit dhe thjeshtimit të mëtejshëm i legjislacionit
- Nxitjes së kulturës së sipërmarrjes në të gjitha nivelet
- Nxitjes së formalizimit të SME-ve
- Përmirësimi i aksesit në financë të SME-ve.
- Nxitjes së grave në biznes
- Mbështetjes së start-up
- Përmirësimi i dialogut dhe partneriteti publik-privat
- Nxitjen e një modeli të rritjes “green” për SME-të
- Nxitjes së biznesit social.

Përmirësimi i konkurrenshërisë së SME-ve dhe inovacioni.

Inovacioni është mjaft i rëndësishëm në rritjen e konkurrenshërisë së ekonomisë. Deficitet e inovacionit janë konstatuar në sektorët kyç të ekonomisë sonë edhe pse një rritje e shpejtë është konstatuar në sektorin e IT, e cila është duke u përhapur në sektorin e SME-ve. Qeveria shqiptare është e angazhuar për përhapjen e sipërmarrjes dhe inovacionit në të gjithë sektorët ekonomike dhe SME-të e sipërmarrësit duhet të marrin një rol të veçantë udhëheqës në këtë proces. Gjenerimi i inovacionit brenda ndërmarrjes është i rëndësishëm. Një faktor vendimtar në kapacitetin e firmave për të absorbuar teknologji të përparuara është klima e investimeve në të cilat ato veprojnë. Kjo përfshin njohuritë, infrastrukturën si dhe Financimin.

Nxitjes së kulturës së sipërmarrjes dhe edukimit për sipërmarrjen. Burimet njerëzore dhe inovacioni janë të lidhura ngushtë. Përdorimi me efektivitet i potencialeve njerëzore është thelbësor për progresin ekonomik të vendit. Mësimi për sipërmarrjen është një nga kompetencat kyçe në nivel evropian dhe duhet të përfshihet në të gjitha nivelet e edukimit që nga niveli primar, sekondar, i mesëm dhe i lartë. Kjo reformë është afatgjatë. Procesi përfshin jo vetëm reformën në

kurrikula në të gjitha nivelet, por edhe një numër programesh për nxitjen e kulturës së sipërmarrjes nëpërmjet trajnimeve.

Përmirësimi i aksesit në financë të SME-ve. Përmirësimi i aksesit në financim i SME-ve është mjaft i rëndësishëm për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë. Një rëndësi të veçantë merr rritja e përmirësimi i skemave të garantimit të kredive. Nxitja dhe fuqizimi i tregut të lizingut. Implementimi i ligjit të faktoringut. Kuadër ligjor për nxitjen e skemave të investimit me venture capital dhe business angels. Kompanitë shqiptare të kenë akses në tregun e kapitaleve.

Zhvillimi i infrastrukturës së SME-ve. Është e nevojshme krijimi i inkubatorëve për start up. Këto inkubatorë duhet të ofrojnë hapësira fizike si dhe të japin shërbime në mbështetje të bizneseve. Është e nevojshme krijimi i klasterave në sektorët kyç duke mbështetur platformat e bashkëpunimit. Bashkëpunimi strategjik midis ndërmarrjeve të ndryshme dhe nxitja e shërbimeve të përbashkëta dhen krijimi i zinxhirit të vlerave do të sjellin internacionalizimin e SME-të dhe akses në tregje të reja.

Përmirësimi i shërbimit ndaj biznesit. Ka një rëndësi të veçantë përmirësimi dhe rritja e shërbimeve ndaj biznesit nëpërmjet kompletimit dhe fuqizimit të portalit për SME-të ashtu si dhe qendrës së informacionit për biznesin; realizimin e nevojave për trajnime, TNA, çdo dy vjet; përmirësimi i shërbimit on line për trajnimet; menaxhimi i skemave financiare për ndarjen e kostove, etj.

3.2. Politikat industriale dhe minerare

Politika industriale është prioritet politik strategjik kombëtar i Qeverisë Shqiptare me synimin e përmirësimi të konkureshmërisë së industrisë Shqiptare përmes koordinimit të politikave dhe ndërhyrjeve të ndryshme. Politikat industriale, të cilat mbulojnë sektorët jo ushqimorë të industrisë dhe sektorin minerar, janë prioritetet e qeverisë sepse këto sektorë përbëjnë 7.2% të PBB-së së vendit. Industria është zhvilluar kryesisht nga sektori privat, i cili është kontribuesi më i madh i rritjes ekonomike me 80% të PBB-së.

Politikat e zhvillimit të industrisë do të fokusohen në disa fusha:

- Promovimi i investimeve lokale dhe të huaja në përdorimin e lëndës së parë natyrore me qëllim zhvillimin e industrisë kombëtare të prodhimit dhe përpunimit me produkte konkurruese në rajon dhe në botë me një rritje vjetore prej 5 %.
- Stimulimi i veprimtarive inovative për të ndihmuar industrinë në rritjen e prodhimit,
- Mbështetje konkurruese duke siguruar bashkëpunim me të gjitha institucionet publike e private në mbështetje të këtij sektori. Promovimi i bashkëpunimi midis enteve për drejtimin e veprimtarive kërkuese, një nxitje për të siguruar bashkëpunimin midis universiteteve dhe sektorit të industrisë. Gjithashtu në këtë kuadër do të mbështesë projektet e përbashkëta të grupeve të kompanive dhe enteve në përmirësimin e veprimtarive të kërkimore-shkencore dhe universiteteve.
- Komercializimi dhe stimulimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në fushën e zhvillimit industrial. Mbështetja së bashku me sektorin privat e projekteve me bashkë-financim, promovimi i dizajnit industrial dhe marketingut të produkteve dhe shërbimeve të reja.
- Stimulimi i zhvillimit të burimeve njerëzore, mbështetja për trajnimin e inxhinierëve dhe zhvillimi dhe trajnimi i personelit teknik, zhvillimi i kurseve trajnuese në sektorët konkurrues.

- Promovimin e transferimit të teknologjive, zbatimin e stimujve fiskalë duke inkurajuar zvogëlimin e pengesave dhe kostove të importit.
- Veprimtaritë për rritjen e ndërgjegjësimit në aplikimin e punës kërkimore, zhvillimin dhe inovacionin në industri;
- Stimulimi tregtisë të produkteve dhe shërbimeve të reja në fushën e dizenjos së produkteve;
- Mbështetja e industrisë për zhvillimin e kërkimeve për forcimin e konkurueshmërisë së tyre lidhur me teknologjinë dhe inovacionin;
- Stimulimi i transfertës së teknologjisë së re duke eliminuar pengesat e importit dhe bashkëfinancimin e kostove për teknologjinë që do të rrisë prezantimin e produkteve dhe shërbimeve të reja me një vlerë të shtuar; dhe
- Mbrojtje e të drejtës së pronësisë industriale dhe intelektuale.

Politikat e Zhvillimit të minierave do të fokusohen:

Konjuktura aktuale e favorshme e çmimeve të mineraleve ka bërë që sytë e shumë investitorëve të drejtohen nga industria e minierave, veçanërisht nga mineralet metalore si kromi, bakri, titano-magnetitet, nikeli dhe hekur-nikeli. Kësaj situatë është e nevojshme ti përgjigjemi me politika pragmatike, afatgjata duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë e çmimeve në një treg ndërkombëtar. Ekziston nevoja e kapitalit dhe orientimit të investimeve drejt prodhimit sasior të mineraleve të kromit, nikelit, bakrit, titano-magnetiteve dhe përfitimet aktuale të drejtohen drejt rritjes së shkallës së përpunimit dhe prezantimit të produkteve të reja në treg në mënyrë që në të ardhmen të ngrihet një mbrojtje ndaj luhatjeve periodike të çmimeve në tregun ndërkombëtar. **Bakri** si një mineral i rëndësishëm duhet të kthehet në ciklin e tij të plotë për ti rritur vlerën si dhe përmes zgjerimit të rezervave të tij nga minierat egzistuese dhe zbulimeve të vendburimeve të reja. **Kromi** duhet që të shkojë drejt përpunimit duke eliminuar në maksimum eksportin e tij si mineral dhe rritjen e eksportit të tij si ferro-krom, zgjerimi i rezervave të kromit nëpërmjet futjes në qarkullim të kromiteve të varfëra nëpërmjet pasurimit, trajtimit e tij për prodhimin e koncentrateve të kromit dhe produktit ferrokrom.

Titano-magnetitet duhet të fillojnë nga shfrytëzimi dhe përpunimi i mëtejshëm i mineralit për daljen me një produkt të ri në tregun evropian dhe global. **Nikeli** duhet të çlirohet nga faza e kërkim-zbulimit dhe duhet të zhvillohet drejt shfrytëzimit dhe proceseve metalurgjike, duke krijuar një potencial të ri për ekonominë, aktualisht duke përdorur kapacitetin e lirë të impianteve të përpunimit metalurgjik në rajonin e Ballkanit (Maqedonia, Kosova, Greqia, etj.) dhe në të ardhmen e afërt me synimin e ngritjes së dy uzinave metalurgjike në vend. Prodhimi i produkteve të reja nga përpunimi i **gurit gëlqeror** për industrinë kimike, bujqësinë, etj, konsiderohet akoma potencial i pazhvilluar. Nevoja për **mineralet energjitike (qymyri)** nxjerrin në pah përsëri edhe një herë mundësinë e rihapjes së minierave për mineralet energjitike bazuar në llogaritjet e kostos së energjisë prodhuar nga ato. **Rerat bituminoze** dhe përpunimi i tyre një potencial që do të ndikojë në mënyrë progresive në potencialin energjistik të vendit dhe në zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe ndërtimit.

Duhet vënë në dukje që në një situatë ku çmimi për njësi i energjisë është rritur dhe mbyllja apo ruajtja e minierave të mineraleve energjistik është bërë në situatë të tjera, është krijuar një situatë e re për sistemin tonë për të balancuar energjinë përmes termocentraleve me kapacitete të vogla pranë minierave.

Nevoja e përmirësimit të balancës së import-eksportit, duke pasur parasysh që produktet që rrjedhin nga ky aktivitetet përbëjnë një potencial të madh për eksport. Megjithatë për momentin niveli aktual i përpunimit të mineraleve dhe vlerat e eksportit mund të jenë të ulta për sa i përket tendencave të përpunimit duhet të promovohen dhe inkurajohen shitja e produkteve të përpunuara

me çmime më të larta. Në këtë kontekst duhet të merret në konsideratë fakti që prezantimi në tregjet Evropiane duhet të bëhet me produkte që mungojnë në këto tregje apo ku konkurrenca nuk është shumë e lartë dhe produktet minerale janë produktet e para me të cilat ne mund të hyjmë në këtë treg siç është provuar nga tradita të mëparshme ku rreth 40% e eksporteve tona përbëhej nga prodhimet minerale.

Zhvillimi i industrive të tjera nuk mund të ndodh pa pasur një bazë minerare të fortë që shërben për veprimtari të mëtejshme në fusha të tjera të industrisë, si çimentoja, prodhimi i materialeve të ndërtimit, industria metalurgjike, industria kimike, etj. Vetëm në tregun vendas kërkesa për materiale gipsi, qeramikë dhe çimento është disa qindra milion dollarë dhe ky treg edhe sot përmbushet në një pjesë të tij nga importi, kur vendi ynë jo vetëm ka mundësinë të mbulojë këtë treg me këto materiale, por është në gjendje të jetë një burim kryesor i eksporteve për rajonin, BE-në dhe më tej.

Kërkesa për **plehra kimike**, si një nga elementët e zhvillimit të bujqësisë domosdoshmërisht kërkon një përtëritje të kësaj industrie në aplikimin e teknologjive të reja në minierat kryesore dhe përpunimin e mineraleve të tyre.

Ky sektor është duke u përballur aktualisht më sfida lidhur me prodhimin e brendshëm dhe tregun global duke qenë se tregu i minierave është një treg global. Rritja e kostos së prodhimit duhet të përballlet me rritjen e prodhimit dhe të kapaciteteve përpunuese, duke zbatuar mekanizma të teknologjisë së avancuar, automatizimin dhe rritjen e nivelit të profesionalizmit në funksionimin e minierave dhe të impianteve të përpunimit.

Rritja e konkurrencës në një treg të lirë me konkurrentë ndërkombëtare për prodhimet minerale, përballohet duke dalë në treg me produkteve të reja nga përpunimi i mineraleve apo shfrytëzimi i mineraleve të rinj, që mungojnë në tregjet rajonale dhe Evropiane, duke luftuar tendencën për monopol në këtë fushë, duke mënjeluar që në shfaqjet e para tendencat për të bllokuar burimet e përdorshme minerale përtej kohës së përshkruar në Ligjin e Minierave, duke eliminuar mungesën e veprimtarive të kërkim-zbulimit dhe copëzimin e vendburimeve, duke siguruar mbikëqyrje dhe monitorim efektiv për të siguruar zbatimin në mënyrë të rreptë me zero tolerancë detyrimet e lejeve minerare dhe kontratave të koncesioneve minerare në përputhje me legjislacionin minerar.

Konfliktet mbi pronësinë e tokës të hasur këto vite, kërkojnë zgjidhje ligjore të reflektuara në masat e marra dhe një sërë reformash ligjore përmes prezantimit të koncepteve të reja të planifikimit mineral përmes një gjykimi racional mbi bazat e një planifikimi territorial të qartë dhe transparent. Në çdo rast duhet të mbizotërojë vënia në dukje e përfitimeve për secilën palë si për pronarët legjitim të tokës (private, lokale apo shtetërore) ashtu dhe për të drejtat e kërkuesve minerare, duke marrë parasysh mundësitë e punësimit, ndërtimin e infrastrukturës për gjithë komunitetin lokal si rrugët, kanalizimet, shkollat, qytetet, furnizimi me energji elektrike, shërbime për zhvillimin e biznesit, etj, përmes investimeve të firmave private dhe e fundit për të vënë në jetë qarkullimin ekonomik të burimeve minerale.

Për përgatitjen e burimeve njerëzore të afta për menaxhimin e industrisë minerare, programet universitare duhet të fokusohen jo vetëm në kontekstin teknik por gjithashtu edhe në menaxhimin e biznesit, kombinim me praktika të dobishme të studimeve, hartimin dhe zbatimin e temave të përshtatshme. Zhvillimi i paketave të programeve simuluese për parashikimin e proceseve teknike dhe ekonomike. Studimi dhe hartimi i burimeve të reja efikase dhe i sistemeve ekzistuese përpunuese të burimeve minerale si ashtu edhe të atyre alternative.

Nevoja për përmirësimin e punës studimore, vlerësimit, hartimit, monitorimit, këshillimit, menaxhim teknik dhe supervizimi profesional të punës dhe riskut të minierave. Në këtë kuadër është e drejtuar drejt liberalizimit të këtij tregu me qëllim promovimin dhe mbështetjen shkencore të projekteve kërkimore nga organet shtetërore (qendrat e specializuara, universitetet), firmave private këshilluese po ashtu dhe zyrat teknike të firmave apo kompanive private. Ndarja e mirë e detyrave në shërbim të institucioneve shkencore dhe edukuese dhe mënyrat e bashkëpunimit midis tyre do të sigurojnë një hap pozitiv në këtë drejtim.

Mënjanimi i rrezikut të minierave dhe përdorimi i sigurtë i tokës, trajtuar me përmirësime në kuadrin ligjor që lidhet më monitorimin e minierave të mbyllura dhe atyre në funksionim, rehabilitimi i të cilave siguron mënjanimin e rreziqeve të minierave dhe zonave industriale përmes realizimit efikas të rritjes së lartë ekonomike. Ruajta, mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit parë në përshtatje me legjislacionin e BE-së, shoqëruar më një mbikëqyrje, monitorim rigoroz të lejeve minerale, respektimin e kontratave koncesionare, duke pasur vizionin që këto aktivitete do të bëhen faktorë komandues të binomit miniera-turizëm në të ardhmen. Siguria teknike dhe trajtimi i punonjësve është trajtuar me anë të përshtatjes së legjislacionit Evropian në këtë sektor, duke vlerësuar faktorin njerëzor si më të rëndësishëm në veprimtarinë minerare, i cili duhet të mbrohet dhe trajtohet në punën e tij sipas standardeve bashkëkohore. Mbrojtja nga aksidentet, trajnimet mbi sigurinë në punë, kushtet e jetesës sipas standardeve bashkëkohore dhe niveli ekonomik do të jetë përcaktues në suksesin e veprimtarive të minierave. Një mbështetje ligjore, rritja e përgjegjësisë sociale nga ana e sipërmarrësve dhe një bashkëpunim i frytshëm punëmarrës-punëdhënës janë drejtimet për përmbushjen e kësaj sfide.

Përfshirja e komunitetit dhe administratës lokale në marrjen e vendimeve si një nga zhvillimet më transparente të veprimtarisë së minierave, duke e konsideruar komunitetin si mbështetësin kryesor për zhvillim të qëndrueshëm të veprimtarisë së minierave, konsiderohen midis sfidave dhe politikave më të rëndësishme të zhvillimit të këtij sektori.

Zhvillimi i Praktikave Minerare Miqësore ndaj Mjedisit

Përmes zbatimit të masave paraprake të mbrojtjes mjedisore dhe trajtimit të zonave të dëmtuara, procesit të rehabilitimit të mjedisit progresiv dhe përfundimtar të zonave minerare, mbylljes së sigurtë të minierave të shfrytëzuara dhe garancisë mjedisore paraprake, menaxhimit të mbetjeve ekzistuese duke stimuluar riciklimin e tyre dhe një menaxhim efektiv të mbetjeve të krijuara, forcimit të mbikëqyrjes dhe i monitorimit gjatë veprimtarisë minerare dhe pas shfrytëzimit, më pak dëme mjedisore emetim dhe ndotje nga aplikimi dhe zbatimi i teknologjive të avancuara, promovimi i praktikave më të mira minerare për të minimizuar sa më shumë që të jetë e mundur efektet mbi jetën e komunitetit dhe natyrës, përkufizimi i ciklit të kufizimit të ndikimit mjedisor të një produkti, promovimi së pari i mbështetjes ndaj proceseve të riciklimit dhe së dyti i përdorimit të materialeve.

Marrja parasysh e aspekteve shoqërore

Qeveria Shqiptare është e përkushtuar të rrisë nivelin e sigurisë, vlerësimin e ndikimit të veprimtarive minerare mbi ambientin dhe jetën e komunitetit, përfshirjen e komunitetit në diskutimet dhe vendim marrjen, rritjen e transparencës, përfshirjen e shoqërisë civile në një mënyrë më të gjerë për të vlerësuar përfitimet dhe dëmtimet ndaj komunitetit si një mënyrë për përmirësimin e mirëqenies, punësimit, aksesit ndaj infrastrukturës, sistemit shëndetësor dhe arsimimit në veçanti për zonat me veprimtari të dobët ekonomike. Vlerësimi i operacioneve minerare me vizion afat gjatë për të mundësuar barazinë për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Drejt një Shqipërie Efiçente në Përdorimin e Burimeve

Pavarësisht se i duhet akoma rrugë për të bërë, Shqipëria është duke shkuar drejt anëtarësimit në BE. Për momentin, Shqipëria ka statusin e vendit potencial kandidat në BE dhe tashmë ka hapur procesin e marrjes së statusit të vendit kandidat. Kjo nënkupton që, në mënyrë që të arrihet përparim, politikat kombëtare duhet që të përafrohen gjithnjë e më shumë me politikat dhe standardet e BE-së. BE-ja e konsideron çështjen e përdorimit efiçent të burimeve një prioritet global dhe e ka bërë këtë një prioritet të politikës së saj të Jashtme. Sipas kësaj logjike, BE-ja do të synojë të rrisë bashkëpunimin e saj lidhur me këto çështje me vendet Evropës Juglindore, të cilat aspirojnë ti bashkohen Unionit në të ardhmen. Siç edhe përmendet në Udhërrëfyesin mbi një Evropë që përdor me Efiçencë Burimet, BE-je do të punojë drejt arritjes së një marrëveshjeje të përgjithshme me partnerët e saj. Edhe pse, nuk është një partner strategjik për BE-në, vizioni është të shkuarit drejt pasjes së një bashkëpunimi më të mirë dhe adoptimit të masave të përdorimit efiçent të burimeve, që duhet të jenë thelbësore për Shqipërinë nëse dëshiron të jetë konkurrese në një Union të zgjeruar. Nëse Shqipëria nuk i kushton vëmendje më të madhe çështjes së ‘përdorimit me efiçencë të burimeve’ do ta gjejë vetveten në një pozicion jo konkurues brenda një Evrope me përdorim gjithnjë e më efiçent të burimeve. Programet mbi efiçencën e burimeve janë të rëndësishme për thithjen e projekteve të donatorëve.

Si përfituese aktuale e Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA) dhe përfituese e ardhshme e fondeve strukturore dhe atyre të kohezionit në momentin e dhënies së statusit të vendit kandidat, Shqipëria do të përfitojë nga prioritetet financiare që u jepen projekteve mbi përdorim me efiçencë të burimeve. Për momentin nuk ka akoma një program të disponueshem por sipas iniciativës ‘Një Evrope Efiçente ndaj Burimeve’, të gjitha instrumentet financiare të BE-së do të angazhohen për të arritur një performancë më të mirë në efiçencën ndaj burimeve. Këto iniciativa theksojnë nevojën e promovimit të biznesit më të qëndrueshëm në Shqipëri, që mund të përfitojë nga projektet e ardhshme të infrastrukturës së BE-së në Ballkan.

Udhërrëfyesi mbi ‘Një Evrope Efiçente ndaj Burimeve’ parashtron objektivat e BE-së mbi trajtimin e sfidave lidhur me përdorimin efiçent të burimeve deri në vitin 2020. Objektivat e politikës të vendosura në Udhërrëfyes marrin parasysh ndërvarësinë mes rritjes ekonomike, mirëqenies sociale dhe përdorimit efiçent të burimeve. Iniciativat për Përdorimin Efiçent të Burimeve përfshijnë dhe mbështesin një spektër të gjerë të veprimtarive transformuese teknologjike, sjelljes konsumatore dhe proceseve të reja të biznesit në disa sektorë të ekonomisë; si ai energjistik, industrial, bujqësor, ai i peshkimit dhe transporti për të përmendur disa. Këto iniciativa stimulojnë ekonominë të prodhojë më shumë duke përdorur më pak, duke rritur në këtë mënyrë konkureshmërinë në planin afat mesëm dhe afat gjatë. Udhërrëfyesi përcakton bazamentin e një rruge transformuese drejt proceseve nga ‘djepi në djep’ (cradle to cradle), konceptimit më të mirë të produkteve, ripërdorimin, dhe metodave të riciklimit.

3.3. Politikat e nxitjes së eksporteve

Politikat e nxitjes së eksporteve do të orientohen në disa drejtime specifike:

3.3.1. Nxitja dhe mbështetja e eksportit të shërbimeve.

Gjate gjithë këtyre viteve fokusi i politikave të eksportit kanë qenë mallrat. Ndërkohë shërbimet po marrin një dimension të ri në zhvillimin ekonomik të vendit. Ato përbëjnë sot rreth 60% të kontributit në GDP dhe janë një potencial i madh për eksport. Në studimin e fundit të Bankës

Botërore⁹ për tregtinë e shërbimeve në vendet CEFTA nënvizohet ndër të tjera rritja e eksportit të shërbimeve në vite e ka tejkaluar rritjen e eksportit të mallrave. Gjithashtu po sipas këtij studimi kriza globale provoi se eksporti i shërbimeve ishte më rezistent ndaj krizës dhe pati një rënie shumë herë më të ulët se sa eksporti i mallrave. Madje për Shqipërinë dhe Kosovën duhet thënë se janë të vetmet vende në rajon që në 2009 patën rritje të eksportit të shërbimeve. Panorama e mësipërme si dhe të dhënat e eksportit të shërbimeve tregojnë për potencialin real të shërbimeve dhe nevojës për t'u përqendruar në liberalizimin e tregtisë së shërbimeve në rajon dhe me gjerë.

3.3.2. Hapja e tregut të shërbimeve me vendet e rajonit.

Kjo do të mbështetet edhe me harmonizimin e legjislacionit me Bashkimin Evropian i cili do të krijojë kushtet për lirinë e ofrimit të shërbimeve në BE. Megjithëse ky legjislacion është për rregullimin e tregut të brendshëm të shërbimeve, për Shqipërinë në një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, ky harmonizim do të krijojë më shumë hapësira për eksport të shërbimeve shqiptare në tregun evropian.

3.3.3 Rritja e aksesit bankar për kompanitë eksportuese.

Kjo është një problematike tepër sensitive veçanërisht për SME-të, për të cilat kufizimet e kreditimit janë më shtrënguese sesa për firmat e mëdha. Duke qenë se SME-te përbejnë pjesën më të madhe të firmave eksportuese, që të rritet eksporti është e nevojshme zgjerimi i skemave të financimit të eksporteve.

3.3.4. Thjeshtimi i dokumentacionit doganor dhe kohës për çlirimin e produktit për eksport.

Ekzistenca ende e procedurave të gjata burokratike ndikojnë në rritjen e kostove të transaksionit për eksport.

3.3.5. Mbështetja e sektorëve eksportues në bazë klasteri.

Nxitja e bashkëpunimit të gjithë aktoreve qofshin privat apo publike, të agjencive të menaxhimit dhe shërbimit për kompanitë eksportuese, kompanitë e transportit, qendrat teknologjike, etj, që ndikojnë në zhvillimin dhe marketingun e produkteve për eksport, konsiderohet një politike proaktive për të përballuar pengesat e hyrjes në tregjet ndërkombëtare.

3.3.6. Harmonizimi dhe përshtatja e politikave të eksportit me politikat që synojnë përmirësimin e produktivitetit dhe rritjen e kapaciteteve teknologjike të kompanive në sektorët e prodhimit.

3.3.7. Nxitja e eksporteve të produkteve të përpunuara minerare me vlerë të shtuar në vend.

3.4. Politikat e nxitjes së investimeve

Rritja e investimeve të huaja është objektiv kyç për zhvillimin ekonomik të vendit dhe prioritet strategjik i qeverisë. Rëndësia e investimeve të huaja është shumë plansh si dhe performanca e investimeve ndikon në progresin ekonomik dhe social të vendit. IHD sjellin kapitalin e nevojshëm, rritin produktivitetin e ekonomisë, dhe ndërmjet të tjerave nëpërmjet transferimit të njohurive dhe teknologjisë, ndikojnë në hapjen e tregjeve të reja për tregti si dhe rritin konkurrueshmërinë e ekonomisë, ndikojnë në reduktimin e deficitit të llogarive korente, rritin

⁹ Barriers to Trade in services in the CWEFTA Region, Borko Handjiski, Lazar Sestovic, 2010

punësimin dhe mbi të gjitha ndikojnë në mirëqenien e popullsisë. Arritja e këtij qëllimi kërkon përmirësime të vazhdueshme në kuadrin ligjor dhe institucional, stabilitet dhe rritje ekonomike të qëndrueshme, përmirësim të mëtejshëm dhe modernizim të infrastrukturës si dhe përmirësime në klimën për mjedisin e biznesit dhe investimeve.

3.4.1. *Klima e biznesit:*

- *E drejta e pronësisë dhe kontratat*

Qeveria do të vazhdojë politikat e saj që ndikojnë në fuqizimin e të drejtës për pronën dhe kontratat, duke përfshirë edhe pronësinë intelektuale. Puna që bëhet për ti dhënë zgjidhje përfundimtare kthimit të pronave dhe në veçanti pronësia mbi tokën, konsiderohet një prioritet. Në plotësim të kësaj mase, dixhitalizimi i regjistrimit të pronave është në fazën e zbatimit për qytetin e Tiranës dhe do të zgjerohet në tërë territorin e vendit. Konsolidimi i Gjykatës Administrative, e krijuar kohët e fundit, do të jetë një kontribut i rëndësishëm që do të garantojë zbatimin e të drejtës kontraktore. Qeveria do të vazhdojë të zhvillojë marrëveshje bilaterale në fushën e investimeve me ato vende që nuk kemi, që do të garantojnë më tej mbrojtjen e investitorëve.

- *Trajtim i barabartë*

Ndërsa legjislacioni shqiptar tashme ofron trajtim të barabartë dhe mbrojtje ndërmjet firmave si vendase ashtu edhe atyre të huaja, masa të tjera nevojiten që të garantojnë konkurrencë të ndershme në treg ndërmjet firmave të huaja me ato lokale. Në veçanti, si trajtohet me poshtë, qeveria do të vazhdojë masat e saj kundër evazionit fiskal dhe korrupsionit ndërmjet bizneseve lokale, që në disa raste tregojnë për konkurrencë jo të ndershme ndaj investitorëve të huaj.

- *Heqja e barrierave administrative*

Referuar reformave të suksesshme të realizuara deri tani në këtë fushë, do të vazhdojnë të merren masa në vitet e ardhshme për reduktim të mëtejshëm të barrierave administrative, në të bërit biznes dhe në investime.

- *Start-up*

Shqipëria ka përfunduar një reformë të suksesshme në regjistrimin e biznesit e cila ka ndikuar në heqjen e barrierave të biznesit dhe reduktimin e kostove të regjistrimit. Përmirësime të rëndësishme janë bërë në procedurat e licencimit dhe të regjistrimit të taksave. Reformat e mëtejshme do të vazhdojnë në thellim të procedurave të licencimit, prioritet tjetër do jetë fusha në përmirësimin e procedurave të imigrimit, duke përfshirë sigurimin e rezidencës, lejen e punës, siguracionet për punëtorët e tyre.

- *Vendndodhja e investimit*

Shqipëria synon për të rritur investimet direkte (green field), procedurat për zgjedhjen e vendit si dhe kostot për sigurimin e tij janë një faktor për të arritur suksesin. Qeveria do të përcaktojë hartën dhe do të përmirësojë të gjitha aspektet e vendndodhjes së investimit, duke përfshirë identifikimin dhe blerjen e tokës; regjistrimin e pronësisë së tokës; zhvillimi i territorit, lejet e ndërtimit; lidhja me burimin e furnizimit të utilitareve, inspektimi dhe lejet e Punësimit. Qeveria do të identifikojë tokat publike që do të jenë disponibël për qera apo shitje për investitorët e huaj, duke përfshirë edhe tokën bujqësore. Politika e dhënies me qera afatgjatë për 1 EURO do të vazhdojë të zbatohet. Aktualisht, procedurat e lejeve të ndërtimit janë rishikuar dhe është planifikuar një sistem reformimi i tërë, i cili do të lehtësojë procedurat, reduktojë kostot dhe rritjen e transparencës. Në shtesë të kësaj politike, është edhe ngritja e zonave industrial që mund të ofrojnë tokën, infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse të biznesit. Legjislacioni për ngritjen e zonave industrial është i gatshëm, dhe zonat e para industriale kane filluar të zhvillohen. Ato do të zhvillohen nëpërmjet dhënies me koncesion BOT me investitorë privat. Krijimi i zonave të lira tregtare pranë porteve dhe aeroporteve si dhe ofrimi i objekteve, uzinave industriale në

pronësi të shtetit, që janë jashtë funksionit dhe te degraduara. Zhvillimi i zonave ekonomike dhe parqeve industrial do te orientohet drejt procesit strategjik të vlerësimit të impaktit mbi mjedisin (SEIA), kështu që këto përpjekje që bëhen në sektorë të ndryshëm, lidhen edhe me zhvillimin e turizmit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe në respekt të mbrojtjes së mjedisit.

- *Veprimet*

Të gjitha kërkesat që lidhen me administrimin e taksave, doganat si dhe rregullat e punësimit do të rishikohen dhe do të përmirësohen. Një theks të veçantë do të këtë për politiken e taksave dhe administrimin e tyre që trajtohen si me poshtë:

Politika e taksave. Politika e taksave dhe menaxhimi është një nga faktorët e rëndësishëm në tërheqjen e investimeve të huaja dhe në përmirësimin e klimës së biznesit. Qeveria do të vazhdojë përpjekjet e saj për të vendosur një sistem taksash të thjeshtë, një administratë tatimore të modernizuar, duke mbajtur nivel të ulët taksash, duke ofruar incentivë dhe përmirësimin e administrimit të tyre.

Niveli i taksimit Qeveria do të menaxhojë dhe do të konsolidojë më tej taksën e sheshtë prej 10% mbi të ardhurat personale dhe fitimin mbi kompanitë. Në vazhdim, do të prezantojë incentivat në taksë që të jenë të selektuara për investimet e huaja, në veçanti duke ulur ose përjashtim të plotë të TVSH-s për makineritë e pajisjet e importit. Qeveria do të jetë e angazhuar për të përmirësuar procedurat dhe kohën e rimbursimit të TVSH-së.

Administrimi i taksave, do të fuqizohet duke respektuar procedurat, rritjen e transparencës dhe uljen e kostos së tyre. Auditimi si dhe procedurat e inspektimit do të përmirësohen, duke reduktuar ndërhyrjet dhe koston e biznesit. Prioritet do të marrin adoptimi i standardeve ndërkombëtare të taksave dhe harmonizim me ato të BE-s, duke përfshirë edhe standardet e taksave për SME-t.

Një projekt rëndësishëm që ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të taksave është në zbatim dhe që mundëson krijimin e dosjeve on-line, përpunimin dhe pagesën e taksave. Prezantimi gjithashtu i teknologjisë modern në dogana, përpunimi si dhe ç'doganimi është gjithashtu pjesë e programit të modernizimit për administrimin e taksave. Ndërkohë, qeveria do të respektojë konkluzionet e marrëveshjes së re bilaterale, veçanërisht me vendet që paraqesin potenciale për investime.

Transparenca, qeveria do të fuqizojë konsultimin dhe dialogu, shkëmbimin e informacionit me investitorët. Informacioni dhe dialogu me shoqatat e investitorëve do të fuqizohet. Në veçanti, komunikimi ndërmjet autoriteteve të taksave me biznesin do të përmirësohet.

Zhvillimi i burimeve njerëzore, një fuqi punëtore e kualifikuar përbën avantazh për investimet e huaja, veçanërisht për ato që operojnë në industrinë me teknologji të lartë. Qeveria do të vazhdojë reformat e saj në fushën e edukimit dhe trajnimit profesional, duke përmirësuar cilësinë e edukimit dhe duke nxitur lidhjet ndërmjet akademisë me biznesin. Një vëmendje e veçantë do ti kushtohet njohurive të specializuara në menaxhim, inxhinieri dhe fusha teknologjike në përgjithësi.

3.4.2. *Partneriteti publik-privat(PPP)*

PPP nëpërmjet kontratave koncesionare ka vërtetuar se është një mekanizëm i suksesshëm në tërheqjen e investimeve të huaja veçanërisht në sektorin e minierave dhe të energjisë. Kjo politikë do të zgjerohet edhe në sektorë të tjerë dhe do të bëhen përpjekje për të nxitur praktikën më të mira në përgjegjësinë sociale të korporatës-CSR, në industrinë nxjerrëse (naftë, miniera, çimento dhe energji elektrike), për të krijuar një mjedis miqësor menaxhues dhe i pranueshëm nga komuniteti lokal.

3.4.3 *Infrastruktura e biznesit.* Qeveria do të vazhdojë planin e saj ambicioz të përmirësimit në zhvillimin e infrastrukturës së vendit. Korridorët e rrugëve kryesore, që do të përmirësojnë transportin lokal dhe ndërkombëtar, janë në proces ose do të vazhdojnë të përmirësohen.

Të gjitha portet kryesore po i nënshtrohen ristrukturimit dhe investimeve. Një numër i ri investimesh janë programuar për të ndërtuar linja të transmetimit të energjisë ose duke përmirësuar ato ekzistuese. Të një prioriteti të veçantë në fushën e infrastrukturës është gjithashtu zhvillimi i TIK, që është kryesore në tërheqjen e investimeve me teknologji të lartë dhe vlerë të shtuar. Qeveria ka ofruar nëpërmjet metodës së koncesionit BOT, për të ndërtuar transmetimin me kabëll me fibra, duke investuar në zhvillimin e infrastrukturës së TIK.

III. OBJEKTIVAT KRYESORE TË STRATEGJISË

1. Sipërmarrja dhe SME-të

Politikat e zhvillimit të SME-ve janë në harmoni me të gjitha ligjet dhe marrëveshjet e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) dhe Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën (ABV). Implementimi i politikave europiane në të 10 dimensionet e ABV, si dhe rekomandimi i Komisionit European i datës 09.01.2013: **“Plani i veprimit për zhvillimin e sipërmarrjes për periudhën 2020”** të Komisionit European, janë udhërrëfyes kryesor në politiken e zhvillimit të sipërmarrjes dhe SME-ve në Shqipëri.

Objektivi strategjik është: *rritja e konkurrencës së SME-ve, duke nxitur rritjen e numrit të ndërmarrjeve të reja dhe të punësimit.*

Objektivat specifike që do të shërbejnë në arritjen e këtij objektivi të përgjithshëm janë si më poshtë:

- 1) *Nxitja e kulturës së sipërmarrjes dhe trajnimi në mbështetje të rritjes dhe krijimit të bizneseve*
- 2) *Krijimi i një klime biznesi ku sipërmarrësit femra dhe meshkuj mund të zhvillohen dhe të rriten*
- 3) *Përmirësimi i financimit të SME-ve*
- 4) *Nxitja e konkurrencës së SME-ve dhe inovacionit*

1.1 Nxitja e kulturës së sipërmarrjes dhe trajnimi në mbështetje të rritjes dhe krijimit të bizneseve

Një nga prioritetet e zhvillimit afatgjatë të sektorit të SME-ve, është nxitja e kulturës së sipërmarrjes, edukimit dhe trinitit të tyre. Në veçanti brezi i ri që është përfitues i të mësuarit për sipërmarrjen, i krijohen mundësi të aftësohet në njohuritë për biznesin, në mjeshtëritë me esenciale, ku përfshihen kreativiteti, iniciativa, puna në grup, të kuptuarit e riskut dhe sensi i përgjegjësisë. Për këtë do të synohet që të hartohet një plan veprimi konkret i cili do të përqendrohet në futjen e kulturës së sipërmarrjes si; në edukimin formal e në atë jo formal, në trajnimet e nevojshme për sipërmarrësit si me poshtë:

1.1.1 Krijimi e përmirësimi i aftësive menaxhuese dhe trajnuese:

Mungesa e talentit menaxhues, mbizotërues në shumë shtete të rajonit, ku edhe Shqipëria është pjese e tij, ka një impakt të madh mbi SME-të. Për këtë arsye, një sjellje tjetër sipërmarrëse duhet të ndërtohet që në hapat e parë të edukimit të brezit të ri. Veprime të tilla janë shumë të rëndësishme në krijimin e ambientit të duhur për sipërmarrësit në sistemin arsimor, për të siguruar

që të rinjtë të jenë të informuar për kulturën sipërmarrëse dhe ta konsiderojnë atë si pjesë të edukimit të tyre dhe mundësi e ardhshme punësimi. Një sjellje e re duhet zhvilluar mes grave dhe të rinjve.

-Të mësuarit për sipërmarrjen tashmë është pranuar si një kompetence kyçe në nivel evropian dhe në Shqipëria po përfshihet në kurrikulat mësimore të shkollave 9 vjeçare, të mesme dhe të larta. Strategjitë e hartuara në vendet e BE-së marrin në konsideratë se ky proces është një proces i të mësuarit në një hark kohor afat-gjatë duke filluar nga arsimit fillor dhe me tej deri në shkollën më të lartë të edukimit. *Këto procese përfshijnë jo vetëm reformën e kurikulës në të gjitha nivelet por edhe një sërë programesh të tjera që kanë qëllim nxitjen e kulturës së sipërmarrjes si partneriteti shkollë-biznes, ndërmarrjet studentëve, reformimin e shkollës dhe të gjitha institucioneve që ofrojnë edukim dhe trajnim.*

-Synohet që të inkurajohen universitetet që të ofrojnë kurse te specializuara mbi sipërmarrjen në fusha të tilla si e-biznesi, teknologjitë e inovacionit, etj.

Shtetet që aspirojnë për të hyrë në BE duhet të konsiderojnë projektet e promovimit e sipërmarrjes jashtë aktivitetëve shkollorë si pjesë e edukimit të të rinjve. Media gjithashtu duhet të luajë rol në promovimin e kulturës sipërmarrëse.

-Një fushatë promovuese për sipërmarrjen, për menaxhimin total të cilësisë, për standardet, kontabilitetin, etj, do të jenë në tematikat e televizionit publik.

-Prodhimi i publikimeve për sipërmarrësit duke përfshirë manuale dhe produkte informacioni si dhe revista periodike për mbështetjen dhe inkurajimin e sipërmarrjes, janë gjithashtu produkte të nevojshme që i shërbejnë forcimit të kulturës së sipërmarrjes. Duke pasur parasysh se programi për promovimin e sipërmarrjes përfshin një bazë të gjerë të aktorëve publik dhe jopublik, është vendosur të krijohet një grup pune ndër institucional.

-Programi synon kualifikimin dhe trajnimin mbi sipërmarrjen të rreth 2.000 ndërmarrësve të rinj potencialë dhe start up.

Kjo do të realizohet nëpërmjet: i) Zhvillimit të programeve për futjen e sipërmarrjes në programet bazë të edukimit në të gjitha nivelet; ii) Hartimi i kurikulës për sipërmarrjen dhe programeve trajnuese për zhvillimin e aftësisë sipërmarrëse në kurset disa mujore profesionale; iii) Zhvillimi i programeve trajnuese për të rinjtë dhe femra që kërkojnë të fillojnë një biznes, të diplomuar, të papunët, rikualifikimin dhe informacione të vazhdueshme; iv) Analizës periodike të nevojave për trajnime; v) Hartimi i programeve të trajnimeve dhe moduleve përkatëse për sipërmarrjen; vi)Trajnimeve on line.

Targetimi pro-aktiv në terren i grupeve të ndryshme rinore (femra dhe meshkuj, femra, gratë dhe burrat në zonat rurale dhe atje ku mungon shërbimi) do të lehtësojë qasjen në informacion të tillë dhe për trajnimet e ofruara.

1.1.2. Nxitja e sipërmarrjeve kreative:

Për të nxitur zhvillimin e sipërmarrjes kreative, me qëllim rritjen e aktivitetëve ekonomike të qëndrueshme dhe krijimin e vendeve të punës në sektorin e artizanatit, qeveria do të kontribuojë me mbështetje financiare për këto sipërmarrje duke patur edhe mbështetjen e donatorëve. Qëllimi kryesor i këtij objekti është për të nxitur: zhvillimin e produktit; marketingun; si dhe kualifikimin dhe ndërtimin e kapaciteteve që përfaqësojnë këtë sektor.

Do të krijohet Fondi Grant për mbështetjen e 470 bizneseve kreative, sidomos për ato në fushën e artizanatit.

Kjo do të realizohet nëpërmjet: Programeve për zhvillimin e ekonomisë kreative e veçanërisht të artizanatit shqiptar; Programe për nxitjen e sipërmarrjes nga gratë; Programe për nxitjen e sipërmarrjes nga të rinjtë, start ups, etj.

1.1.3 Rritja e pjesëmarrjes së grave që drejtojnë biznese:

Për të pasur një rritje ekonomike të qëndrueshme, një fokus i veçantë do të jetë vlerësimi në lidhje me rritjen e bizneseve të drejtuara nga femrat. Duke pasur edhe mbështetjen e donatoreve synohet që të merren disa masa konkrete për mbështetjen e grave në biznes:

- Ndërmarrja e një anketimi në territorin e vendit me qëllim për të siguruar të dhëna të sakta mbi numrin, sektorët, madhësinë, vendëndodhjen gjeografike, problematika që hasin gratë dhe nevojat në zhvillimin e biznesit të tyre;
- Mbi bazën e gjetjeve dhe konkluzioneve të këtij anketimi, synohet drejt hartimit të një programi mbështetës për gratë sipërmarrëse, me qëllim për të rritur pjesëmarrjen e tyre në biznes;
- Krijimi i bazës së të dhënave mbi performancën ekonomike të grave në biznes;
- Rritja e ndërgjegjësimit si shkalla e përfitimit nga programet e BE-së, me qëllim për të rritur numrin e grave ambasadore dhe mentore dhe me qëllim për tu bërë pjesë e networkut në nivel rajonal dhe europian;
- Hartimi i një dokumenti politikash për sipërmarrjen e grave, plan veprimi dhe buxhet;
- Zbatimi i politikave adekuate për gratë në biznes duke i shoqëruar me programe mbështetëse financiare si: skemave grante për fillimin e biznesit dhe për fuqizimin e tyre, skemave mbështetëse për të rritur aksesin në financë të femrave sipërmarrëse.
- Krijimi/mbështetja e networkut kombëtar për gratë sipërmarrëse.

Ndërmarrja e këtyre masave ka qëllimin për të arritur që *numri i sipërmarrjeve femërore deri në fund të vitit 2020 të arrijë në 35% të të gjitha bizneseve aktive. Numri i femrave të vetëpunësuar deri në fund të vitit 2020 të arrijë në 35%. Disbursimi i kredive për sipërmarrjet femërore deri në fund të vitit 2020 të arrijë në 35%.*

1.1.4. Nxitja e biznesit social:

Një nga drejtimet e reja të politikave të BE-se është drejt një ekonomie sociale të tregut, pra mbështetja e krijimit të bizneseve sociale. Nxitja e biznesit social, duke pasur objektiv të veçantë grupet vulnerabël, sidomos minoritetet etnike, si dhe individë me aftësi të kufizuara. Një biznes social nuk është një biznes fitimprurës, objektivi kryesor i tij është zgjidhja e një problemi social. Krijimi dhe fuqizimi i këtyre bizneseve do të sjellë zhvillim e punësim sidomos në zonat gjysmë urbane e urbane, por edhe në zonat më pak të zhvilluara në vend.

Për më tepër, është i nevojshëm ndërmarrja e një studimi të veçantë për karakteristikat dhe nevojat e grupeve të veçanta të grave dhe burrave nga pakicat etnike dhe të grave me aftësi të kufizuara dhe burrave.

Për mbështetjen e këtyre bizneseve do të hartohet së pari një kuadër ligjor e nënligjor në përputhje me direktivat e BE-së dhe me pas skemat për mbështetjen e këtyre bizneseve.

1.1.5 Nxitja e pergjegjesise sociale te korporates/PSK:

Per komunitetin e biznesit po behet gjithnje si nje nevoje zbatimi i strategjise se rinovuar te Komisionit Evropian 2011-2014 per PSK, botuar ne Tetor 2011. Prioritet i eshte dhene zhvillimit te strategjive kombetare ne fushen e PSK dhe krijimit te forumit shumepalesh.

Per tregun shqiptar, parimet e PSK se bashku me Kodin Etik te Biznesit, si nocione, gjithnje e me shume po gjejne terren zbatimi, po behen pjese e drejtimit strategjik ne veprimtarine e kompanive. Qe ne vitin 2005, Shqipëria ka krijuar një rrjet lokal, për të cilën PNUD-i vepron si

Sekretariat dhe punon ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), për të lehtësuar komunikimin me forumin shumëpalesh. Objektivi i këtij forumi ishte për të vepruar si një organizim keshillues, duke sjellur pranë tij të gjithë aktoret, për të rritur ndergjegjesimin, shkëmbimin e eksperiencave për zhvillimin e indikatorëve kombëtar dhe nivel kompanie dhe gjithashtu në zbatimin vullnetar të standardeve për PSK. Forumi shumëpalesh ka në përberjen e tij përfaqësues nga organizatat e biznesit, institucionet publike, akademja, OJF si dhe kompani individuale. Forumi Shumepalesh i krijuar ka si qëllim inkurajimin e komunitetit të biznesit dhe administratën publike në zbatimin e praktikave me të mira mbi përgjegjësitë sociale dhe për të ndermarre aksione të përbashkëta në : *adresimin e shume çështjeve të rëndësishme siç janë; mbrojtja e mjedisit, mbështetja sociale, nxitja e investimeve dhe e punësimit.* Dokumenti politik i PSK dhe plani i veprimit konsiderohet pjesë përberëse e Draft Strategjise së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për periudhën 2013-2020.

1.2 Krijimi i një klime biznesi ku sipërmarrësit mund të zhvillohen dhe të rriten

Pavarësisht nga rezultatet e deritanishme të arritura në përmirësimin e klimës së biznesit dhe të indikatorëve që e përcaktojnë atë, nisur nga kontaktet dhe dialogu i vazhdueshëm i qeverisë me përfaqësuesit e komunitetit të biznesit, lind si domosdoshmëri thellimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në drejtim të disa indikatorëve të rëndësishëm që ndikojnë në përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit dhe reduktimin e kostos së të bërit biznes.

-Ashtu si në axhendën politike të Komisionit Europian, reduktimi i barrierave dhe praktikave të panevojshme administrative mbetet një ndër prioritetet e reformës rregullatore në Shqipëri. Në veçanti “red tape” duhet të eliminohet ose të shkojë drejt minimizimit, kudo ku është e mundur, për të gjitha bizneset dhe në veçanti për mikro ndërmarrjet duke përfshirë të vet punësuarit dhe profesionet e lira.

-Gjithashtu në fushën e *prokurimit publik* me qëllim që të rritet pjesëmarrja e SME-ve, ka vend për të rishikuar kuadrin ligjor nga autoritetet kontraktore veçanërisht me kërkesat e dokumentacionit administrativ, që bëhen pengesë për pjesëmarrjen e SME-ve në këtë proces prokurimi. *Copëzimi i kontratave në bazë të lotëve dhe kufirit të vlerës së tyre, do të rriste aksesin e tyre.*

-Çdo sipërmarrës pavarësisht nga madhësia e biznesit që përfaqëson, duhet të mbështetet në një pikë kontakti të vetme për të marrë informacionin e dobishëm lidhur me hapjen dhe zhvillimin e biznesit të tyre.

-Agjencitë e tipit “one stop shops” tashmë janë mundësuar nga qeveria dhe agjenci të tilla si AIDA, QKR dhe QKL, mundësojnë sigurimin e një informacioni dhe shërbimi me kosto tepër minimale për biznesin.

-Deri në fund të vitit 2020, puna do të përqendrohet në adoptimin e “*Kodit Europian të praktikave më të mira që lehtësojnë aksesin e SME-ve për pjesëmarrje në prokurim publik*”

- Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve të agjencive publike si AIDA, QKR, QKL, etj, në funksion të nevojave të sipërmarrjes dhe të reduktimit të kostove të këtyre shërbimeve.

- Ndërmarrja e shërbimeve dhe monitorimi nga pikëpamja e gjinisë të ofruara nga agjencitë si AIDA, QKR, QKL, etj.

1.2.1 Lehtësimi i procedurave në transferimin e një biznesi

Nisur nga përvoja e vendeve të BE-së, janë rreth 450 mijë kompani me rreth 2 milion të punësuar që transferohen çdo vit në vende të tregut europian. Kushtet e transferimit të biznesit nuk janë të lehta, janë një sërë faktorësh si barrierat administrative dhe barra e taksave, mungesa e

informacionit dhe koha e shpenzuar në plotësimin e formaliteteve që konsiderohen një pengesë e madhe. Nisur gjithashtu nga forma legale e kompanisë dhe koha e saj që operon në treg, konsiderohen elemente shtesë që kompanitë e vogla me eksperiencë jo me shumë se tre vjet në treg të jenë vullnerabël dhe që ekspozohen më lehtë ndaj dështimit për transferimin e biznesit të tyre.

Edhe pse një eksperiencë e tillë deri tani njihet pak në tregun shqiptar, praktikat ligjore dhe administrative duhet të gjejnë zbatim, pasi gjithnjë e më shumë biznesi përgatitet të integrohet sa më shumë në tregun europian. Veçanërisht transferimi i një biznesi nga një brez në tjetrin brenda familjes është një sfidë me të cilën edhe biznesi vendas do të përballlet. Transferimi i një biznesi familjar nuk është thjeshtë transferimi i pronësisë së kapitalit dhe asetëve, por është gjithashtu ajo “Vlera” e cila është ndërtuar dhe zhvilluar nga brezat e familjes, ku përfshihet tradita dhe know-how.

Meqenëse akoma sot në tregun europian ka vështirësi për transferimin e biznesit, për efekt të sistemit të taksave dhe procedurave administrative, aq më shumë në tregun vendas lind si domosdoshmëri:

- përmirësimi apo dhe adoptimi i kuadrit ligjor që të lehtësojë transferimin e biznesit, duke marrë në konsideratë : *Rekomandimin e Komisionit Europian të vitit 2006 për transferimin e biznesit dhe atë të vitit 2011 që merr në konsideratë pengesat fiskale për transferimin e një biznesi ndërkufitar brenda tregut europian.*
- përmirësimi i informacionit dhe shërbimeve të këshillimit si dhe mbledhja e të dhënave dhe monitorimi i rasteve të transferimit të një biznesi, etj.

1.2.2 Të kthesh dështimin në një sukses: shansi i dytë për proces falimentimi të ndershëm

Ashtu si në tregun Europian, procesi i falimentimit të një biznesi është i rregulluar me ligj të veçantë. Gjatë viteve të fundit në zbatim të ligjit janë marrë masa institucionale.

Në zbatim të nenit 282/1 të ligjit 9919/2008 është krijuar Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, Është institucion i ri, i miratuar me VKM nr.852, datë 21.10.2010.

Megjithatë procesi i falimentimit kalon nëpërmjet një procesi shume kompleks që shpenzon shumë kohë duke krijuar mbi të gjitha shumë vështirësi për këtë kategori kompanish, me qëllim për ti krijuar një shans të dytë dhe të fillojnë një biznes të ri.

Në këto kushte ligjet e falimentimit duhet të sigurojnë mënyra të shpejta dhe me efikase të paraqitjes së ankesave dhe duke plotësuar pretendimet e kreditorëve, nga ana tjetër procedura më të shpejta dhe më të përballueshme për përmbylljen e bizneseve nga falimentimi dhe për ti krijuar një shans të dytë për fillimin e një biznesi të ri.

Në kushte të tilla bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian puna do të fokusohet në:

- përmirësimet e ligjit të falimentimit, për shkurtimin e kohës dhe detyrimeve për sipërmarrësit e ndershëm pas procesit të falimentimit.
- ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe këshillime për ristrukturim të ndërmarrjeve me qëllim për të parandaluar falimentimin por edhe pas këtij procesi.
- ofrimi i shërbimeve për sipërmarrësit e falimentuar me qëllim menaxhimin e borxheve si dhe zhvillimi i programeve për këtë ‘mundësi të dytë’ në drejtim të mentoring, trajnime dhe përfshirja në rrjetin e bizneseve.

1.2.3 Ngritja e sistemit të plotë e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator VNR (Regulatory Impact Assessment –RIA).

i) Ngritja e sistemit të thjeshtë të Vlerësimi të Ndikimit Rregullator (VNR/RIA light) Për zhvillimin e sistemit të Vlerësimi të Ndikimit Rregullator (VNR/RIA), si një instrument i ri që do të garantonte cilësinë e kuadrit të ri ligjor. Në këtë kuadër kërkohet miratimi i draftit të propozuar për amendimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.584, datë 28 gusht 2003 “Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave” dhe konkretisht rishikimi i procedurave të draftimit të akteve dhe reformimi i Relacionit Shpjegues aktual dhe Vlerësimi Buxhetor. Kjo do të kërkonte ndër të tjera krijimin e njësive përkatëse për kryerjen e VNR/RIA sektorial. Alternative zgjidhjeje do të ishte edhe përfshirja në përshkrimin e punës së stafëve ekzistuese nëpër ministri të ndryshme kryerja e vlerësimi të ndikimit rregullator.

ii) Organizimi i trajnimeve gjatë periudhës 2013-2015, për ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët e administratës publike, të cilët do të jenë përgjegjës për hartimin e legjislacionit, rregulloreve dhe relacionin shpjegues.

iii) Vlerësimi i kalimit nga sistemi i thjeshtë i vlerësimi të ndikimit rregullator në zbatimin e plotë të vlerësimi të ndikimit rregullator (full blond RIA), 2014-2015 .

Ky vlerësim do të përfshijë ndër të tjera edhe nevojat për hartimin e një ligji për krijimin i një sistemi të plotë të RIA-s, kuadrit ligjor për të cilin vlerësimi i plote i ndikimit rregullator është i detyrueshëm, krijimin e një strukture institucionale të veçantë në nivel kombëtar për koordinimin e RIA-s, si dhe ngritjen e njësive për RIA-n brenda ministrive të linjës, etj. Ky proces do të shihet i lidhur ngushtë me procesin e harmonizimit të legjislacionit me acquis duke lehtësuar procesin e kryerjes së VNR në rastet e harmonizimit të plotë të legjislacionit.

1.2.4 Reformimi i sistemit të inspektimit nëpërmjet konsolidimit të numrit të inspektorateve dhe fuqizimit të Inspektoratit Qendror si dhe ristrukturimi i inspektorateve dhe trupave inspektues, në varësi të nevojave të tregut për periudhën 2013- 2020.

Inspektorati Qendror, do të merret me të gjithë problematikën e inspektimit, duke promovuar metodologjinë më të mirë, parimet dhe praktikat kryesore më të mira që zbatohen në vendet e zhvilluara të BE-së dhe OECD-së. Ky institucion do të operojë në bazë të ligjit “**Për Inspektimin**” i miratuar që në qershor 2011.

Do të thellohet puna gjatë këtyre viteve në ristrukturimin e të gjitha inspektorateve dhe trupave inspektues, duke i riorganizuar dhe bashkuar funksionet inspektuese të çdo Ministrie dhe eliminuar në këtë mënyrë strukturat e shumta të inspektimit ekzistuese, që funksionon sipas logjikes “çdo ministri e linjës të ketë një inspektorat”. *Reforma në inspektorat do të sjellë: - Reduktimin e inspektorateve me 2/3 si dhe reduktimin e kohës së inspektimit në biznese nga 45 ditë në 12 ditë.*

1.2.5 Përditësimi i regjistrit elektronik për legjislacionin e biznesit.

Për të rritur shkallën e transparencës, konsulencës, lehtësimi të biznesit, informimit të tij dhe për minimizimin e mundësive korruptive, do të punohet në mënyrë sistematike mbi përditësimin e këtij regjistri. Ky regjistër do të jetë në formatin e një web-site ku i gjithë legjislacioni (çdo akt legjislativ) do të jetë në format(file) elektronik.

METE do të monitorojë dhe kontribuoj në përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit të këtij Web-Site.

Ky web-site do të behet funksional dhe i menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) me adresën: www.rlb.gov.al

Për periudhën 2013-2020, masat do të konkretizohen si më poshtë në reduktimin e ditëve për :

- procedurat për fillimin e një biznesi: nga 5 reduktohet në 2 procedura
- koha për marrjen e një leje ndërtimi: nga 436 ditë reduktohet në 35 ditë
- koha për furnizimin me energji elektrike: nga 177 ditë reduktohet në 45 ditë
- koha për regjistrimin e pronësisë: nga 33 ditë reduktohet në 13 ditë
- marrjen e një kredie;
- koha për pagesën e taksave nga raportimi on line: reduktohet me 125 orë;
- procedurat doganore të eksport-importit: reduktimi i kohës për eksport nga 19 ditë në 4 ditë; reduktimi i kohës për import nga 18 ditë në 3 ditë; reduktimi i numrit të dokumenteve për eksport nga 7 në 3; reduktimi i dokumenteve për import nga 8 në 4;
- zbatimin e kontratave: reduktimi i afateve kohore të procesit gjyqësor si dhe reduktimi i procedurave
- procedurat e falimentimit: reduktimi i kohës së procesit të falimentit

Përmirësimi i masave legislative dhe administrative në këto aspekte dhe më shumë që do të bëhen gjatë periudhës 2013-2020, padyshim që do të ndikojnë në përmirësim të renditjes së Shqipërisë, sipas Indikatorëve të Bankës Botërore “Doing Business”, me 25 vende.

1.3. Përmirësimi i financimit të SME-ve

Institucionet financiare luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e SME-ve dhe në zhvillimin dhe përhapjen e teknologjive të reja. Tregjet financiare kudo në Evropë kanë filluar ti përgjigjen zhvillimeve të qëndrueshme në mënyra më direkte dhe krijuese si përmes fondeve “jeshile”, tregjeve të sigurimeve dhe zhvillimit të politikave dhe udhëzimeve për sa i përket çështjeve të mjedisit. Mbështetja financiare duhet të jetë si me kredi për projektet e mëdha deri tek mikro-kreditë që mbështesin iniciativat e vogla.

Qeveria Shqiptare kërkon që ta fuqizoj më shumë financimin e SME gjatë viteve të ardhshme, nëpërmjet përdorimit dhe të disa instrumenteve të tjerë në mbështetje të SME-ve.

1.3.1. Rritja e nivelit të kreditimit dhe fuqizimi i fondit shqiptar të garantimit të kredive.

Ashtu si në vendet e BE-së, është e nevojshme të bëhet një vlerësim për kuadrin aktual ligjor financiar me qëllim për të siguruar forma ligjore alternative të financimit në veçanti për bizneset fillestare, start-ups dhe SME-të.

Tashmë është krijuar fondi i garantimit të kredive, si pjesë e programit të mbështetjes së SME-ve nëpërmjet një linjë kredie të butë, sipas një marrëveshje me qeverinë italiane. Edhe pse është krijuar kuadri ligjor i nevojshëm, nga ky fond ende nuk janë mbështetur bizneset. Në kohën kur kemi një turrje të kreditimit në Shqipëria edhe pse SME-të kanë nevoja për financime për të investuar e për tu zgjeruar, del më se i domosdoshëm: **funksionimi dhe zgjerimi i këtij fondi garantimi**. Për këtë arsye ekziston nevoja për një vazhdim dhe zgjerim rajonal nëpërmjet degëve të bankave, të linjave ekzistuese të kreditimit të përqendruara tek SME-të, të cilat ofrohen si nga bankat tregtare apo edhe nga disa donatorë që kontribuojnë në financimin e SME-ve.

Kështu gjatë viteve 2013-2015 parashikohet që të fillojë faza e dytë e programit për mbështetjen e SME-ve, e financuar nga qeveria italiane në ndihmë të SME-ve me një fond kredie shtesë të butë, prej 15 milion euro.

- Krijimi i skemave për mbështetjen e start-up por edhe SME-ve të drejtuara nga femra për subvencionimit të interesave bankare të kredive.

- Krijimi i skemave të venture capital, business angels, innovation voucher, etj.
- Aplikimi i instrumenteve të tjerë financiare si:
 - o Zbatimi e zgjerimi i faktoringut;
 - o Zbatimi e zgjerimi i leasingut;
 - o skema te garantimit;
 - o skema te garantimit publik-privat;
 - o etj.

Do të sigurohet mbështetja financiare për 100 biznese të udhëhequra nga gratë nëpërmjet kredive me interesa të ulta.

1.3.2. Rritja e fondeve për mikrokredi.

Do të vazhdoj mbështetje e institucioneve jo financiare me fond të mikrokredisë nga donatorë të huaj e programe rajonale si fondi EFSE, si dhe nga qeveria shqiptare për të zgjeruar skemat e mikrokredisë në të gjitha zonat rurale e urbane.

Krijimi i programit për mbështetjen e rreth 1000 bizneseve të reja (start up), nëpërmjet fondeve grant dhe kredi me interesa të ulta.

1.4. Nxitja e konkurrueshmërisë së SME-ve dhe inovacioni

Konkurrueshmëria e bizneseve shqiptare është përmirësuar nga vitit në vit, por si objektiv i rëndësishëm për periudhën 2013-2020 mbetet :

Rritja e mëtejshme e konkurueshmërisë së ekonomisë duke përmirësuar vlerësimin nga 4.06 pikë në vitin 2012 në 4.5 pikë në vitin 2020 (sipas raportit të GCI).

Synohet që për periudhën 2013-2016, do të zbatohet Programi Strategjik për Zhvillimin e Inovacionit dhe Teknologjisë të SME-ve për periudhën 2011-2016 miratuar me Vendimin Nr. 104, datë 09.02.2011 të Këshillit të Ministrave.

Objektivi kryesor i zhvillimit të programit strategjik është:

- **Rritja e aftësisë së bizneseve shqiptare për të zhvilluar, përdorur, përshtatur dhe komercializuar teknologjinë.**

Kjo do të arrihet nëpërmjet mbështetjes me instrumentet financiare të përshtatshme të orientuar drejt zhvillimit të produkteve të reja dhe stimulimit të SME-ve për të përdorur dhe përshtatur teknologji të reja. Kjo do të kontribuonte në përmirësimin e konkurrencës së industrisë shqiptare si në tregjet vendase ashtu edhe në ato të huaja. Rritja e kapacitetit teknologjik të SME-ve shqiptare do t'i ndihmojë të konkurrojnë me më efikasitet dhe do të mbështesë integrimin ekonomik të Shqipërisë në tregjet globale. Gjithashtu, përmirësimi i kapaciteteve teknologjike të bizneseve, për t'i bërë ato më konkurruese, do të jetë një hap i rëndësishëm për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

- **Mbështetja e inovacionit të biznesit** – për ofrimin e ndihmës ndaj Ofruesve të Shërbimeve të Biznesit (BSP-ve), si Agjencitë e Zhvillimit Rajonal (ARZH-të) dhe këshillimet, për të rritur kapacitetin njerëzor në auditimin e teknologjisë, menaxhimin e inovacionit, dhënien e informacionit si dhe lehtësimin e financimit për ndërmarrjet. Ky element ofron ekspertizën për t'u siguruar që financimi të ketë përfitime optimal. Pjesë e këtij objektiv është edhe plotësimi i boshllëkut institucional në Sistemin Kombëtar Shqiptar të Inovacionit. ***Do të përfitojnë rreth 500 biznese me informacione e grante nga disbursimi i Fondit të Inovacionit.***

- **Zhvillimi i infrastrukturës do të mundësojë :**
 - i) Krijimin e inkubatorëve (si në terma të hapësirës fizike ashtu edhe në ato të zhvillimit të shërbimeve për mbështetjen e biznesit) me detyrën për të ofruar një mjedis të favorshëm, për të favorizuar suksesin e mundshëm në shfaqjen e iniciativave të reja inovative të biznesit, duke krijuar vendeve të reja të punës, mundësi biznesi dhe rritje të vlerave, nëpërmjet rritjes së shëndetshme të bizneseve të reja inovative. **Do të ndërtohen 1 inkubatorë teknologjik i biznesit.**
 - ii) Mbështetjen e cluster-it të bizneseve në sektorë kyç, duke ofruar mbështetje për platformat bashkëpunuese, gjë që mund të mundësojë dhe mbështesë bashkëpunimin strategjik midis ndërmarrjeve dhe organizatave të tjera, për rritjen e zinxhirit të vlerës së produkteve dhe shërbimeve, duke favorizuar ndërkombëtarizimin dhe aksesin në tregje të reja. **Do të ngrihen 3 klastera të reja.**
- **Zhvillimi i kapaciteteve dhe transferimi i teknologjisë** do të arrihet përmes sigurimit të informacionit, projekteve demonstruese, programeve të ndihmës teknike, trajnimeve të fuqisë punëtore dhe mbështetjes së institucioneve teknike, të tilla si qendrat e ekselencës dhe qendrat e inovacionit.
- **Nxitje për mundësi të reja biznesi në moshën dixhitale:**
- Një përdorim sa më i mirë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), do të jetë në shërbim të zhvillimit të bizneseve. Nisur nga fakti se TIK është një ndër instrumentet kryesor që shërben për rritjen ekonomike dhe në veçanti për një rritje më të shpejtë të SME-ve. Mbështetur edhe në axhendën dixhitale dhe të iniciativave flagship të politikës industriale të BE-se, fokusi qëndron në: *shfrytëzimin maksimal të potencialeve që ofron TIK, si në fushën e ofertës, për produkte dhe shërbime të reja dixhitale, ashtu edhe në anën e kërkesës, për një përdorim të zgjuar (smart) të këtyre teknologjive.* Duke ditur se tregu shqiptar është pjesë e kërkesës, investimi në teknologjinë dixhitale është e vetmja zgjidhje, ku çdo SME mund të bëhet konkurruese. Nga ana tjetër kjo konsiderohet për biznesin si një mundësi dhe njëkohësisht sfidë, pasi bizneset e vogla janë më pak të pajisura dhe i nevojitet kohë të kapitalit financiar për aplikimin e këtyre modeleve të reja të biznesit.
- “*Digital entrepreneurs*” konsiderohen ato biznese që shfrytëzojnë maksimalisht produktet dhe shërbimet dixhitale, duke përfshirë “cloud computing” (që i referohet të gjitha aplikimeve dhe shërbimeve të ofruara nëpërmjet internetit) që ndihmon në rritjen e konkurrueshmërisë. Në këtë kuader iniciativa e BE-se: “*Përdorimi i zgjuar i teknologjisë së informacionit dhe integrimi i SME-ve në zinxhirin e vlerave të industrisë globale*” ndihmon SME-t shqiptarë që të bëhen pjesë e rrjetit dixhital botëror.
- Objektivi i rëndësishëm mbetet ndërmarrja e një *fushate ndërgjegjësimit* për sipërmarrësit dhe SME-t të mbi përfitimet që sjell evolucioni i ri dixhital, nxitja dhe promovimi i historive të suksesit në tregun shqiptar. Gjithashtu puna për të lehtësuar dhe ndihmuar që kompanitë shqiptare të bëhen pjesë e *networkut të Mentoreve European*, për qëllime trajnimi, këshillimi dhe për tu përfshirë sa më shumë në biznesin dixhital dhe për krijimin e partneriteteve të reja. Një përdorim sa më i mirë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), aq më shumë do të ndihmohen bizneset që të zhvillohen, duke filluar me shërbimet qeveritare ato bankare me shërbimet dhe informacionet rreth produkteve të SME-ve dhe shërbimeve në përgjithësi. Të gjithë sektorët mund të përfitojnë nga hyrja online dhe përdorimi i teknologjisë moderne për promovimin, shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të tyre në tregje deri tek konsumatori përfundimtar.
- *Puna do të fokusohet në fuqizimin dhe mbështetjen e bizneseve fillestare start-ups për shërbime dixhitale dhe web dhe për alternativa në mbështetje financiare, siç janë skemat innovation voucher për TIK; për të garantuar një përdorim sa më të mirë të fondeve*

Europiane për rrjetin web dhe sipërmarrjen dixhitale, sipas prioriteteve dhe rregullave të zbatimit.

Përmirësimi i shërbimeve ndaj biznesit. Një rëndësi të madhe merr përmirësimi dhe shtimi i shërbimeve ndaj biznesit, nëpërmjet plotësimit dhe fuqizimit të portalit për SME-t, si dhe rrjetit me qendrat e informimit të biznesit; Kryerja çdo dy vjet e Analizës së nevojave për trajnime për biznesin, TNA; Menaxhimi i skemave të financimit për inovacionin, përmirësimi i shërbimeve on line për trajnime, pagesa, informacione, etj.

Sa i takon pagesës on line çdo sipërmarrës në Shqipëri që ka në përdorim një smartphone ose një tabelat për shërbimeve të internetit, nuk është me i detyruar të shkojë tek zyrat e tatimeve për tu njohur me detyrimet e taksave apo të shkoje në sportelet e bankave për të bërë pagesën. ***Për vitin 2013, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve po i mundëson biznesit që të kryejnë dy aplikacione të reja nëpërmjet telefonit celular; i) aplikacioni i parë i pagesës elektronike i mundëson biznesit që të krijojë llogarinë e tij elektronike tek tatimet dhe njëkohësisht të lidhet me bankat për të bërë pagesën, pa qenë nevoja të jetë prezent fizikisht; ii) aplikacioni i dytë është mobile-tax (taksa nga celulari), nëpërmjet të cilit çdo tatim pagues në çdo kohë mund të marrë informacion nga administrata tatimore për të paguar në kohë detyrimet.***

Me qellim për të nxitur më tej shërbimet ndaj biznesit po zbatohet :

Përhapja e metodës së bërthamës që synon mobilizmin e sipërmarrësve individuale, veçanërisht të SME-ve, nga ana tjetër edhe stimulimin e proceseve të zhvillimit organizativ në bazë dhome tregtie apo shoqata biznesi. Zhvillimi i kësaj metode, e cila gjen zbatim edhe nëpërmjet asistencës teknike që sigurohet nga projekti GIZ/EDEP, synon të krijojë një platformë organizative ku sipërmarrësit të mund të flasin hapur, të identifikojnë më mirë problemet e tyre, të krahasojnë veten me të tjerët (benchmarking), të përcaktojnë kërkesën e tyre për shërbime, të zhvillojnë vetëbesimin dhe të përmirësojnë biznesin e tyre. Ky proces lehtësohet me caktimin e konsulentëve të akredituar për SME me metoden e bërthamës (Nucleus approach).

Gjithashtu në kuadër të shërbimeve të biznesit, gjatë viteve të zbatimit të kësaj strategjie do të organizohet ***çdo vit, në muajin Tetor, java e sipërmarrjes dhe biznesit të vogël***, që do t'i shërbejë rritjes së ndërgjegjësimit dhe bilancit të arritjeve në zbatimin e kësaj strategjie në mbështetje të SME-ve.

1.5 Krijimin e një partneriteti midis qeverisë dhe biznesit në lidhje me nevojat për përmirësimin e teknologjisë, inovacionit dhe aftësisë për të përgatitur fuqi punëtore të kualifikuar.

Konsultimi me biznesin në Shqipëri është vlerësuar edhe nga Institucione ndërkombetare, ku krahas anës pozitive të krijimit me ligj të Keshillit Konsultativ të Biznesit (KKB), konstatohet se ka vend për të rritur efikasitetin e procesit të konsultimit, për ta bërë KKB-n një zë të fuqishëm pranë qeverisë.

Kjo do të arrihet me disa masa konkrete:

i) Rëndësia e nivelit të perfaqësimit në KKB

Në Shqipëri numërohen dhjetra shoqata të biznesit. Perzgjedhja e tyre si interlokutor me Qeverinë, nuk është bërë mbi bazën e një studimi mbi nivelin e perfaqësimit, por thjesht mbi reputacionin e tyre në nivel kombëtar, që në të shumtën e rasteve është produkt i mediave. Lind si domosdoshmeri ndërmarrja e një studimi për të vlerësuar nivelin e perfaqësimit të këtyre shoqatave në shkallë kombëtare. Ka vend që ***te rishikohet përberja e KKB, duke antaresuar organizata aktive me karakter sektorial që kontribuojnë në rritjen ekonomike të vendit.***

ii) Rritja e numrit të akteve që konsultohen.

Eshte detyre e KKB per te punuar intensivisht ne drejtim te sensibilizimit te institucioneve qendrore qe te sjellin per konsultim aktet qe propozojne te miratojne.

iii) Rritja e cilesise se konsultimit.

Pervec pjesmarrjes active te cdo organizate biznesi te perfaqesuar ne kete keshill, do te realizohet nje faqe WEB, ku te gjitha projekt aktet qe vijne per mendim ne KKB te gjejne pasqyrim. Mendimet qe mund te vijne edhe nga grupe interesi jashte antaresise se KKB, do te merren ne shqyrtim dhe te vleresohen nga nje komision i posacem. Rregullat e konsultimit ne kete rast do te percaktohen ne Rregulloren e funksionimit te KKB-se.

iv) identifikimi dhe vendosja e prioriteteve ne ceshtjet qe kufizojne veprimtarine e biznesit dhe te investimeve.

Shume shoqata te biznesit nuk kane burimet dhe kapacitetin organizativ per te rritur ne menyre efektive rolin e tyre, duke filluar nga Dhomat e Tregtise dhe Industrise, shoqata etj . Nuk transmetohen tek antaresia e tyre aktet qe diskutohen ne KKB, duke kufizuar keshtu ardhjen e mendimit te konsultuar biznesit ne Keshill.

Eshte i pamjaftueshem kontributi i biznesit ne mbeshtetjen e reformave te qeverise per politikat per te permiresuar klimen e biznesit, per rritjen e produktivitetit dhe konkurruesmerise. Mbi te gjitha mungojne alternativat e propozuara nga vete biznesi, qofshin te natyres ligjore apo administrative me synimin per te stimuluar sektoret prodhues, eksportet, investimet, lehtesim te skemave te financimit te biznesit, kualifikimit, trainime, transferimin e teknologjive, etj, me impakt ne rritjen e konkurruesmerise se ekonomise se vendit.

- Megjithese ne rregulloren e brendeshme te funksionimit te KKB, eshte e percaktuar qarte, funksionimi i komisioneve keshillimore te punes, deri tani nuk ka patur asnje propozim konkret ne funksionimin e komisioneve te tilla " **ad hoc**".

Ne keto kushte do te punohet ne:

1. Forcimin e kapaciteteve te Keshillit Konsultativ te Biznesit, (KKB), lidhur me kompozimin e tij si dhe koordinim me te mire me antaresine e tij.
2. Mbeshtetje per forcim kapacitetesh te organizatave te Biznesit, si: Dhomat e Tregtise dhe Industrise, Agjencive Rajonale te Biznesit, shoqatave te grave ne biznes, organizatave jo qeveritare/OJF etj.

1.6 Forcimi i kapaciteteve institucionale.

Realizimi i objektivit per rritjen e konkurruesmerise se SME-ve si dhe forcimi i kapaciteteve teknologjike te tyre, nuk mund te konsiderohet i suksesshem, nese nuk shoqerohet me forcim dhe zhvillim kapacitetesh administrative qe nga niveli i polit bërjes ashtu edhe nga agjencite implementuese si AIDA dhe AKTI, etj. Per kete qellim synohet qe ne fazen e zbatimit te kesaj strategjie, do te punohet ne drejtim te:

3. Forcimit te kapaciteteve ne METE/ DPK,
 - Krijimi i sektorit per politikat e sipermarrjes dhe SME-te
 - krijimi i sektorëve për politikat për transferim teknologjie dhe inovacion,
 - krijimi i sektorit për reformën në legjislacionin tregtar dhe klimën e biznesit
4. Forcimi i kapaciteteve ne AIDA:
 - Fuqizimi i stafit te BRIC, lidhur me shërbimet dhe skemat e menaxhimit të fondeve për inovacionin

- Forcimi i kapaciteteve të departamentit për SME-të dhe eksportet lidhur me shërbimet dhe skemat e menaxhimit të garanteve për konkurrueshmërinë, dhe ekonominë kreative, etj.

2. Objektivat për sektorin e industrisë dhe minierave

Industria Prodhuese:

Zhvillimi i sektorit të industrisë prodhuese për një periudhe afatmesme të zhvillimit të saj konsiderohet prioritet i qeverisë. Janë një numër arsyes dhe faktorësh që ndikojnë për të ndjekur një politike industrial pro aktive:

- Arritjet e deritanishme në realizimin e objektivave, kërkojnë transformime strukturore, duke lëvizur nga vlera e ulët produktive në atë më të lartë. Dhe zhvillimi industrial është rruga më efiçente për të arritur një transformim të tillë, në veçanti duke nxitur zhvillimin e sektorëve me nivel të mesëm dhe të lartë teknologjik industrial.
- Shqipëria disponon një sektor bujqësor të pazakont krahasuar me vendet e zhvilluara, të marra së bashku në prodhim dhe punësim, që zë pothuaj gjysmën e forcave të punës. Meqenëse vendi zhvillohet dhe urbanizohet, punësimi në bujqësi tenton që të bjerë me shpejtësi. Ky ndryshim do të kërkonte krijimin e vendeve të reja të punës edhe në sektorët jo bujqësor, kryesisht në industri dhe shërbime. Sektori i industrisë ka shanse më të mëdha, që gjeneron punësim, krahasuar me shërbimet tradicionale.
- Me qëllim për të mbyllur këtë boshllëk zhvillimi me vendet e tjera europiane dhe për reduktimin e varfërisë, nevojitet të sigurojmë nivele të larta të rritjes në vitet që do të vijnë. Eksperienca ndërkombëtare ka treguar se në asnjë vend nuk ka qenë e mundur të gjenerohet rritja e vazhdueshme dhe reduktimi i varfërisë, pa zhvillimin e sektorit të industrisë.
- Shqipëria akoma rezulton me një deficit të lartë tregtar dhe mundësia për përmirësimin e këtij bilanci tregtar, vjen duke rritur eksportet e produkteve industrial.
- Zhvillimi industrial krijon mundësi të mëdha për rritje të qëndrueshme, krijon vende pune dhe reduktim të varfërisë. Qëllimi i politikës industriale është për të transformuar ekonominë e vendit, në një ekonomi të drejtuar nga industria, dinamike dhe me orientim nga eksportet.

2.1. Objektivat strategjike për sektorin e industrisë janë:

- Zgjerimi, diversifikimi, fuqizimi i sektorit të industrisë dhe rritja e kontributit në prodhim;
- Rritja e nivelit të punësimit ;
- Rritja e eksporteve të produkteve industriale dhe përmirësimi i bilancit tregtar;
- Rritja e kapaciteteve teknologjike që do të çojnë drejt vlerës së shtuar të produkteve dhe me teknologji të lartë.

Politikat industriale nuk do të fokusohen vetëm në tregun lokal, por do të përfshijnë edhe komponentë të promovimit të eksporteve. Shqipëria duke qenë një treg i vogël, një zhvillim i qëndrueshëm industrial kërkon akses në tregjet e huaja, që ofrojnë mundësi të reja për zgjerim të eksporteve, duke përfutur kështu nga ekonomitë e shkallës. Eksportet gjithashtu sigurojnë valutë të huaj, që ndikon në uljen e kostos së importit të inputeve ndërmjetëse dhe mallrave, në veçanti për teknologji të reja për industrinë e vendit.

Drejtimet kryesore të zhvillimit industrial do të orientohen drejta:

- Zgjerimit dhe përmirësimit të industrive ekzistuese, duke adoptuar teknologji të reja dhe duke rritur konkurrueshmërinë;
- Zhvillimit të industrisë nëpërmjet zhvillimit të klasterave industrial;
- Diversifikimit, drejt industrive të reja me nxitjen e investimeve të huaja direkte.

2.2. Objektiva specifike

Zhvillimi i industrive prodhuese konsiderohet një ndër prioritetet e programeve të zhvillimit nga ana e qeverisë. Industria prodhuese ka provuar se është nxitësi kryesor i rritjes së qëndrueshme, sepse është nxitësi kryesor i inovacionit dhe përmirësimeve teknologjike, që konsiderohen faktorët kryesor të rritjes.

Gjithashtu prodhimi industrial krijon efekte “ spillover” në sektorë të tjerë të ekonomisë si në drejtim të progresit teknologjik dhe atij të përmirësimit menaxherial. Është nxitës gjithashtu për zhvillimin e sektorit financiar, të infrastrukturës, etj.

2.2.1 Zhvillimi i prodhimit industrial që mbështet në burimet bazë të prodhimit, në veçanti në prodhimin e lëndëve të para, metaleve të përpunuara, prodhimit të materialeve të ndërtimit që bazohen në mineralet e vendit, duke rritur zinxhirin e vlerës.

2.2.2 Zhvillimi i industrisë ricikluese, e cila ka shumë mundësi zhvillimi për tu zgjeruar, veçanërisht në fushën e metaleve, të plastikës, xhamit dhe letrës dhe mbi të gjitha zhvillimi i kësaj industrie krahas potencialit ekonomik është një kontribuese në ruajtjen e mjedisit. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve dhe rritja e efciences së burimeve.

2.2.3 Fuqizim dhe diversifikim i mëtejshëm i operacioneve të përpunimit aktiv (fason)

Arritja e këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet mbështetjes financiare për ndërtimin e kapaciteteve njerëzore, për prodhuesit e tekstileve dhe të këpucëve, për të krijuar ndërmarrje të pavarura dhe eksportues direkt. Gjithashtu qeveria do të stimulojë diversifikimin e përpunimit aktiv në sektorë të tjerë, siç janë produktet mekanike, ose montimet e nyjeve apo pajisjeve elektronike duke tërhequr prodhues të teknologjisë së larte.

Nisur nga rëndësia dhe kontributi i sektorit të fasonit në prodhimin për eksport si dhe në zënien me punë të forcave të lira, edhe për vitet në vazhdim, kjo veprimtari industriale zë një vend të rëndësishëm në objektivat e kësaj strategjie. Në këtë kuadër METE dhe AIDA parashikojnë të ndërtojnë një program të koordinuar me mbështetje financiare që mundëson kompletimin e teknologjisë si dhe një sërë shërbimesh cilësore në fushën e marketingut ndërkombëtar për penetrim në tregje të caktuara Rajonale dhe Europiane. Realizimi i këtij objektivi do të ndihmojë që ndërmarrjet ekzistuese dhe ato të reja që do të krijohen, të mundësojnë realizimin e produktit 100% me cikël të plote, duke u kthyer në ndërmarrje autonome dhe njëkohësisht si eksportues

direkt. Procese industriale të kësaj natyre ndikojnë gjithashtu në përmirësimin e kulturës menaxheriale prodhuese.

Sipas INSTAT, referuar anketës strukturore të ndërmarrjeve (ASN), për vitin 2010 operojnë mbi 990 ndërmarrje, kryesisht në fushën e tekstil veshjeve dhe të lëkurë-këpucës. Synimi është për të rritur gamën e produkteve me përpunim aktiv, duke u shtrirë edhe në sektorin e pajisjeve elektronike, mekanike, etj.

Nisur nga pozicioni gjeografik i Shqipërisë, e pozicionuar mjaft mirë pranë tregjeve Europiane synohet që të zhvillohen *operacione montimi* për gjysmë produkte ose produkte të plota, që mund të kenë si destinacion tregjet përtej oqeanit. Nisur nga avantazhi i kostos së transportit, ky lloj aktiviteti industrial e justifikon si mjaft fisibël për të ardhmen e këtij sektori. Industritë e kësaj natyre janë dhe ato që mund të ndërtohen mbi bazën e zhvillimit të tregtisë Evropë – Kinë; Amerikë etj. *Me realizimin e këtij objektiv synohet që të rritet mesatarisht 2-4 % në vit prodhimi i ndërmarrjeve që operojnë me përpunim aktiv.*

2.2.4 Nxitja e prodhimeve artistike, artizanatit, qeramikës dhe prodhimeve të drurit

Këto produkte të specializuara do të mund të plotësojnë kërkesën ekzistuese të tregut evropian për produkte tradicionale shqiptare. Kjo industri mund të zhvillohet me sukses me një mbështetje të vogël nga qeveria për faktin se ajo përdorë inute me kosto të lire dhe angazhon fuqi të madhe punëtore.

- *Stimulimi i prodhimit industrial i tipit “produkte të konsumit të gjerë”.*

Me zhvillimin e teknologjisë shumë produkte industriale nga importi kanë hyrë në sektor duke dominuar mbi produktet artizanale. Teksa sektori artizanal kalon kohë të vështira në të gjithë Evropën, në Shqipëri situata u bë kritike për sektorin e artizanatit tradicional. Për shkak të vështirësive të vendit në tranzicion të rinjtë e konsideronin traditën shqiptare si të vjetëruar. *Sot artizanët nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për të investuar në zhvillimin e produktit.*

Niveli i ulët i organizimit sidomos në zonat rurale shkakton një zhvlerësim të produkteve të trashëgimisë kulturore. Për shkak të diferencimit të ulët të produkteve, ka një konkurrencë të lartë gjë që krijon zhvlerësim të produktit.

Kompanitë e huaja nga vendet fqinje si Italia apo Greqia zbuluan avantazhe për të prodhuar në Shqipëri në sektorë si industria e këpucëve dhe veshjeve, por ka shume pak kompani të huaja që prodhojnë suvenire, dekorime të brendshme, produkte druri ose qeramika.

Tregu në rritje i turizmit është një treg interesant për shitjet e produkteve artizanale.

Zhvillimi i këtyre industrive, konsiderohet një alternative e re për tregun shqiptar, pasi është e kombinuar me inute me kosto të ulët. Ky lloj prodhimi synon konkurrueshmërinë në tregjet Europiane, duke aplikuar çmime të ulta.

Duke synuar krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta me kapital të huaj për këto lloj industrish, Shqipëria ka shanset të specializohet në këto lloj produktesh. Synohet për të nxitur ato biznese që mund të ofrojnë produkte me karakteristika të dallueshme të etnicitetit. Prioritet në këtë drejtim merr industria e artizanatit, qeramikës dhe drurit që do të orientohet në krijimin e produkteve të reja 100% me origjinë shqiptare për të cilat konsumatori evropian është sensitiv. Përveç masave që do të ndërmerren nga qeveria në sigurimin e fondeve për mbështetjen e sektorit të artizanatit, bashkëpunimi me shoqatat e biznesit merr një rëndësi të veçantë. Përveç kontributit të qeverisë dhe në bashkëpunim me donatorët, fokusi i mbështetjes së këtij sektori do të përqendrohet në: i) zhvillimin e produktit; marketingun dhe; iii) Kualifikimi dhe ndërtimi i kapaciteteve.

Me realizimin e këtij objektiv, synohet të kemi një rritje të produktit të këtyre ndërmarrjeve industriale mesatarisht 2-4% në vit.

2.2.5 Rritje të gamës së produkteve ekologjike që bazohen në përdorimin e efektshëm të burimeve për prodhimin e pastër

Bazuar në ecurinë e zbatimit me sukses të programit të Kombeve të Bashkuara për zhvillim Industrial (UNIDO) dhe atij për mjedisin (UNEP), nën drejtimin e njësisë zbatuese të këtij programi ECAT –Tirana, janë mbështetur rreth 30 kompani në sektorin hoteleri-turizëm, agro-industri dhe industrinë minerare. Si rezultat i praktikave të deri tanishme, duke identifikuar instrumentet ligjor për integrimin e përdorimit të efektshëm të burimeve dhe prodhimit të pastër, synohet që nëpërmjet këtij programi dhe nga vetë shoqatat e biznesit si dhe qeveria, do të ndikojnë në rritjen e numrit të ndërmarrjeve industriale që mbështeten në prodhimin e pastër. *Synohet që me realizimin e këtij objekti, të rritet mesatarisht 3-5 % në vit, numri i kompanive që aplikojnë prodhimin e pastër në Shqipëri.*

2.2.6 Rritja e investimeve në kërkimin shkencor dhe zhvillimi i produkteve të reja dhe inovacioni në industrinë e prodhimit

Investime të tilla do të rritin kapacitetet teknologjike të prodhuesve vendas duke i orientuar drejt produkteve me teknologji të mesme dhe të lartë.

Gjithashtu zhvillimi i parqeve industriale dhe teknologjike do të kanë impakt në rritjen dhe diversifikimin e produkteve industriale dhe rritjen e prodhimit industrial si i tërë.

Për arritjen e këtij objekti kërkohet një kooperim ndërmjet industrisë, komunitetit kërkues-shkencor, universiteteve dhe institucione publike.

Ky objektiv do të arrihet gjithashtu duke përmirësuar dhe rritur kooperimin ndërkombëtar ndërmjet partnereve të biznesit, duke fuqizuar kooperimin teknologjik dhe profesional, duke përmirësuar praktikën e marketingut të produkteve, teknikat e produktivitetit dhe nëpërmjet tërheqjes së investimeve të huaja direkte.

Rritja dhe zhvillimi i investimeve në kërkimin shkencor dhe inovacion do të ketë një impakt në rritjen dhe diversifikimin e produkteve industriale, për rrjedhojë *rritjen e prodhimit industrial me rreth 7,5% në vit.*

2.2.7 Krijimi i klasterave industrial me qëllim rritjen e vlerës së shtuar të produktit vendas

Krijimi i klasterave industrial do të përmirësojë kooperimin dhe specializimin, të nxis zhvillimin rajonal dhe do të përmirësojë konkurrueshmërinë e produkteve.

Qëllimi i zhvillimit të klasterave industriale është që të rrisë prodhimin kombëtar me vlerë të shtuar. Bazuar në strategjinë e zhvillimit të inovacionit për biznesin, synohet nxitja e bashkëpunimit nëpërmjet inovacionit dhe ndërkombëtarizimit. Do të sigurohet një bashkëpunim i ngushtë midis kompanive industriale dhe institucioneve mbështetëse për të arritur sukses në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nëpërmjet krijimit të klasterave industriale, do të ketë ndikime pozitive edhe në zhvillimin rajonal; bashkëpunim më të mirë ndërmjet institucioneve të specializuara qofshin publike dhe private; rritjen e ndërkombëtarizimit të këtyre industrive si dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produktit. *Synohet që deri në vitin 2020 të ngrihen 3 klastera industriale.*

2.2.8 Nxitja dhe mbështetja e ndërmarrjeve industriale (spill over effect).

Në kushtet e një konkurrence globale, lind si një nevojë mbështetja për ato ndërmarrje që kanë shanse biznesi të integrohen në zinxhirin e vlerës së investimeve industriale me kapital të huaj. Me mbështetjen e qeverisë dhe agjencive të specializuara si AIDA, lind si domosdoshmëri hartimi i projekteve për rritjen e aftësive dhe mjeshtrive specifike në përputhje me interesat e investitorëve të huaj që operojnë në tregun shqiptar. Zakonisht industrinë e sofistikuara si ato elektronike, etj, krijojnë mundësitë të nënkontraktujnë një sërë ndërmarrjesh të vogla dhe të

mesme ne prodhimin e disa agregateve (produkte, paisje, nyje etj) të produktit të tyre, që rezultojnë të jenë me kosto më të ulët se sa importi.

Ky objektiv duket i vështirë në stadin aktual, për faktin se ka mungesë kapacitetesh të specializuara. Megjithatë mbetet i mundshëm dhe synohet për ta programuar si një projekt afatgjatë duke filluar me mbështetjen e ndërmarrjeve që mund të prodhojnë për nevojat e kompanive të mëdha vendase si dhe ato ndërkombëtare.

Zhvillimi i kapaciteteve të tilla industriale, vlerësohet edhe në kuadrin e politikës "import substitution", duke çliruar fonde si rezultat i zvogëlimit të importit për këto produkte.

Synohet që të vlerësojmë procesin e kooperimit ndërmjet investitorëve të huaj me industrinë lokale, duke vlerësuar një rritje të këtij prodhimi mesatarisht 0,5-1% në vit.

2.3 Industria minerare

Shqipëria është e njohur relativisht për burime të pasura minerale, në veçanti për krom, bakër, nikel, titan-magnetite dhe një numër të madh mineralësh jo-metalore. Industria minerare tradicionalisht ka qenë shtylla kurrizore e ekonomisë shqiptare. Nga viti 1970 deri në vitin 1990, Shqipëria ishte një nga prodhuesit kryesor të mineralit dhe produkteve të kromit dhe një eksportues i rëndësishëm për nënproduktet e bakrit, nikelit, metaleve të tjerë të përpunuara dhe mineraleve të ndryshme. Komplekset e mëdha industriale kanë operuar në një proces të rritjes së vlerës së mineraleve në mënyrë të integruar në formë të një zinxhiri që fillonte me prodhimin e xeheroreve nga minierat për të vazhduar më tej në proceset e pasurimit, përpunimit metalurgjik dhe fabrikimit të produkteve metalore.

Për shkak të tranzicionit të vështirë ekonomik, ristrukturimit dhe fillimit të investimeve në sektor ritmet e zhvillimit u vonuan për gati një dekadë. Pas viteve 2000 me efektin e reformave të ristrukturimit të sektorit, që u hapën rrugë investimeve në industrinë e minierave, sektori filloi rimëkëmbjen dhe të zhvillohet. Investimet janë fokusuar në kërkim-zbulim dhe shfrytëzim, (si nëpërmjet hapjes dhe riaktivizimit të minierave ekzistuese dhe zhvillimin e atyre të reja), si dhe në riaktivizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së përpunimit të mineraleve.

Megjithatë, sektori është larg realizimit të potencialit të tij të plotë dhe zhvillimi i tij do të mbetet një prioritet dhe në vitet e ardhshme.

Objektivi strategjik është: Transformimi i sektorit minierar në një industri bazë të ekonomisë shqiptare që do të nxisë dhe furnizojë zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, rritjen e eksporteve dhe të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Objektivat kryesore në industrinë minerare do të jenë:

- Vazhdimi i punës për kërkimin-zbulimin e rezervave dhe burimeve minerale të vendit. Kjo do të përfshijë kërkim-zbulimin e thelluar të zonave me burime minerale të identifikuar, kërkim-zbulimin në zonat e reja të vendit, dhe zgjerimin e gamës së mineraleve të zbuluara.
- Ngritja e një sistemi kombëtar të informacionit gjeologjik dhe minierar i cili do të reflektojë të dhënat e fundit dhe statistikat e mbledhura nga veprimtaritë e kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit. Ky sistem do të adaptojë standardet ndërkombëtare të klasifikimit të burimeve dhe rezervave minerale dhe të gjithë treguesit e tjerë të lidhura me rezervat dhe veprimtarinë minerare.
- Zhvillimi i industrisë së shfrytëzimit të mineraleve, duke rritur kapacitetin e minierave ekzistuese dhe nëpërmjet hapjes dhe zhvillimit të minierave të reja në të gjitha vendburimet e njohura. Në këtë drejtim duhet të bëhen përpjekje për të inkurajuar konsolidimin e veprimtarisë minerare në minierat ekzistuese të fragmentuara dhe për të tërhequr investimeve kapitale të mëdha në zonat e minierave të reja. Veprimtaria minerare për mineralet e kromit, bakrit do të zhvillohet me anë të

zgjërimit të minierave ekzistuese, si dhe hapjes dhe zhvillimit të minierave të reja; pas shumë viteve të veprimtarive të kërkim-zbulimit, nikeli do të zhvillohet dhe konsolidohet në drejtim të veprimtarive të shfrytëzimit. Veprimtaria minerare do të zgjerohet në shfrytëzimin e mineraleve të reja metalike, të tilla si titan-magnetiti, zinku, boksidet, etj. Shfrytëzimi i mineraleve jo-metalore do të jetë gjithashtu një objektivi i madh, në veçanti rërat bituminoze.

•Përpunimi në Shqipëri i mineraleve me qëllim rritjen e vlerës së mineraleve të nxjerra si një vlerë e shtuar në vend dhe për të siguruar lenden e parë për zhvillimin e industrive të tjera në vend. Objektivi është të arrihet në përpunimin e plote në vend të të gjithë mineraleve dhe për të reduktuar në zero eksportin e mineraleve të papërpunuara. Arritja e këtij objektivi do të kërkojë zhvillimin e veprimtarive metalurgjike dhe rafinimit në industrinë e bakrit (pyro-metalurgji dhe hydrometallurgji); zhvillimin e proceseve të pasurimit dhe metalurgjike për mineralin e kromit, duke përfshirë prodhimin e ferrokromit dhe produktet e tjerë të kromit metalik; si dhe zhvillimit të proceseve metalurgjike dhe rafinimit për mineralin e nikelit deri në prodhimin e nikelit metalik. Hapa të ngjashme duhet të ndërmerren për titan-magnetitet dhe minerale të tjera metalike, si dhe për përpunimin deri në produkte të gatshme për treg për mineralet jo-metalore.

• 2.4 Objektivat specifike:

2.4.1 Adaptimi dhe modernizimi i legjislacionit minerar shqiptar. Ai do të harmonizojë legjislacionin e sektorit me atë të Bashkimit Evropian dhe do të vendosë standardet ndërkombëtare në sektorin e industrisë minerare. Në veçanti, Qeveria do të përmirësojë dhe plotësojë kuadrin ligjor lidhur me pronësinë e tokës, të drejtat e hyrjes në një pronësi toke dhe të drejtat e hyrjes në një zonë minerare.

2.4.2 Do të vazhdojë me privatizimin e minierave dhe të objekteve të përpunimit të mineraleve. Burimet minerale të Shqipërisë do të zhvillohen nga investitorët privatë përmes veprimtarive minerare të garantuara nga dhënia e të drejtave minerare në forme koncesionare afatgjata dhe investime direkte.

2.4.3 Hapa të mëtejshëm do të ndërmerren në përmirësimin e klimës dhe mjedisit të investimeve dhe krijimit të stimujve për të tërhequr IHD në sektor, përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrueshmërisë. Një objektivi i rëndësishëm do të jetë tërheqja e kompanive minerare të mëdha për zhvillimin e minierave të reja.

2.4.4. Garantimi i realizimit në praktike të veprimtarive minerare të qëndrueshme dhe ekologjike të shëndosha si në minierat ekzistuese dhe ato të reja. Do të hartohet dhe zbatohet kuadri i nevojshëm ligjor për të garantuar veprimtari minerare të qëndrueshme dhe të bazuara në përvojën më të mirë ndërkombëtare. Qëllimi do të jetë për të maksimizuar shfrytëzimin racional të burimeve dhe rezervave minerale duke minimizuar ndikimet negative për mjedisin dhe shoqërinë. Kjo do të kërkojë që planifikimi i veprimtarive minerare duhet të adresojë në mënyrë të kënaqshme të gjitha çështjet e lidhura me mjedisin, ato sociale dhe ekonomike. Lista e çështjeve të tilla nuk do të kufizohet, por do të përfshijë, përmes të tjerave, mbetjet minerare, ndotjen e ajrit, ndikimi i pafavorshëm mbi përdorimin e tokës, biodiversitetin, ndotjen e ujit dhe disponueshmërinë e tij, materialet e rrezikshme, zhurmat dhe vibrimet, përdorimin e energjisë, si dhe efektet ekonomike lokale dhe rajonale. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj politike do të jetë menaxhimi i mirë i mbetjeve minerare, nxitja e procesit të riciklimit, si dhe për të siguruar

mbylljen e plote dhe të sigurtë të objekteve minerare të cilat do të bëhen një pjesë integrale e çdo Veprimtarie minerare sipas konceptit të ciklit të veprimtarisë të një miniere. Për të garantuar realizimin e këtij qëllimi, Qeveria do të krijojë një sistem mbikëqyrje efektiv dhe monitorimi modern të veprimtarive dhe objekteve minerare.

2.4.5 Si pjesë e politikës së mësipërme, do të angazhohen për pjesëmarrje në vendim-marrje për të gjitha çështjet e rëndësishme të zhvillimit të veprimtarive minerare, komunitetet, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë në politikë dhe vendim-marrje, si dhe do të mbahet një ekuilibër në shpërndarjen e fitimit nga veprimtaritë minerare ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale për të bërë këta të fundit të interesuar në zhvillimin e sektorit. Transparenca e veprimtarive minerare do të krijojë përfshirjen në diskutimet për prioritetet e këtij sektori të të gjitha grupeve të interesuara dhe publikut, si dhe do të krijojë një mjedis transparent për investimet e huaja.

2.4.6 Praktikant më të mira minerare do të përfshijnë gjithashtu zbatimin e të gjitha masave dhe të standardeve të nevojshme për të garantuar sigurinë dhe shëndetin në punë. Qeveria do të sigurojë zbatimin e konventave ndërkombëtare në këtë fushë, përfshirë konventën (1995) të ILO-s për sigurinë në punë dhe shëndetin e punonjësve në miniera dhe konventa të tjera të ngjashme

2.4.7 Zbatimi i suksesshëm i politikave të mësipërme do të kërkojë futjen e teknologjive moderne në veprimtaritë minerare, të cilat do të përmirësojnë efikasitetin e sektorit dhe do të krijojnë kushte më të mira për përmbushjen e standardeve mjedisore dhe sociale. Qeveria do të hartojë rregulloret dhe stimujt që do të inkurajojnë adoptimin e teknologjive moderne dhe inovacionin në industrinë minerare.

2.4.8 Ri-vlerësimi i rezervave minerale sipas standardeve ndërkombëtare për klasifikimin e rezervave dhe të burimeve minerale, jetëgjatësia e minierës, cikli i një veprimtarie minerare ciklit, do të jenë koncepte të zbatueshme për veprimtaritë minerare. Aplikimi i sistemit të Kombeve të Bashkuara për klasifikimin e rezervave (EFG), konsiston në krijimin e instrumentit që lejon klasifikimin e burimeve/rezervave e lëndëve të para minerale në mënyre të ngjashme me klasifikimin ndërkombëtar të tyre që aplikohet sot në botë. Do të përfundohet vlerësimi sipas (KNR) Klasifikimit Ndërkombëtar të Rezervave për rezervat minerale të vendburimeve kryesore për mineralet e nikelit silikat, titan-magnetit, rërave bituminoze, bakrit, kromit, të një mase të madhe të vendburimeve të gurëve dekorative

2.4.9 Krijimi i një sistemi të të dhënave gjeologjike dhe të minierave ekzistuese, grumbullimin informacionit gjeologjik nga zonat e reja të kërkim-zbulim dhe të dhënave të minierave të reja që kryejnë veprimtaritë e shfrytëzimit dhe përpunimit, duke përditësuar statistikën për planifikimin mineral dhe promovimin e sektorit të bazuar në të dhënat e prodhimit/rezervat potencial/rezervat e zbuluara;

2.4.10 Nxitjen dhe inkurajimin për proceset riciklimit, zëvendësimi i mineraleve deficitare, shfrytëzimi racional, efektive dhe energji-efiçent i vendburimeve minerale duke synuar një rritje në kapacitetet ricikluese me 5% çdo vit;

2.4.11 Politika aktive të bashkëpunimit dhe koordinimit, bilateral, rajonal dhe më gjerë për të lehtësuar pjesëmarrjen në tregjet ndërkombëtare të mineraleve;

2.4.12 Forcimi i kapitalit mineral dhe rritje të mbështetjes për këtë sektor, për të lehtësuar përballjet e tij me luhatjet e shpeshta të çmimeve të mineraleve;

2.4.13 Zhvillimi i burimeve njerëzore në bashkëpunim me universitetet dhe qendrat kërkimore të Gjeoshkencave duke realizuar kuadrin ligjor për rolin e personit të kualifikuar dhe pozitës së tij në veprimtaritë minerare.

3. Objektivat për eksportet

Drejt një Shqipërie plotësisht të integruar në Tregjet Rajonale, Evropiane dhe Globale.

Rritja e qëndrueshme e eksporteve gjatë viteve të fundit, që vjen si rezultat i një politike liberale, të hapur dhe pa barriera tregtare është treguesi më i mirë i qasjes së ndjekur nga Qeveria Shqiptare në drejtim të nxitjes dhe mbështetjes së eksporteve. Kontributi i eksportit si raport i tij ndaj ndaj GDP është pothuaj dyfishuar krahasuar me vitin 2006 ndërkohë që vihet re një riorientim i eksporteve. Eksporti në vendet CEFTA dhe Turqia po rritet vazhdimisht. Në vitin 2011 eksporti ndaj vendeve CEFTA përbën 13% të totalit të eksportit të Shqipërisë kundrejt 8% në vitin 2006. Gjithashtu, në vitet 2010-2011 kemi një ri-orientim të eksporteve drejt Kosovës dhe Turqisë me rreth 7.5% të eksportit total të Shqipërisë.

Reduktimet në tarifatat doganore nuk janë të mjaftueshme dhe vetëm politikat tregtare nuk mund t'i arrijnë rezultatet e pritshme. Fokusi parësor politikave lidhet me *konkurueshmërinë e ekonomisë* në përgjithësi duke e përqendruar vëmendjen mbi *konkurueshmërinë e eksporteve* si një nga burimet kryesore të gjenerimit të të ardhurave për vendin.

3.1. Objektivi strategjik i eksporteve:

Integrimi në tregjet rajonale dhe ato evropiane nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve për eksport për të përballuar konkurrencën në rritje në këto tregje.

3.2. Objektiva specifike:

3.2.1. Krijimi i një axhende që synon zëvendësimin e importeve.

Investimet në fushën e produkteve industriale kanë dhënë impaktin e vet pozitiv, kryesisht për çelikun dhe çimenton duke sjellë një rritje të ndjeshme të eksportit të këtyre produkteve vitet e fundit. Ndërkohë vihet re që zhvillimet në prodhimin e produkteve bujqësore po marrin një hop të ri. Aktualisht importi i produkteve bujqësore zë 17% të importit total të Shqipërisë ndërkohë që eksporti zë vetëm 5.6% të eksportit total të vendit. Potencialët në vend mundësojnë që të punohet për zëvendësimin e produkteve bazë të konsumit, ku peshën më të madhe e zënë ushqimet dhe kafshët e gjalla.

Për këtë do të punohet me shoqatat e biznesit, kryesisht biznesit bujqësor dhe blegtoral, për të vlerësuar mundësitë e tyre reale për të prodhuar produkte që sot importohen. Gjithashtu fokus të veçantë do të marrë edhe konsultimi me shoqatën për mbrojtjen e konsumatorëve për të kuptuar kërkesat dhe nevojat e konsumatorit shqiptar për prodhime vendi. Pavarësisht fokusit për zëvendësimin e produkteve bazë të konsumit diskutimi me shoqatat e industrisë si Konfindustria dhe shoqata të tjera të biznesit industrial, përbejnë një program konkret punë për të parë mundësitë e zëvendësimit të produkteve specifike. Për këtë duhet të mbështetet krijimi i dialogut dhe zhvillimi i mëtejshëm i organizatave të promovimit, shpërndarjes apo grumbullimit me qëllim rritjen e potencialit për eksport por njëkohësisht të potencialit për shitje në tregun e brendshëm me qëllim zëvendësimin e importeve.

3.2.2. *Reduktimi i kostove administrative dhe eliminimi i barrierave tregtare jo-tarifore.*

Rëndësia që po merr rajoni për eksportet shqiptare është e provuar me shifra. Megjithatë liberalizimi i tregut nuk jep rezultatet e pritshme si rezultat i barrierave tregtare jo-tarifore. Për këtë do të punohet në bashkëpunim me strukturat e CEFTA dhe me OECD në dy drejtime kryesore:

- *Eliminimi i barrierave jo tarifore ex-post.*
 - i. Në bashkëpunim me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, shoqatat e biznesit dhe operoret ekonomike do të azhurnohet vazhdimisht data basë i barrierave tregtare jo-tarifore të ndeshura nga eksportuesit shqiptare në të gjitha vendet e rajonit.
 - ii. Krijimi i një data basë të ngjashëm për eksportuesit shqiptare të destinuar për tregun evropian, turk, etj. Në bashkëpunim me AIDA do të vlerësohet mundësia e krijimit të një database të ngjashëm.
 - iii. Në bashkëpunim me vendet e CEFTA si dhe me strukturat përkatëse shqiptare, si Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes Konsumatorit dhe agjencitë përkatëse zbatuese do të punohet në mënyrë periodike për eliminimin e pengesave jo tarifore për eksportuesit shqiptare.
- *Eliminimi i barrierave ex-ante ne eksportin me vendet CEFTA.* Kjo qasje do të zbatohet për produkte finale dhe produkte të ndërmjetme. Për këto të dytat do të bëhen analiza të detajuara në vitet e ardhshme. Fokusi tek produktet e ndërmjetme do të ndihmojë në propozimin e politikave që do të eliminojnë barrierat tregtare në gjithë zinxhirin e prodhimit të një produkti prioritar për eksport.
 - i. Në bashkëpunim me OECD do të hartohet pyetësi për eliminimin e barrierave jo-tarifore me focus: (1) rregullat teknike në tregti, (2) masat sanitare dhe fitosanitare, (3) procedurat administrative.
 - ii. Vlerësimi i barrierave jo tarifore për një liste prioritare produktesh dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për ndërmarrjen e politikave konkrete.
 - iii. Konsultimi me grupet e interesit i rekomandimeve dhe masave të propozuara.
- *Reduktimi i mëtejshëm i pengesave në logjistikën tregtare dhe harmonizimi i procedurave të çlirimit të mallrave.*

Në bashkëpunim me projektin “Regional Trade and Logistics”:

- i. Vlerësimi i nevojës për ngritjen e një grupi pune në nivel kombëtar për logjistikën tregtare me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Shqipërisë, Ministrisë së Bujqësisë së Shqipërisë, Ministrisë së Financave të Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, agjencive të ndryshme inspektuese që operojnë në kufi, dhe në rast nevojë të palëve të interesuara të sektorit privat;
- ii. Hartimi i planit të detajuar të punës dhe metodologjisë së kërkuar për të realizuar zbatimin e objektivave për reduktimin e pengesave në logjistikë;
- iii. Vlerësimi i mundësive për krijimin e Single Window në doganë për të lehtësuar transaksionet tregtare, reduktuar kohën dhe koston në kalimin e kufirit.
- iv. Konsultimi me grupet e interesit në vend dhe tryezave rajonale me biznesin për të koordinuar veprimet midis strukturave të pikave të kalimit të kufirit midis vendeve të rajonit;

3.2.3. Liberalizimi i tregtisë së shërbimeve me vendet e rajonit.

Vendet e rajonit kanë rënë dakord të vlerësojnë të gjitha hapësirat për të filluar negociatat për liberalizimin e shërbimeve të tregtisë. Shqipëria në statusin e presidentit të ardhshëm të CEFTA-s për vitin 2012 është duke kryer të gjithë procesin e përgatitjeve për të bërë të mundur fillimin e negociatave në 2012. Gjate vitit 2012 dhe në vijim, në varësi edhe të vullnetit të vendeve të rajonit për të hapur tregun e shërbimeve do të punohet për:

- Përgatitjen e matricës së efekteve shtrënguese në zbatim në shërbimet tregtare. Kjo matricë do të zbatohet nga secili vend, në bashkëpunim me formatin e përdorur në marrëveshjen WTO GATS.
- Vlerësimin e sektorëve dhe masave kufizuese relative, duke nënvizuar shkallën e hapjes të secilit vend të CEFTA-s. Kjo do të bëhet nga vendet por për të pasur një vlerësim të paanshëm do të angazhohet gjithashtu një ekspert i jashtëm.
- Vlerësimin e indeksit të kufizimit të shërbimeve të tregtisë. Ky indeks do të matet nga OECD në kuadrin e bashkëpunimit të programit CEFTA për tregtinë dhe investimin.
- Analizën e performancës për shërbimet të cilat janë konsideruar si potenciale për tu liberalizuar midis vendeve të CEFTA. Për këtë deri tani janë identifikuar shërbime të pavarura duke u fokusuar në këshillime ligjore, inxhinierike, arkitekturore, etj.
- Përgatitjen e dokumentit për hapjen potenciale të negociatave për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve në rajon, në sektorë prioritarë.
- Monitorimin e vazhdueshëm të statistikave tregtare për të zgjeruar shkallën e liberalizimit edhe në sektorë të tjerë. Kjo do të paraprihet nga analiza të detajuara për secilin vend.
- Rritja e sinergjive mes prodhuesve rajonalë me qëllim krijimin e një dinamike industriale plotësuese ku produkti final është rezultat i një bashkëpunimi rajonal me kosto më ultra dhe konkurrueshmëri më të lartë në tregjet ndërkombëtare.

3.2.3. Integrimi i mëtejshëm ekonomik rajonal.

Kriza aktuale globale me efektet e saj mbi partnerët kryesorë ekonomikë të Shqipërisë si Greqia dhe Italia, ka efektet e saj edhe në realitetin e biznesit në Shqipëri. Kjo situatë, kryesisht në Greqi, ka sjelle një tkurrje të eksporteve shqiptare duke bërë që nga viti 2010 Greqia të mos jetë më partneri i dytë me i rëndësishëm në eksport për Shqipërinë. Një nga mënyrat për të rritur eksportet mund të jetë integrimi më i fuqishëm ekonomik në tregjet e reja të eksporteve në rajon. Kosova është partneri i dytë me i rëndësishëm në eksport për Shqipërinë që nga vitit 2010. Eksportet tona në Kosovë përbejnë rreth 60% të eksporteve totale me vendet CEFTA. Kjo kërkon një fokus të veçantë për të rritur bashkëpunimin e institucioneve shtetërore dhe atyre të biznesit për të gjetur hapësira të reja bashkëpunimi.

Rritja është e nevojshme për të krijuar punë, prosperitet dhe kushte jetese për të mbajtur njerëzit këtu në rajon duke krijuar kushtet për një rritje të qëndrueshme në sektorin e SME-ve. Bashkëpunimi i suksesshëm me njëri-tjetrin do të çojë së pari në kushte më të mira ekonomike dhe do të jetë një kontribut për të bindur BE-në që rajoni është maturuar dhe gati për në BE. Duke ndjekur këtë arsyetim hapi i parë duhet të jetë një integrim më i thellë midis Kosovës dhe Shqipërisë, duke vendosur kështu ritmin dhe duke krijuar një strukturë për t'u ndjekur edhe me vendet e tjera.

3.2.4. Masa për rritjen e kapaciteteve produktive për eksport.

- **Promovimi**

- Promovimi i produkteve “Made in Albania” nëpërmjet pjesëmarrjes në panairë, konferenca, tryeza rajonale dhe evropiane etj. Nëpërmjet AIDA-s Qeveria Shqiptare do të mundësojë një informim periodik rajonal dhe më gjerë për produktet shqiptare të eksportit. Për këtë kërkohet edhe një bashkëpunim i vazhdueshëm me dhomat e tregtisë dhe industrisë dhe shoqatat e biznesit.
- Asistencë teknike ndaj kompanive eksportuese lidhur me strategjitë e marketingut për eksport dhe planet strategjike në rajon dhe BE.
- Ndërmarrja e aktiviteteve promovuese brenda dhe jashtë Shqipërisë në mbështetje të shërbimeve marketing për kompanitë eksportuese Shqiptare.
- Promovimi i produkteve shqiptare sipas tendencave ndërkombëtare importuese duke nxjerrë më në pah uniken e produkteve ku Shqipëria krijon vlerë të shtuar krejtësisht të veten. Në sektorin e agroindustrisë në veçanti, ka një kërkesë në rritje për produktet BIO ku Shqipëria mund të rrisë eksportet e saj dhe impaktin në punësimin në zonat rurale.
- Përforcimi i aksionit promovues jashtë vendit duke rritur intensitetin e përfaqësimit dhe ndjekjes institucionale të kompanive shqiptare eksportuese nëpërmjet një angazhimi aktiv të rrjetit diplomatik shqiptar, ose nëpërmjet të përfaqësimit të AIDAs brenda rrjetit diplomatik shqiptar jashtë vendit.

○ *Prodhimi*

- Zhvillimi i një sistemi kombëtar për inovacionin, transferimin e teknologjive dhe njohurive (Know How) për kompanitë eksportuese
- Mbështetje në fushën e certifikimit dhe akreditimit të ndërmarrjeve për eksport
- Rritja e kapaciteteve industriale të eksportuesve shqiptarë me qëllim zëvendësimin e importit të lëndëve të para si produkte të papërpunuara me produkte që kanë një përpunim teknologjik dhe vlerë të shtuar më të madhe.
- Nxitja drejt zhvillimit të standarteve dhe cilësisë së produkteve për eksport duke u fokusuar nga njëra anë, në produktet dhe shërbimet ku Shqipëria ka një avantazh krahasues në vlerën e produkteve të saj (Psh. produktet BIO), dhe nga ana tjetër, në nxitjen e inovacionit (R&D) në përmbushjen e standarteve për eksport. Rritja e standarteve vjen dhe nga mbështetja që mund t’i jepet sipërmarrësve të rinj të talentuar me njohuri të gjëra për standartet e tregjeve ndërkombëtare.
- Konsolidimi i eksporteve të shërbimeve që lidhen me tendencat teknologjike botërore dhe të burimeve njerëzore të disponueshme në tregun e punës shqiptar, siç është rasti i zhvillimit të telemarketingut, asistencës në distancë etj. Në këtë sektor ka një angazhim të lartë të popullatës rinore dhe të nivelit të kontraktimit nga kompani ndërkombëtare të mëdha. Mbështetja ndaj kompanive shqiptare të këtij sektori do të ndihmonte pozitivisht në bilancin tregtare.

○ *Koordinimi*

- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet prodhuesve do të lejojë shfrytëzimin potencial të “economies of scale”. Madhësia e vogël e veprimtarisë ekonomike që karakterizon tregun lokal, sjell nevojën e koordinimit të aktiviteteve ndërmjet subjekteve të ndryshme ekonomike, do të mundësonte reduktimin e kostove fikse për çdo prodhues të vetëm.
- Krijimi i lehtësive infrastrukturore specifike në zhvillimin e parqeve industriale, inkubatorëve apo clusterave të produkteve eksportuese. Ndërtimi i parqeve industriale mund të kombinohet me incentiva fiskale apo që nxisin tregtinë e lirë. Mbështetja ndaj clusterave në terësi dhe jo vetëm ndaj anëtarëve veçmas lejon krijimin e sinergjive financiare dhe njerëzore.

- Mbështetja e shoqatave të biznesit dhe kompanive eksportuese që operojnë në bazë sektori dhe produktesh.
- Krijimi dhe/ose konsolidimi i mëtejshëm i rrjeteve konsultative, informative apo promovuese mes bizneseve, shoqatave, botës akademike dhe shtetit me qëllim një koordinim më reaktiv ndaj zhvillimeve të sektorëve dhe të eksportit.
- Thjeshtëzim i legjislacionit për eksport, etj.
- **Diaspora:** Një kontribut potencialisht i rëndësishëm që mbështet zbatimin e një programi të nxitjes së eksporteve është Diaspora. Biznese nga diaspora kanë zgjeruar kufijtë e njohurive lidhur me prodhimin, menaxhimin dhe diversifikimin e produkteve për eksport.

o **Mbështetja financiare**

- Bazuar në suksesin e Fondit të Konkurrueshmërisë, objektivi i qeverisë për periudhën 2013-2020, është që nëpërmjet këtij fondi të asistohen kompanitë eksportuese, kështu që do të ketë një rritje deri në 10% të eksporteve gjatë këtyre viteve.
- Për të ardhur në ndihmë të kompanive eksportuese synohet të përmirësohet dhe të hapet se shpejti Fondi Shqiptar i Garantimit të Kredive për Eksport. Kjo është një nga nismat me të reja që qeveria shqiptare do të ndërmarrë në mbështetje të kompanive eksportuese vendase në vlerë prej 2 Mil.USD. Fondi i garantimit të kredive të eksportit përdoret për të mbuluar kërkesat për kolateral për kredi tregtare (për mjete xhiroje) për ndërmarrjet, të kërkuara nga sistemi bankar shqiptar
- Hartimi dhe implementimi i skemave të reja mbështetëse kreditimi për zhvillimin e eksporteve.

3.2.5. *Objektiva të matshëm të eksporteve:*

Rritja e treguesve të eksportit të mallrave, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të prodhimit të sektorëve aktuale që punojnë për eksport, si dhe shtimi i gamës së sektorëve dhe artikujve të rinj për të dalë në eksport, sidomos në drejtim të mineraleve të reja, artikujve bujqësore dhe agro-përpunimit, etj, duke synuar një rritje progresive vjetore me **9%**.

Sigurimi i masave lehtësuese për bizneset që prodhojnë për eksport, në veçanti nxitja e vendosjes së prodhimit me fason drejt zonave dhe rajoneve që kanë papunësi të lartë dhe mundësi zhvillimi të kufizuar.

Ruajtja e ritmit të rritjes së eksportit dhe rritja e kontributit të sektorit të eksporteve në rritjen e PBB-së duke arritur në **20%** të PBB-së në vitin 2020.

Ruajtja dhe rritja me rime më të larta të eksporteve nga prodhimi vendas në raport me prodhimin me fason duke arritur në vitin 2020 në raportet 60% nga prodhimi vendas dhe 40% nga fasoni.

4. Objektivat për zhvillimin e Investimeve të Huaja Direkte.

Objektivi strategjik për investimet e huaja është kthyer Shqipërinë në një destinacion kryesor për investimet e huaja në Evropën Juglindore duke tërhequr, mbajtur dhe maksimizimin e fluksit të tyre

Me qëllim për të pasur një tablo të qartë të IHD-ve në vend, ndikimin e tyre dhe gjithashtu për të gjetur segmentet me të mira (niche) për thithjen e IHD, Qeveria Shqiptare, nën drejtimin e UNCTAD / UNDP ka përgatitur dhe publikuar Raportin shqiptar “Për Investimet e Huaja” (dy edicionet). Në këtë raport gjendet informacion shumë i dobishëm veçanërisht për të analizuar

rolin e IHD-ve në ekonomi, numrin e tyre dhe vëllimin e prodhimit, punësimin shifren e afarizmit, si dhe kontributin e të teknologjive të reja.

Shprehur si në objektivat e mësipërme, strategjia e qeverisë i kushton shumë rëndësi jo thjesht në vëllimin e hyrjeve të investimeve të huaja, por edhe në cilësinë e tyre. Greenfield dhe investime të orientuara nga eksporti, si dhe investimet në prodhimin e vlerës së lartë dhe të produkteve të teknologjisë së lartë do të jetë një prioritet i rëndësishëm. Investime të tilla kanë potencial më të lartë të rritjes dhe për të sjellë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Objektivat specifike janë:

- Ruajtja e një niveli të lartë të investimeve të huaja ndaj PBB-së për 7 vitet e ardhshme.
- Arritja e qëndrueshmërisë afatgjatë të investimeve duke promovuar ri investimin dhe zgjerimin e investimeve ekzistuese.
- Rritja e pjesës së investimeve direkte (green field) dhe investime të orientuara nga eksporti.
- Rritja e pjesës së vlerës së shtuar në nivel kombëtar të investimeve dhe atyre të teknologjisë së lartë.

4.1. Forcimi i kapaciteteve për Promovimin e Investimeve

Në përputhje me përmirësimet e politikës, një drejtim i rëndësishëm i strategjisë së IHD-ve të qeverisë do të jetë nxitja aktive për klimën e biznesit për investime dhe mundësitë për investitorët ekzistues dhe ato potencial. Agjencia zbatuese për promovimin e kësaj strategjie është AIDA. Shërbimet e AIDA-s do të mbulojnë të gjitha fazat e investimit: a) para-investim, duke përfshirë shpërndarjen e informacionit, studimeve dhe analizave sektoriale, vlerësimin e investimeve, kontaktet me institucionet relevante, bashkëpunim me partnerët (match-up), asistencën ndaj vizitave të investitorëve, etj, b) investim, duke përfshirë ndihmën nëpër të gjitha investimeve të filluar dhe procedurat e vendit të investimit dhe c) pas-investimit, duke përfshirë edhe ndihmë me problemet e operimit dhe në zgjerimin ose konsolidimin e aktivitetit të tyre. Në terma afatmesëm, AIDA do të transformohet në një “one-stop-shop” për investitorët e huaj, e cila përveç mbështetjes fillestare dhe shërbimeve të lidhura, gjithashtu do të jetë në gjendje të negociojë me investitorët për incentiva specifike.

4.2. Investitorët e synuar

AIDA do të jetë shumë aktive në krijimin, mbajtjen dhe ndërveprimin me investitorët potencial, ato ekzistues dhe palët e interesuara. Disa nga llojet kryesore të investitorëve që do të kontaktohen jepen si më poshtë:

- *Investime të orientuara nga eksporti:* Tregu shqiptar i brendshëm është relativisht i vogël, dhe shumica e investitorëve do të jenë të interesuar në investimet e orientuara nga eksporti. Pozicioni gjeografik i favorshëm i vendit, infrastruktura e mirë dhe kosto e lirë e punës janë elemente të rëndësishme që plotësojnë nevojat e këtij lloji të investitorësh, veçanërisht ato që duan të eksportojnë në tregjet evropiane. Në veçanti, Shqipëria ofron mundësi të mëdha në fushën e mineraleve dhe përpunimit të metaleve, në sajë të burimeve të pasura natyrore dhe të prodhimit të konsiderueshëm mineralar. Zhvillimi i industrisë përpunuese të metaleve gjithashtu do të krijojë mundësinë për zhvillimin e industrive të lidhura, të tilla si industri mekanike dhe automobilave. Një tjetër fushë me potencial të lartë të eksportit është prodhimi i produkteve “niche”, veçanërisht në fushën e produkteve

të kujdesit mjekësor dhe personale, të cilat mund të përfitojnë nga potenciali i madh të vendit në prodhimin e bimëve mjekësore.

- Investime me punësim intensiv: Shqipëria ende ofron kosto të ulët të punës, në krahasim me vendet e tjera në rajon. Shumë lloje të investitorëve do të jenë të interesuar për të përfituar nga ky avantazh, në veçanti në tekstile e përpunimit të brendshëm dhe industrinë e lëkurë. Shqipëria ka qenë e suksesshme në tërheqjen e llojeve të tilla të investimeve në të kaluarën, të cilat kanë bërë histori suksesi dhe kanë dhënë shumicën e eksporteve të vendit në dekadën e fundit. Ky lloj i investitorëve do të vazhdojë të promovohet në mënyrë “agresive” në të ardhmen. Investime në teknologji të reja. Deri tani qeveria ka nxjerrë Ligjin Nr. 125, datë 2012/12/20 që lehtësojnë problemet e TVSH, deri në përjashtimin e TVSH-s, për ato kompani që sjellin, ose do të investojnë në teknologji të reja.

4.3. Përmirësimi i imazhit të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare.

Investimet dhe strategjitë për investitorë të synuar kanë provuar se kanë qenë shumë të suksesshme në Shqipëri - disa nga investimet më të mëdha dhe më të rëndësishme të huaja në vend janë siguruar nëpërmjet synimeve të specifike. Për këtë arsye, strategjia e vendit do të fokusohet në dy drejtime kryesore: a) ndërtimin e imazhit të vendit si një destinacion i shkëlqyer për investime, duke theksuar avantazhet e Shqipërisë për mjedisin e lidhura me investimet dhe b) promovimin e drejtpërdrejtë të mundësive për investime tek investitorët, në lidhje me avantazhet e veçanta të vendit me nevojat e investitorit të synuar.

4.4. Promovimi i biznesit shqiptar në tregjet ndërkombëtare

Në këtë drejtim duhet të diskutohet dhe të promovohet një rol të ri për misionet diplomatike shqiptare. Fokusi duhet të jetë në bashkëpunim mes Ministrisë së Punëve të Jashtme, AIDA-s dhe Bashkimit të DHTI-së për promovimin e biznesit shqiptar në tregjet ndërkombëtare nëpërmjet misioneve të përbashkëta dhe stafit të kualifikuar.

4.5. Zhvillimi i zonave ekonomike (parqet industriale dhe zonat e lira)

Konsiderohet si një objektivi i rëndësishëm që ndikon në rritjen e investimeve të huaja, si dhe rritjen e aftësisë së kapaciteteve gjeneruese në vend. Parqet industriale synohet të bëhen operative për të siguruar shërbime të standardeve të larta për investitorët që vijnë.

4.6. IHD-ve përmes përfundimit të procesit të privatizimit

Privatizimi ka luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë shqiptare dhe flukset e IHD-ve. Investimet e huaja marrin një rëndësi të re në periudhën e post-privatizimit. Privatizimi i pronave publike është pothuajse i përfunduar në Shqipëri – te vetmet asete të mbetura të qeverisë që do të privatizohen janë hidrocentralet

4.7. Objektiva të matshëm të IHD

- rritje mesatare të IHD-te prej **6.3%** për çdo vit.
- Kjo shifër mund të jetë më e lartë në 2 vitet e para, për arsye të mundësive të tërheqjes së investitorëve të huaj si rezultat i privatizimit të sektorëve strategjike.
- shndërrimi i 15-20% të kompanive të targetuara në investitorë potenciale

- Rritja e IHD kundrejt PBB mesatarisht me 0.1 – 0.2 % çdo vit.

IV. KOSTOT FINANCIARE DHE BURIMET PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Për një vlerësim të përafërt të kostove të nevojshme për zbatimin e strategjisë së biznesit dhe investimeve janë marrë në konsideratë programet buxhetore afat-mesme të METE-s për periudhën 2013-2015, projekte të ndryshme me fonde të huaja, duke vepruar dhe planifikuar për të filluar në disa fusha, dhe llogaritjet paraprake për projektet dhe aktivitetet e tjera që do të kryhen në partneritet me bizneset. Gjatë viteve në vazhdim janë planifikuar të financohen programet e reformave rregulluese, zhvillimi i SME-ve, eksportet, investimet e huaja, janë përfshirë gjithashtu edhe fondet për zhvillimin e industrisë jo-ushqimore, minierave, të cilat zhvillohen në bazë të sipërmarrjes së lire. Një pjesë e kostove, në varësi të përmasave, përveç METE-s dhe institucioneve të tjera, kryesisht do të mbulohen nga financimi i huaj i sektorit privat.

Në llogaritjen e kostove kemi marrë gjithashtu parasysh koston për ndërtimin e parqeve ose të zonave industriale, ku për **çdo hektarë** të ndërtimit të një parku kostoja është përllogaritur rreth **1 milion**.

Kostot e përafërta për projektet specifike, ndërtesat e institucioneve, etj, janë bazuar në studimet e ndryshme dhe eksperiencat e vendeve të tjera. Në këtë kontekst, në mund të nënvizojmë:

- Përmirësimi i klimës së biznesit ka nevojë për të paktën **1,973 milion ALL**, pjesa më e madhe e të cilave do të mbulohet nga qeveria, por edhe nga donatorët, nga projektet BERIS, GIZ, etj. Kjo përfshin masat për procedurat nxitëse dhe lehtësuese dhe kostot për të bërë biznes, reduktimin e pengesave hyrëse në treg, për reduktimin e mëtejshëm të procedurave për fillimin e një biznesi, lejeve të punës, regjistrimin e pronës, procedurat e eksportit-importit, zbatimin e plotë të sistemit RIA, reformën në inspektoriat, etj.

- Për zhvillimet në rritje, bizneset me kapacitet ndërkombëtar kërkojnë një vlerë prej rreth **814 milionë ALL**, të cilat përfshijë projekte për të rritur konkurrencën e SME-ve, fondin kredi të garancisë për inkurajimin e ndryshimeve dhe transferimin e teknologjive. Megjithëse do të ketë një mbështetje nga BE-ja përmes IPA-s (Instrumenti Para Anëtarësimit) shumë përfituese dhe projekteve komunitarë CIP (Programi i Konkurrencë dhe Inovacion)

- Për financimin e SME-ve parashikohet një vlerë prej **15,200 milion ALL** me mbështetjen e qeverisë Italiane në shumën e 15 milion Eurove ku janë përfshirë hua të ndryshme dhe mikro-hua për SME-të, krijimi i fondit të garancisë së kredive, krijimi i instrumenteve të tjerë për financimin e SME-ve.

- Për të mbështetur SME-të lidhur me inovacionin është parashikuar një buxhet prej **1.033 milion ALL**, nga të cilat 80% pritet të mbulohen nga donatorët si BE-ja përmes IPA, USAID, GIZ dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillimin (AADF) dhe 20% nga qeveria Shqiptare.

- Nxitja e kulturës së sipërmarrjes kërkon një buxhet përafërsisht rreth **254 milion ALL**. Këto masa do të mbulohen kryesisht nga buxheti i shtetit dhe do të ndërmerren në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Edukimit dhe Ministrinë e Punës.

- Programi për të mbështetur gratë në biznes në vlerën prej **85 milion Lekë**, i cili do të mbulohet nga buxheti i shtetit.

- Programi për të mbështetur ekonominë artizanale kap një vlerë prej **230 milionë ALL**.
- Programi për nxitjen e biznesit social dhe të përgjegjshmërisë sociale me një shumë prej **140 milionë Lekë**, pjesa më e madhe e së cilës do të mbulohet nga donatorët të tillë siç është UNDP, etj.

- Institucionet që kanë një ndikim të rëndësishme dhe të domosdoshëm në rritjen e importeve dhe aftësive konkurruese të kompanive Shqiptare janë ato që merren me sistemin e matjeve, standardizimit, akreditimit dhe kontrollit të cilësisë për mallrat dhe shërbimet e ofruara nga ekonomia Shqiptare. Për të fuqizuar dhe për të plotësuar këtë infrastrukturë ndërkombëtare janë përfunduar disa projekte mbështetëse dhe bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare si Banka Botërore, IBRD, projekti BERIS, etj.

- Projektet për zhvillimin e fushave ekonomike dhe parqeve industriale që do të ndërtohen me pjesëmarrjen e sektorit privat dhe investitorëve të huaj dhe do të jetë afërsisht **14,277 mln ALL** ose 102 milionë EURO.

- Programe për të tërhequr investitorët e huaj, për të promovuar potencialet investuese të vendit, për të përmirësuar shërbimet ndaj investitorëve të huaj përmes një ndalese, është vlerësuar që kërkon një buxhet prej **714 milionë ALL**, të cilat do të sigurohen së pari nga buxheti i shtetit si dhe nga donatorët e tjerë.

Për të zbatuar objektivat e sektorit të minierave kërkohet një buxhet prej **2,721 milionë Lekë** që do të mbulohet kryesisht nga buxheti i shtetit për të arritur këto objektiva:

Përfundimin e kuadrit ligjor sipas standardeve të BE-së me një buxhet prej 101 milionë ALL. Monitorimi i mbikëqyrjes me 1,207 milionë ALL, procesi i privatizimit 256 milionë ALL, mbrojtja mjedisore dhe zhvillimi social 178 milionë ALL; programe, transparencë, bashkëpunim me grupet e interesit dhe qeverinë lokale kanë një vlerë prej 467 milionë ALL.

Orientim mbi kostot e përgjithshme për zbatimin e strategjisë:

Me qëllim që të arrihen rezultatet e synuara në zhvillimin e biznesit dhe të investimeve për periudhën 2013-2020, llogaritjet kërkojnë një buxhet rreth **39,677 milionë ALL**, prej të cilave në vlerën **22,187 milionë Lekë**, ose rreth 55% e kostos totale është e premtuar dhe nënkupton donatorët e huaj ndërsa fondi i planifikuar për t'u mbuluar nga buxheti i shtetit është **6,930 milion Lekë** ose **17%** e kostos totale. Nga investimet e huaja direkte private rreth **10,550 milionë Lekë** ose **28%** e kostos totale. Gjithashtu buxheti i shtetit do të mbulojë kostot e lidhura me burimet njerëzore, kërkimin dhe zhvillimin, dhe trajnimin.

Tabela 4 e kostove sipas sektorëve (në Milion ALL)

Kostot e strategjisë ZHBI 2013-2020 (milion Lekë)										
Nr		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	total
1	SME inovative dhe sipërmarrja									
A	Përmirësimi i klimës së biznesit	197	200	276	220	240	260	280	300	1973
B	SME inovative									
	Fondi i Inovacionit	12	12	12	25	35	50	70	85	301

	Shërbimet për Inovacionin e Biznesit	18	20	25	35	35	35	40	40	248
	Programi i Inkubacionit të Biznesit	1	8	60	17	20	18	20	20	164
	Programi Shqiptar i Cluster-it (ACP)	12	13	20	25	50	60	70	70	320
	Totali SME inovative	43	53	117	102	140	163	200	215	1033
C	SME kreditimi	700	700	1000	1500	2000	2500	3300	3500	15200
D	Ekonomia kreative	10	10	10	10	20	40	60	70	230
E	biznesi social & përgje. sociale	10	12	15	18	20	20	20	25	140
F	trajtime SME & start up	0.5	0.5	0.5	5	8	10	15	20	59.5
G	program gratë në biznes	2	5	8	10	15	15	15	15	85
H	grante për start up	2	2	5	15	20	25	30	35	134
	Totali SME	964.5	982.5	1431.5	1880	2463	3033	3920	4180	18855
2	Nxitja eksporte									
	fondi garantimit eksporteve	70	70	70	70	70	70	70	70	560
	fondi konkurrueshmërisë	28	28	28	30	30	35	35	40	254
	Totali eksporteve	98	98	98	100	100	105	105	110	814
3	Nxitja e IHD									
	promovimi potencialeve IHD (AIDA)	51	53	55	85	100	115	125	130	714
	Krijimi i parqeve industriale	100	253	560	850	1500	2400	3100	4800	13563
	Total IHD	151	306	615	935	1600	2515	3225	4930	14277
4	Industria Totali	320	320	320	350	400	420	430	440	3,000
5	Minierat									
	Plotësimi i kuadrit ligjor sipas standarteve të BE-se	11	11	12	12	13	13	14	15	101
	Fuqizimi institucional	56	57	59	61	64	67	72	76	512
	Mbikëqyrja e monitorimi	132	135	139	144	151	159	169	179	1207
	Procesi privatizimit	28	29	29	31	32	34	36	38	256

Mbrojtja mjedisit & zhvillimi social	20	20	20	21	22	23	25	26	178
Programimi, transparenca, bashkëpunim me grupet e interesit e pushteti vendor	51	52	54	56	59	61	65	69	467
Total Miniera	298	304	313	325	341	358	380	403	2721
Total strategji	1831	2010	2777	3590	4904	6431	8060	10063	39677

V. TREGUESIT E MONITORIMIT TE STRATEGJISE

Suksesi në vlerësimin e treguesve të monitorimit 2013 - 2020 do të behet sipas **2 grupeve**:

1. Grupimi i treguesve monitorues të përcaktuar sipas shtyllave të kësaj strategjie.

Mbështetur në sektorët kryesor që përbejnë bazën e kësaj strategjie, monitorimi do të realizohet nga **sektori i monitorimit të strategjive në METE** në bashkëpunim me drejtoritë që janë përgjegjëse për objektiva të caktuar si Drejtoria e Politikave të Mbështetjes së Konkureshmërisë, Drejtoria e Politikave Industriale, Drejtoria e Politikave të Integritit Tregtar, AIDA, etj. Bazuar në planin e veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe çdo vit, plani i veprimit do të jetë pjesë përbërëse e planit vjetor të çdo drejtorie që mbulon sektorët e kësaj strategjie:

Drejtoria e Politikave të Mbështetjes së Konkureshmërisë, do të jetë përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit sipas objektivave të përcaktuara për klimën e biznesit, sektorin e sipërmarrjes dhe SME-ve, sektorin e nxitjes së eksporteve si dhe të nxitjes së investimeve të huaja.

Drejtoria e Politikave Industriale dhe minerare, do të jetë përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit sipas objektivave të përcaktuar në sektorin e industrisë dhe të minierave.

Drejtoria e Politikave të Integritit Tregtar, do të jetë përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit dhe objektivave për reduktimin e kostove administrative dhe eliminimin e barrierave tregtare jo tarifore.

Çdo vit, do të monitorohet ecuria e realizimit të indikatorëve bazë të kësaj strategjie, për vitin raportues. Duke siguruar një bashkëpunim të ngushtë me institucionet si INSTAT, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, AKBN, AIDA, etj, me qëllim për të mbledhur bazën e të dhënave që do të garantojnë dinamikën e zhvillimit të indikatorëve të përcaktuar sipas viteve të kësaj strategjie.

2. Benchmarking Ndërkombëtar

Renditja e Shqipërisë në benchmarking global do të jetë një tregues transparent dhe i matshëm për suksesin e zbatimit të strategjisë që do të bazohet në vlerësimet e raporteve ndërkombëtare:

-Raporti i BB-së mbi “Të Bërit Biznes” si benchmarking kryesor.

Mbetet një synim dhe ambicie e qartë e Qeverisë për tu renditur midis 50 më të mirëve në të gjitha pikat kyçe të renditjes globale për lehtësinë e të bërit biznes dhe konkurrueshmërisë dhe lidershipit në Evropën Juglindore.

<http://www.doingbusiness.org/>

-Indeksi i Politikave të SME-ve i BE-së sipas Aktit të Biznesit të Vogël (ABV) së BE-së

Indeksi i Politikave SME është një raport vlerësues për vendet e Ballkanit Perëndimor për të monitoruar dhe vlerësuar progresin në zbatimin e kuadrit kryesor të politikave për zhvillimin e SME-ve.

http://www.oecd.org/pages/0,3417,en_35424885_37776794_1_1_1_1_1,00.html

Është një synim dhe ambicie e Qeverisë për të qenë lider në Evropën Juglindore midis vendeve të tjera të rajonit.

-Një tregues tjetër që do të inkludohet, psh: “Gender Gap Index”, i forumit ekonomik botëror (<http://www.weforum.org/issues/global-gender-gap>)

-Këshilli Rajonal për Investimet në Evropën Juglindore (Investment Compact-OECD)

Që nga Janari 2012, Komiteti i Investimeve të Ejl bashkë-drejtohet me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal, OECD Investment Compact vazhdon të ofrojë mbështetje në rritjen e konkurrueshmërisë rajonale dhe klimës së investimeve, veçanërisht për zbatimin e Vizionit të Ejl për vitin 2020.

http://www.investmentcompact.org/pages/0,2987,en_35424885_35425005_1_1_1_1_1,00.html

Është një synim dhe ambicie e Qeverisë për të qenë lider në Evropën Juglindore midis vendeve të tjera të rajonit.

-Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale

Forumi ekonomik Botëror publikon çdo vit të dhënat kryesore mbi konkurrueshmërinë e ekonomisë së vendeve të botës.

<http://reports.weforum.org/global-competitiveness-2011-2012/#>

- Indeksi i Lirisë Ekonomike

Instituti Fraser dhe Heritage, të dy me seli në Amerikën e Veriut publikojnë çdo vit treguesit të fokusuar në lirinë ekonomike

<http://www.fraserinstitute.org/research-news/research/display.aspx?id=16613>

<http://www.heritage.org/index/explore>

- **Treguesit e strategjisë**

Në këtë fushë tregues të qartë dhe të matshëm numerikë lejojnë transparencën dhe fokusin në arritjen e synimeve në këtë periudhë 2013-2020:

- **Përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit** duke:
Reduktuar kohën e hapjes së një biznesi nga 5 ditë që është në 2013 në 2 ditë,
Reduktimin e procedurave për hapjen e një biznesi nga 5 në 2,
Reduktimin e ditëve për marrjen e licencave të ndërtimit nga 436 dite në 35 dite,
Përmirësimin e shërbimit për pagimin e taksave online, etj.
- **Për SME-të inovative dhe sipërmarrjen:**
Krijimi i 1 inkubatori teknologjik të biznesit
Krijimi i 3 klasterave të reja
Mbështetja e 300 bizneseve me informacione e grante për inovacionin
Krijimi i programit për mbështetjen e 100 bizneseve të udhëhequra nga gratë nëpërmjet kredive me interesa të ulta.
Krijimi i programit për mbështetjen e rreth 400 bizneseve të reja (start up) , nëpërmjet fondeve grant dhe kredi me interesa të ulta
Krijimi i fondit për mbështetjen e 470 bizneseve kreative sidomos ato në fushën e artizanatit me grante
- **Për internacionalizimin e SME-ve**
Mbështetja e 254 kompanive me grante për rritjen e konkurrueshmërisë së tyre
Mbështetja e 100 kompanive eksportuese me fonde të garantimit të eksporteve.
- **Për industrinë**
 - Rritja e shifrës së afarizmit të sektorëve të industrisë mesatarisht çdo vit prej 7,3%
 - Rritja e vlerës së shtuar mesatarisht çdo vit prej 10%
 - Rritja e produktivitetit mesatarisht çdo vit, prej 5%
- **Për Minierat**
Rritja e prodhimit me 40% në fund të vitit 2020 krahasuar me vitin 2013
Rritja e investimeve me 40% në fund të vitit 2020 krahasuar me vitin 2013
Rritja e të punësuarve me 47% në fund të vitit 2020 krahasuar me vitin 2013
- **Për Eksportet**
Rritja e eksporteve të mallrave mesatarisht çdo vit prej 9%
- **Për tërheqjen e investimeve të huaja**
Krijimi dhe funksionimi i 9 parqeve industriale dhe zonave ekonomike
Përmirësimi i shërbimeve ndaj 210 investitorëve të huaj

Monitorimi i strategjisë së Biznesit dhe Investimeve do të bëhet nëpërmjet këtyre indikatorëve:

Përshkrimi	Njësi	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
<i>Klima e biznesit</i>									

Numri i ditëve për hapjen e një biznesi të ri		5	4	3	2	2	2	2	2
Numri i procedurave për hapjen e një biznesi të ri		5	4	3	2	2	2	2	2
Performanca SME-ve									
Nr. Ndërmarrjeve aktive	000/nd	113	115	117	119	121	123	125	127
Rritja me % e nr. te ndërmarrjeve	%	1.8	1.8	1.7	1.7	1.7	1.7	1.6	1.6
Nr. i të punësuarve		285	299	314	330	346	364	382	401
Rritja ne % e te punësuarve		4%	5%	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Nr. Ndërmarrjeve të drejtuara nga femra ne % ndaj totalit	%	28%	29%	30%	31%	32%	33%	34%	35%
Kredia e disbursuar për bizneset femërore	%	29%	30%	31%	32%	33%	34%	34,5%	35%
SME inovative									
Krijimi i inkubatorëve të biznesit									1
Krijimi klasterave							1	1	1
Eksportet									
Eksporti mallrave gjithsej(X)	Mln/€	1668	1818	1981	2160	2354	2566	2797	3049
Rritja ne % e eksporteve kontributit te eksporteve ne PBB	%	9	9%	9%	9%	9%	9%	9%	9%
		16%	17%	18%	18%	19%	19%	20%	20%
IHD									
IHD gjithsej	Mln Euro	855	905	950	1005	1052	1095	1140	1220
Rritja ne % e IHD	%	14%	5.8%	5.0%	5.8%	4.7%	4.1%	4.1%	7.0%
IHD si % e PBB-se		8.3%	8.4%	8.4%	8.5%	8.4%	8.2%	8.1%	9%
Konkurueshmëria									
Indikatori i Konkureshmërisë/ Score		4.1	4.15	4.2	4.25	4.3	4.35	4.4	4.5
Indikatori i Konkureshmërisë/ Rank									
Industria									
Rritja ne % e shifrës		5%	7%	7%	8%	8%	8%	8%	8%

afarizmit									
Rritja në % e Vlerës së Shtuar		6%	10%	10%	10%	10%	10%	10%	10%
Rritja në % e produktivitetit		5%	5%	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Minierat									
Rritja në % të punësuarve	%	10%	5%	4%	4%	4%	4%	4%	4%
Rritja në % e prodhimit		5%	5%	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Rritja në përqindje e vlerës së produkteve minerare		5%	6%	6%	6%	6%	6%	6%	6%
Rritja në % e objekteve prodhuese	%	5%	4%	4%	3%	3%	2%	2%	2%
Rritja në përqindje e investimeve	000 euro	5%	5%	5%	5%	5%	5%	5%	5%

VI. ANEKSET E STRATEGJISË

Aneks i kësaj strategjie është plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për periudhën 2013-2020